



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

[www.qbz.gov.al](http://www.qbz.gov.al)

**Nr.157**

**6 dhjetor**

**2012**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 108/2012 datë 15.11.2012	Për ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara” .....	8457
Ligj nr. 109/2012 datë 15.11.2012	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Njohjen e Divorceve dhe Ndarjeve Ligjore .....	8477
Ligj nr. 110/2012 datë 15.11.2012	Për bashkimin ndërkufitar të shoqërive tregtare .....	8484
Ligj nr. 111/2012 datë 15.11.2012	Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore .....	8498

**LIGJ**  
**Nr. 108/2012**

**PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SË OKB-SË “PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME  
AFTËSI TË KUFIZUARA”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet konventa e OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”, bërë në Nju-Jork më 13 dhjetor 2006.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 15.11.2012

**Shpallur me dekretin nr. 7842, datë 3.12.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

**KONVENTA**  
**MBI TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA**

**Preambulë**

Shtetet palë në këtë konventë:

a) *Duke pasur parasysh se*, në përputhje me parimet e shpallura në Kartën e Kombeve të Bashkuara, të cilat njohin dinjitetin e lindur dhe të drejtat e barabarta dhe të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes së njeriut si bazë të lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë;

b) *Duke pranuar se* Kombet e Bashkuara, në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe në paktet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, kanë shpallur dhe kanë pranuar që çdo njeri gëzon të gjitha të drejtat dhe liritë të parashtruara në to, pa asnjë dallim të çfarëdo lloji;

c) *Duke pohuar se* universaliteti, pandashmëria, ndërvarësia dhe ndërlidhja e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe nevojës së personave me aftësi të kufizuara për t'i garantuar ato pa diskriminim;

d) *Duke pasur parasysh se* Konventa ndërkombëtare mbi të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore, Konventa ndërkombëtare mbi të drejtat civile dhe politike, Konventa ndërkombëtare mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racial, Konventa ndërkombëtare mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave, Konventa kundër torturës dhe formave të tjera të trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor apo poshtërues, Konventa mbi të drejtat e fëmijëve dhe Konventa ndërkombëtare mbi mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punonjësve migrues dhe anëtarëve të familjeve të tyre;



e) *Duke pranuar se* aftësia e kufizuar është një koncept evolues dhe se aftësia e kufizuar rezulton nga ndërveprimi ndërmjet personave me dëmtime dhe barrierave të qëndrimit/mentalitetit dhe ambientit, që pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në nivel të barabartë me të tjerët,

f) *Duke pranuar* rëndësinë e parimeve dhe udhëzimeve politike të shprehura në programin botëror të veprimit lidhur me personat me aftësi të kufizuara dhe në rregullat standarde mbi barazinë e mundësive për personat me aftësi të kufizuara, të cilat ndikojnë në promovimin, formulimin dhe vlerësimin e politikave, planeve, programeve dhe veprimeve në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar për të çuar më tej barazinë e mundësive për personat me aftësi të kufizuara;

g) *Duke theksuar* rëndësinë e përfshirjes së çështjeve të aftësisë së kufizuar si një pjesë përbërëse të strategjive përkatëse për zhvillim të qëndrueshëm;

h) *Duke pranuar gjithashtu se* diskriminimi ndaj çdo personi i bazuar në aftësinë e kufizuar është një dhunim i dinjitetit të lindur dhe vlerës së personit;

i) Duke pranuar më tej diversitetin e personave me aftësi të kufizuara;

j) *Duke pranuar* nevojën për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e njeriut të të gjithë personave me aftësi të kufizuara, përfshirë dhe ata që kërkojnë mbështetje më intensive;

k) *Duke qenë të shqetësuar se*, pavarësisht nga të gjitha këto instrumente dhe ndërmarrje, personat me aftësi të kufizuara vazhdojnë të ndeshen me barriera në pjesëmarrjen e tyre si anëtarë të barabartë të shoqërisë dhe me dhunime të të drejtave të tyre njerëzore në të gjitha pjesët e botës;

l) *Duke pranuar* rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar për përmirësimin e kushteve të jetesës së personave me aftësi të kufizuara në çdo vend dhe veçanërisht në vendet në zhvillim;

m) *Duke pranuar* kontributet e vlefshme ekzistuese dhe potenciale të bëra nga personat me aftësi të kufizuara për mirëqenien e përgjithshme dhe diversitetin e komuniteteve të tyre, dhe se promovimi i gëzimit të plotë të të gjitha të drejtave të tyre njerëzore dhe lirive themelore nga personat me aftësi të kufizuara, si dhe pjesëmarrjes së plotë nga personat me aftësi të kufizuara do të çojë në rritjen e sensit të tyre të përkatësisë dhe në një përparim të konsiderueshëm të zhvillimit njerëzor, shoqëror dhe ekonomik të shoqërisë dhe zhdukjes së varfërisë;

n) *Duke pranuar rëndësinë* që ka për personat me aftësi të kufizuara autonomia dhe pavarësia e tyre personale, duke përfshirë dhe lirinë për të bërë vetë zgjedhjet e tyre;

o) *Duke pasur në konsideratë se* personat me aftësi të kufizuara duhet të kenë mundësinë të përfshihen aktivisht në proceset vendimmarrëse për politikën dhe programet, përfshirë ato që kanë të bëjnë direkt me ta;

p) *Duke qenë të shqetësuar* për kushtet e vështira që ndeshin personat me aftësi të kufizuara, të cilët u nënshtrohen formave shumëllojshme apo të rënduara të diskriminimit mbi bazë race, ngjyre, gjinie, gjuhe, besimi fetar, bindje politike apo të tjera, kombësie, origjine etnike apo shoqërore, pasurie, lindjeje, moshe apo gjendje të tjera;

q) *Duke pranuar se* gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara janë shpeshherë më shumë të rrezikuara, si brenda dhe jashtë shtëpisë, nga dhuna, dëmtimi apo abuzimi, neglizhenca apo trajtimi neglizhent, keqtrajtimi apo shfrytëzimi;

r) *Duke pranuar se* fëmijët me aftësi të kufizuara duhet të gëzojnë plotësisht të drejtat e njeriut dhe liritë themelore në baza të barabarta me fëmijët e tjerë, dhe duke pasur parasysh detyrimet lidhur me këtë qëllim të ndërmarrë nga shtetet palë në Konventën mbi të drejtat e fëmijës;

s) *Duke theksuar* nevojën për të përfshirë një perspektivë gjinore në të gjitha përpjekjet për të promovuar që personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë plotësisht të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut;

t) *Duke theksuar faktin se* shumica e personave me aftësi të kufizuara jetojnë në kushte të varfërisë dhe duke pranuar kështu nevojën kritike për të zgjidhur ndikimin negativ të varfërisë te personat me aftësi të kufizuara;

u) *Duke pasur në mendje se* kushtet e paqes dhe të sigurisë, të bazuara në respektimin e plotë të qëllimeve dhe parimeve që përmban Karta e Kombeve të Bashkuara dhe vëzhgimi i instrumenteve të aplikuara për të drejtat e njeriut janë të domosdoshme për mbrojtjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht gjatë konflikteve të armatosura dhe pushtimeve të huaja;

v) *Duke pranuar* rëndësinë e mundësisit të ambienteve fizike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore, në shëndet dhe arsimim dhe informacionit e komunikimit, për të mundësuar personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë plotësisht të drejtat dhe liritë themelore të njeriut;

w) *Duke kuptuar* se individi, duke pasur detyrime ndaj individëve të tjerë dhe komunitetit të cilit ai apo ajo i përket, ka përgjegjësinë të bëjë përpjekje për promovimin dhe respektimin e të drejtave të njohura në paketat ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut;

x) *Duke qenë* të bindur se familja është njësi e përbërë natyrale dhe themelore e shoqërisë dhe ka të drejtë të mbrohet nga shoqëria dhe shteti, dhe se personat me aftësi të kufizuara dhe anëtarët e tyre të familjes duhet të marrin mbrojtjen dhe asistencën e duhur, me qëllim që të bëjnë të mundur që familjet të kontribuojnë që personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë të drejtat e tyre në mënyrë të plotë dhe të barabartë;

y) *Duke qenë të bindur se* një konventë ndërkombëtare gjithëpërfshirëse dhe integrale për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat dhe dinjitetin e personave me aftësi të kufizuara do të japë një kontribut domethënës për të balancuar dizavantazhin e thellë shoqëror të personave me aftësi të kufizuara dhe të promovojë pjesëmarrjen në sferat shoqërore, politike, ekonomike dhe kulturore me mundësi të barabarta, si në vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim,

kanë rënë dakord për sa më poshtë:

#### Neni 1

#### **Qëllimi**

Qëllimi i kësaj konvente është të promovojë, të mbrojë dhe të sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të promovojë respektimin e dinjitetit të tyre të lindur.

Personat me aftësi të kufizuara përfshijnë ata që kanë dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat, në ndërveprim me barriera të ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët.

#### Neni 2

#### **Përkufizimet**

Për qëllimet e kësaj konvente:

“Komunikim” përfshin gjuhët, shfaqje teksti, *Braille*, komunikimin me prekje, printim me gërmë të madhe, multimedien digjitale, si dhe gjuhë të qartë, të dëgjuar dhe të shkruar, lexues dhe mënyra, mjete dhe forma komunikimi shtesë apo alternative, përfshirë informacionin digjital dhe teknologjinë e komunikimit.

“Gjuha” përfshin gjuhën e folur dhe gjuhën e shenjave, si dhe forma të tjera të gjuhës jo të folur.

“Diskriminim me bazë aftësinë e kufizuar” do të thotë që çdo dallim, përjashtim apo kufizim me bazë aftësinë e kufizuar, që ka si qëllim ose ndikon në dëmtimin apo anulimin e njohjes, gëzimit apo ushtrimit, mbi baza të barabarta me të tjerët, të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile apo në ndonjë fushë tjetër. Ky përkufizim përfshin të gjitha format e diskriminimit, duke përfshirë dhe mohimin e akomodimit të arsyeshëm.

“Akomodim i arsyeshëm” do të thotë modifikim dhe rregullim i nevojshëm dhe i përshtatshëm që nuk krijon një barrë disproporcionale, që është i nevojshëm në raste të veçanta, për t’u siguruar personave me aftësi të kufizuara gëzimin dhe ushtrimin e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut me baza të barabarta me të tjerët.

“Projektim universal” do të thotë projektim i mallrave, mjedisit, programeve dhe shërbimeve për t’i bërë të përdorshme për të gjithë njerëzit, në masën më të madhe të mundshme, pa pasur nevojë për përshtatje apo projektim të veçantë. Projektimi universal nuk duhet të përjashtojë pajisjet ndihmese për grupe të veçanta të personave me aftësi të kufizuara, kur është e nevojshme.



### Neni 3

#### Parimet e përgjithshme

Parimet e kësaj konvente duhet të jenë:

- a) Respekt për dinjitetin e natyrshëm, autonomi individuale, përfshirë lirinë për të bërë zgjedhjet personale dhe pavarësi e personit;
- b) Mosdiskriminim;
- c) Pjesëmarrje dhe përfshirje e plotë dhe efektive në shoqëri;
- d) Respekt për ndryshimin dhe pranimin e personave me aftësi të kufizuara si pjesë e diversitetit njerëzor dhe humanizmit;
- e) Barazi mundësish;
- f) Heqje barrierash;
- g) Barazi ndërmjet burrave dhe grave;
- h) Respekt për kapacitetet në zhvillim të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe respekt për të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara për të ruajtur identitetin e tyre.

### Neni 4

#### Detyrime të përgjithshme

1. Shtetet palë marrin përsipër të sigurojnë dhe promovojnë realizimin e plotë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të gjithë personat me aftësi të kufizuara pa diskriminim të ndonjë lloji me bazë aftësinë e kufizuar. Për këtë qëllim, shtetet palë marrin përsipër:

- a) Të miratojnë të gjitha masat e duhura legjislative dhe administrative, si dhe masa të tjera për zbatimin e të drejtave të njohura nga kjo konventë;
- b) Të marrin të gjitha masat e duhura, përfshirë legjislativonin, për të modifikuar apo zhvlerësuar ligjet, rregulloret, zakonet dhe praktikat ekzistuese që përbëjnë diskriminim ndaj personave me aftësi të kufizuara;
- c) Të marrin parasysh mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut për personat me aftësi të kufizuara në të gjitha politikat dhe programet;
- d) Të mos marrin pjesë në veprime apo praktika që nuk janë në përputhje me këtë konventë dhe të sigurojnë që autoritetet dhe institucionet publike të veprojnë në përputhje me këtë konventë;
- e) Të marrin të gjitha masat e duhura për të eliminuar diskriminimin me bazë aftësinë e kufizuar nga personat, organizatat apo ndërmarrjet private;
- f) Të ndërmarrin apo të promovojnë punën kërkimore dhe zhvillimin e mallrave, shërbimeve, pajisjeve dhe lehtësive të projektuara në mënyrë universale, siç përcaktohen në nenin 2 të kësaj konvente, të cilat duhet të kërkojnë adaptimin më minimal të mundshëm dhe koston më të ulët për të plotësuar nevojat specifike të personave me aftësi të kufizuara, për të promovuar gjendjen dhe përdorimin e tyre, dhe për të promovuar projektim universal në zhvillimin e standardeve dhe udhëzimeve;
- g) Të ndërmarrin apo të promovojnë punën kërkimore dhe zhvillimin, si dhe të promovojnë gjetjen dhe përdorimin e teknologjive të reja, përfshirë teknologjitë e informacionit dhe komunikimit, mjeteve ndihmëse lëvizëse, pajisjeve, teknologjive ndihmëse, të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara, duke u dhënë prioritet teknologjive me kosto të përballueshme;
- h) Të sigurojnë mundësimin e informacionit për personat me aftësi të kufizuara lidhur me mjetet ndihmëse lëvizëse, pajisjet, dhe teknologjitë ndihmëse, përfshirë teknologjitë e reja, si dhe forma të tjera ndihme, shërbimesh dhe lehtësirash mbështetëse.
- i) Të përmirësojnë trajnimin e profesionistëve dhe personelit që punon me personat me aftësi të kufizuara lidhur me të drejtat që njeh kjo konventë, me qëllim që ndihma dhe shërbimet e garantuara nga këto të drejta të sigurohen më mirë.

2. Lidhur me të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore, çdo shtet palë merr përsipër të ndërmarrë të gjitha masat në masën maksimale të burimeve ekzistuese dhe, kur është e nevojshme, në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar, me synimin për të arritur në mënyrë progresive realizimin e

plotë të këtyre të drejtave, pa cenuar ato detyrime të paraqitura në këtë konventë, të cilat sipas të drejtës ndërkombëtare janë drejtpërdrejt të zbatueshme.

3. Në zhvillimin dhe zbatimin e legjislationit për zbatimin e kësaj konvente, si dhe për proceset e tjera vendimmarrëse në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me personat me aftësi të kufizuara, shtetet palë duhet të konsultojnë dhe të përfshijnë aktivisht personat me aftësi të kufizuara, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara nëpërmjet organizatave të tyre përfaqësuese.

4. Asgjë nga kjo konventë nuk duhet të prekë ato dispozita që janë më të favorshme për realizimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe që mund të përmbahen në ligjin e shtetit palë apo të drejtën ndërkombëtare në fuqi për atë shtet. Nuk duhet të ketë asnjë kufizim apo cenim të asnjë prej të drejtave të njeriut dhe lirive themeltare të njohura apo ekzistuese në cilindo shtet palë në këtë konventë në përputhje me ligjin, konventat, rregulloret apo zakonet me pretekstin se kjo konventë nuk i njeh këto të drejta apo liri apo se ajo i njeh ato në një masë më të vogël.

5. Dispozitat e kësaj konvente zbatohen në të gjitha pjesët e shteteve federale pa asnjë kufizim apo përjashtim.

#### Neni 5

#### **Barazia dhe mosdiskriminimi**

1. Shtetet palë pranojnë se të gjithë personat janë të barabartë para ligjit dhe sipas ligjit dhe se kanë të drejtë pa asnjë diskriminim për mbrojtje të barabartë dhe përfitim të barabartë nga ligji.

2. Shtetet palë duhet të ndalojnë çdo lloj diskriminimi me bazë aftësinë e kufizuar dhe t'u garantojnë personave me aftësi të kufizuara mbrojtje ligjore të barabartë dhe efektive ndaj çdo lloj diskriminimi në të gjitha situatat.

3. Me qëllim që të promovohet barazia dhe të eliminohet diskriminimi, shtetet palë duhet të ndërmarrin të gjithë hapat e duhur për të siguruar që është arritur akomodimi i arsyeshëm.

4. Masat specifike të cilat janë të nevojshme për të përshpejtuar apo arritur *de facto* barazinë e personave me aftësi të kufizuara nuk duhet të konsiderohen diskriminim sipas termave të kësaj konvente.

#### Neni 6

#### **Gratë me aftësi të kufizuara**

1. Shtetet palë pranojnë se gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara i nënshtrohen një diskriminimi shumëformësh, dhe për këtë do të marrin masa për të siguruar se ato gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

2. Shtetet palë duhet të marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar zhvillimin, përparimin dhe fuqizimin e plotë të grave, me qëllim që t'u garantohet atyre ushtrimi dhe gëzimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të përcaktuara në këtë konventë.

#### Neni 7

#### **Fëmijët me aftësi të kufizuara**

1. Shtetet palë duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që fëmijët me aftësi të kufizuara të gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në bazë të barabartë me fëmijët e tjerë.

2. Në të gjitha veprimet lidhur me fëmijët me aftësi të kufizuara, interesit të lartë të fëmijëve duhet t'i kushtohet rëndësi parësore.

3. Shtetet palë duhet të sigurojnë se fëmijët me aftësi të kufizuara kanë të drejtën për të shprehur pikëpamjet e tyre lirisht në të gjitha çështjet që prekin ata, pikëpamjeve të tyre i është dhënë vlerësimi i duhur në përputhje me moshën dhe maturinë e tyre, në baza të barabarta me fëmijët e tjerë, dhe për t'u pajisur me asistencën e duhur sipas moshës dhe aftësisë së kufizuar për të realizuar këtë të drejtë.



## Neni 8

### Rritja e ndërgjegjësimit

1. Shtetet palë marrin përsipër të miratojnë masat e duhura, efektive dhe të menjëhershme:
  - a) Për të rritur ndërgjegjësimin e shoqërisë, përfshirë familjen, lidhur me personat me aftësi të kufizuara, dhe për të ushqyer respekt ndaj të drejtave dhe dinjitetit të personave me aftësi të kufizuara;
  - b) Për të luftuar stereotipat, paragjykimet dhe praktikat e dëmshme lidhur me personat me aftësi të kufizuara, përfshirë dhe ato me bazë seksin dhe moshën në të gjitha fushat e jetës;
  - c) Për të promovuar rritjen e ndërgjegjësimit lidhur me aftësitë dhe kontributet e personave me aftësi të kufizuara.
2. Masat për këtë qëllim përfshijnë:
  - a) Ndërmarrjen e nismave dhe mbarëvajtjen e fushatave efektive për ndërgjegjësimin e publikut të synuara:
    - i) të ushqejnë të kuptuarit e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara;
    - ii) të përmirësojnë perceptimin pozitiv dhe një ndërgjegjësim më të madh shoqëror ndaj personave me aftësi të kufizuara;
    - iii) të promovojnë njohjen e aftësive, meritave, mundësive të personave me aftësi të kufizuara dhe kontributeve të tyre në ambientin (vendin) e punës dhe tregun e punës;
  - b) Të ushqejnë një mentalitet respekti për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha nivelet e sistemit të edukimit, përfshirë të gjithë fëmijët që nga mosha e hershme;
  - c) Inkurajimin e të gjitha organeve të medias për të portretizuar personat me aftësi të kufizuara, në mënyrë të tillë që të jetë në pajtim me këtë konventë;
  - d) Promovimin e programeve trajnuese ndërgjegjësuese lidhur me personat me aftësi të kufizuara dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

## Neni 9

### Heqja e barrierave

1. Me qëllim që të bëhet e mundur që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës, shtetet palë duhet të marrin masat e duhura për të siguruar mundësimin për personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, në ambientet fizike, transport, informacion dhe komunikim, përfshirë dhe teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit, si dhe në mjete apo shërbime të tjera të hapura apo të siguruara për publikun, si në zonat urbane dhe ato rurale. Këto masa, të cilat duhet të përfshijnë identifikimin dhe eliminimin e pengesave dhe barrierave për mundësimin, zbatohen ndër të tjera për:
  - a) ndërtesa, rrugë, transport dhe mjete të tjera në ambiente të brendshme apo të jashtme, përfshirë shkollat, strehimin, shërbime mjekësore apo vendet e punës;
  - b) informacion, komunikim dhe shërbime të tjera, përfshirë shërbimet elektronike dhe shërbimet e emergjencës.
2. Shtetet palë duhet gjithashtu të marrin masat e duhura:
  - a) për të zhvilluar, shpallur dhe monitoruar implementimin e udhëzimeve dhe standardeve minimale për mundësimin e mjeteve dhe shërbimeve të hapura apo të siguruara për publikun;
  - b) për të siguruar se subjektet private që ofrojnë mjete dhe shërbime, të cilat janë të hapura apo të siguruara për publikun, të marrin parasysh të gjitha aspektet e mundësimit për personat me aftësi të kufizuara;
  - c) për të siguruar trajnim për pjesëmarrësit në proces lidhur me çështjet e heqjes së barrierave që ndeshin personat me aftësi të kufizuara;
  - d) për të siguruar në ndërtesat dhe mjete të tjera të hapura për publikun, shenja në *Braille* dhe në një formë lehtësisht të lexueshme dhe të kuptueshme;
  - e) për të siguruar forma asistence të drejtpërdrejta dhe të ndërmjetme, përfshirë udhëzues, lexues dhe përkthyes profesionalë të gjuhës së shenjave, për të lehtësuar hyrjen në ndërtesa dhe mjete të tjera të hapura për publikun;

f) për të promovuar forma të tjera të përshtatshme asistence dhe mbështetjeje për personat me aftësi të kufizuara për të siguruar që atyre t'u mundësohet informacioni;

g) për të promovuar mundësimin e informacionit të ri dhe sistemet e teknologjitë e reja të komunikimit për personat me aftësi të kufizuara, përfshirë dhe internetin;

h) për të promovuar projektimin, zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e sistemeve të informacionit të mundësueshëm dhe teknologjisë së komunikimit në një fazë të hershme, në mënyrë që këto teknologji dhe sisteme të bëhen të mundshme me një kosto minimale.

#### Neni 10

### **E drejta për të jetuar**

Shtetet palë ripohojnë se çdo qenie njerëzore ka të drejtën e lindur për jetën dhe se duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që personat me aftësi të kufizuara e gëzojnë këtë të drejtë në mënyrë efektive në baza të barabarta me të tjerët.

#### Neni 11

### **Situatat e rrezikut dhe emergjencat humanitare**

Shtetet palë, në përputhje me detyrimet e tyre sipas së drejtës ndërkombëtare, përfshirë të drejtën ndërkombëtare humanitare dhe të drejtën ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, do të marrin të gjitha masat për të siguruar mbrojtjen dhe sigurinë e personave me aftësi të kufizuara në situata rreziku, përfshirë situatat e konfliktit të armatosur, emergjencat humanitare dhe fatkeqësitë natyrore.

#### Neni 12

### **Njohja e barabartë para ligjit**

1. Shtetet palë riafirmojnë se personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtën e njohjes kudo si persona para ligjit.

2. Shtetet palë do të pranojnë se personat me aftësi të kufizuara gëzojnë zotësi ligjore në bazë të barabartë me të tjerët në të gjitha aspektet e jetës.

3. Shtetet palë do të marrin masat e duhura për të siguruar mundësimin ndaj personave me aftësi të kufizuara për mbështetjen që ata mund të kërkojnë në ushtrimin e kapacitetit të tyre ligjor.

4. Shtetet palë do të sigurojnë se të gjitha masat që lidhen me ushtrimin e zotësisë ligjore sigurojnë masat mbrojtëse të duhura dhe efektive për të parandaluar abuzimin në përputhje me të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Masa të tilla mbrojtëse do të sigurojnë se masat e lidhura me ushtrimin e zotësisë ligjore respektojnë të drejtat, vullnetin dhe preferencat e personit, nuk kanë konflikt interesi dhe ndikim të panevojshëm, janë në proporcion dhe të përshtatura sipas rrethanave të personit, aplikohen për periudhën më të shkurtër të mundshme dhe u nënshtrohen rishikimeve të rregullta të një autoriteti kompetent, të pavarur dhe të paanshëm apo një organi gjyqësor. Masat mbrojtëse do të jenë proporcionale, në shkallën ku masa të tilla prekin të drejtat dhe interesat e personit.

5. Në bazë të dispozitave të këtij neni, shtetet palë do të marrin të gjitha masat e duhura dhe efektive për të siguruar të drejtën e barabartë të personave me aftësi të kufizuara për të pasur në pronësi apo për të trashëguar prona, për të kontrolluar çështjet e tyre financiare dhe për të pasur mundësi të barabartë në kredi bankare, hipoteka dhe forma të tjera të kredive financiare, dhe do të sigurojë se personave me aftësi të kufizuara nuk u hiqet prona në mënyrë arbitrare.

#### Neni 13

### **Mundësimi i drejtësisë**

1. Shtetet palë duhet të sigurojnë akses efektiv në drejtësi për personat me aftësi të kufizuara në baza të barabarta me të tjerët, përfshirë nëpërmjet sigurimit të mundësive të përshtatshme procedurale





dhe të moshës, me qëllim që të lehtësohet roli i tyre efektiv si pjesëmarrës direkt dhe jodirekt, përfshirë dhe si dëshmitarë, në të gjitha gjykimet, përfshirë hetimet dhe stadi të tjera paraprake.

2. Me qëllim që të jepet ndihmesë në sigurimin e mundësisë efektive në drejtësi për personat me aftësi të kufizuara, shtetet palë duhet të promovojnë trajnime për ata persona që punojnë në fushën e administrimit të drejtësisë, përfshirë policinë dhe personelin e burgut.

#### Neni 14

### **Liria dhe siguria e personit**

1. Shtetet palë duhet të sigurojnë se personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët:

a) gëzojnë të drejtën për lirinë dhe sigurinë e personit;

b) nuk u hiqet liria në mënyrë të paligjshme dhe arbitrare, dhe se çdo heqje lirie është në përputhje me ligjin, dhe se ekzistenca e aftësisë së kufizuar nuk duhet në asnjë rast të justifikojë heqjen e lirisë.

2. Shtetet palë duhet të sigurojnë se nëse personave me aftësi të kufizuara u është hequr liria nëpërmjet çfarëdo lloj procesi, mbi baza të barabarta me të tjerët, ata kanë të drejtë për garanci në përputhje me të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe duhet të trajtohen në përputhje me objektivat dhe parimet e kësaj konvente, përfshirë sigurimin e akomodimit të arsyeshëm.

#### Neni 15

### **Lirimi nga tortura, trajtimi i egër, çnjerëzor apo degradues**

1. Askush nuk duhet t'i nënshtrohet torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor apo degradues. Në veçanti, askush nuk duhet t'i nënshtrohet eksperimentimit mjekësor apo shkencor pa pëlqimin e saj/tij të lirë.

2. Shtetet palë duhet të marrin të gjitha masat efektive legjislative, administrative, gjyqësore apo masa të tjera për të parandaluar që personat me aftësi të kufizuara, në bazë të barabartë me të tjerët, t'u nënshtrohen torturës apo trajtimit apo dënimit të egër, çnjerëzor apo degradues.

#### Neni 16

### **Lirimi nga shfrytëzimi, dhuna dhe abuzimi**

1. Shtetet palë duhet të marrin masat e duhura legjislative, administrative, shoqërore, arsimore dhe masa të tjera për të mbrojtur personat me aftësi të kufizuara, si brenda familjes dhe jashtë saj, nga të gjitha format e shfrytëzimit, dhunës dhe abuzimit, përfshirë aspektet me bazë gjinore.

2. Shtetet palë duhet të marrin gjithashtu të gjitha masat e duhura për të parandaluar të gjitha format e shfrytëzimit, dhunës dhe abuzimit, duke siguruar, ndër të tjera, format e duhura të asistencës në bazë të gjinisë dhe moshës dhe mbështetje për personat me aftësi të kufizuara, familjeve të tyre dhe punonjësve të kujdesit, përfshirë nëpërmjet sigurimit të informacionit dhe edukimit se si të shmangen, njihen apo raportohen rastet e shfrytëzimit, dhunës apo abuzimit. Shtetet palë duhet të sigurojnë se shërbimet e mbrojtjes tregojnë ndjeshmëri ndaj moshës, gjinisë dhe aftësisë së kufizuar.

3. Me qëllim që të parandalohen të gjitha format e shfrytëzimit, dhunës dhe abuzimit, shtetet palë duhet të sigurojnë që të gjitha mjetet dhe programet e projektuara për t'u shërbyer personave me aftësi të kufizuara të monitorohen në mënyrë efektive nga autoritete të pavarura.

4. Shtetet palë duhet të marrin të gjitha masat e duhura për të promovuar shërimin dhe rehabilitimin fizik, njohës dhe psikologjik dhe riintegrimin shoqëror të personave me aftësi të kufizuara, të cilët janë viktimë të çdo lloj forme shfrytëzimi, dhune apo abuzimi, përfshirë nëpërmjet sigurimit të shërbimeve mbrojtëse. Një shërim dhe riintegrim i tillë duhet të ndodhë në një ambient që mbështet shëndetin, mirëqenien, vetërespektin, dinjitetin dhe autonominë e personit dhe merr parasysh nevojat specifike gjinore dhe të moshës.

5. Shtetet palë duhet të sigurojnë legjislacionin dhe politika efektive, përfshirë legjislacionin dhe politikat në lidhje me gratë dhe fëmijët, për të siguruar se janë identifikuar, hetuar dhe kur duhet, janë ndjekur ligjërisht rastet e shfrytëzimit, dhunës dhe abuzimit ndaj personave me aftësi të kufizuara.

#### Neni 17

### **Mbrojtja e integritetit të personit**

Çdo person me aftësi të kufizuara ka të drejtën për respekt ndaj integritetit të saj apo të tij fizik dhe mendor në bazë të barabartë me të tjerët.

#### Neni 18

### **Liria e lëvizjes dhe shtetësia**

1. Shtetet palë duhet të njohin të drejtat e personave me aftësi të kufizuara për lirinë e lëvizjes, lirinë për të zgjedhur rezidencën dhe shtetësinë e tyre, në baza të barabarta me të tjerët, përfshirë dhe sigurimin e faktit se personat me aftësi të kufizuara:

a) kanë të drejtë të marrin dhe ndryshojnë shtetësinë dhe nuk u hiqet shtetësia në mënyrë arbitrare apo në bazë të aftësisë së kufizuara;

b) nuk iu hiqet mundësia, në bazë të aftësisë së kufizuara, për të marrë, pasur dhe përdorur dokumentacionin e shtetësisë së tyre apo dokumentacion tjetër identifikues, apo për të përdorur proceset përkatëse, të tilla si procedurat e imigrimit, që mund të nevojiten për të lehtësuar ushtrimin e të drejtës për lirinë e lëvizjes;

c) janë të lirë të largohen nga çdo vend/shtet, përfshirë dhe vendin/shtetin e tyre;

d) nuk iu hiqet e drejta, në mënyrë arbitrare apo në bazë të aftësisë së kufizuara, për të hyrë në vendin/shtetin e tyre.

2. Fëmijët me aftësi të kufizuara duhet të regjistrohen menjëherë pas lindjes dhe që nga lindja duhet të kenë të drejtën për një emër, të drejtën për të marrë një shtetësi dhe, sa më shpejt të jetë e mundur, të drejtën për të njohur dhe për të pasur kujdesin e prindërve.

#### Neni 19

### **Jetesa e pavarur dhe përfshirja në komunitet**

Shtetet palë në këtë konventë pranojnë të drejtën e barabartë të të gjithë personave me aftësi të kufizuara për të jetuar në komunitet, me zgjedhje të barabarta me të tjerët, dhe duhet të marrin masat e duhura dhe efektive për të mundësuar që personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë plotësisht këtë të drejtë dhe përfshirjen e pjesëmarrjen e tyre të plotë në komunitet, përfshirë dhe sigurimin e faktit se:

a) Personat me aftësi të kufizuara kanë mundësinë për të zgjedhur vendin e tyre të banimit, ku dhe me kë do të jetojnë në baza të barabarta me të tjerët dhe nuk janë të detyruar të jetojnë në një mënyrë të veçantë të caktuar jetese;

b) Personat me aftësi të kufizuara kanë mundësi për një gamë të gjerë shërbimesh mbështetëse në shtëpi, shërbime rezidenciale dhe shërbime në komunitetet, dhe për parandalimin e izolimit dhe veçimit nga komuniteti;

c) Shërbimet dhe mjetet komunitare për popullatën në përgjithësi janë të disponueshme në baza të barabarta për personat me aftësi të kufizuara dhe u përgjigjen nevojave të tyre.

#### Neni 20

### **Lëvizshmëria personale**

Shtetet palë duhet të marrin masat efektive për të siguruar lëvizshmërinë personale me pavarësinë më të madhe të mundshme për personat me aftësi të kufizuara, si më poshtë:

a) Lehtësimin e lëvizshmërisë personale të personave me aftësi të kufizuara sipas mënyrës dhe kohës së zgjedhur prej tyre, dhe me kosto të përballueshme;



b) Lehtësimin e mundësimit për personat me aftësi të kufizuara në mjetet lëvizëse, pajisjet, teknologjitë ndihmëse dhe format e asistencës direkte dhe të ndërmjetme, përfshirë sigurimin e tyre me kosto të përballeshme;

c) Sigurimin e trajnimit lidhur me aftësitë lëvizëse të personave me aftësi të kufizuara dhe stafit të specializuar që punon me personat me aftësi të kufizuara;

d) Inkurajimin e subjekteve që prodhojnë mjete lëvizëse, pajisje dhe teknologji ndihmëse të marrin parasysh të gjitha aspektet e lëvizjes së personave me aftësi të kufizuara.

#### Neni 21

### **Liria e të shprehurit dhe mendimit, dhe mundësi i informacionit**

Shtetet palë duhet të marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar se personat me aftësi të kufizuara mund të ushtrojnë të drejtën e tyre të të shprehurit dhe mendimit, përfshirë lirinë për të kërkuar, marrë dhe përhapur informacionin dhe idetë në baza të barabarta me të tjerët dhe nëpërmjet të gjitha formave të komunikimit sipas zgjedhjes së tyre, siç përcaktohen në nenin 2 të kësaj konvente, si më poshtë:

a) Sigurimin e informacionit të synuar për publikun e gjerë ndaj personave me aftësi të kufizuara në formate dhe teknologji të realizueshme e të përshtatshme për lloje të ndryshme të aftësisë së kufizuar në kohën e duhur dhe pa kosto shtesë;

b) Pranimin dhe lehtësimin e përdorimit të gjuhës së shenjave, *Braille*, komunikimit shtesë dhe alternativ, dhe e të gjitha mjeteve, mënyrave dhe formave të tjera të komunikimit të realizueshme sipas zgjedhjes së personave me aftësi të kufizuara në ndërveprimet zyrtare;

c) Nxitjen e subjekteve private që sigurojnë shërbime për publikun e gjerë, përfshirë dhe internetin, që të sigurojnë informacion dhe shërbime në formate të realizueshme dhe të përdorshme për personat me aftësi të kufizuara;

d) Inkurajimin e masmedias, përfshirë dhe sigurimin e informacionit nëpërmjet internetit, për t'i bërë shërbimet e tyre të mundshme për personat me aftësi të kufizuara;

e) Njohjen dhe promovimin e përdorimit të gjuhës së shenjave.

#### Neni 22

### **Respektimi i jetës private**

1. Asnjë person me aftësi të kufizuar, pavarësisht nga vendqëndrimi apo mënyra e jetesës, nuk duhet t'u nënshtrohet ndërhyrjeve arbitrare apo të paligjshme në jetën private të tij apo të saj, në familjen, korrespondencën, llojet e tjera të komunikimit apo t'u nënshtrohet sulmeve të paligjshme ndaj nderit apo reputacionit të tij/saj. Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtën të mbrohen nga ligji ndaj këtyre ndërhyrjeve dhe sulmeve.

2. Shtetet palë mbrojnë fshhtësinë e informacionit personal për shëndetin dhe rehabilitimin e personave me aftësi të kufizuara në baza të barabarta me të tjerët.

#### Neni 23

### **Respektimi i shtëpisë dhe familjes**

1. Shtetet palë duhet të marrin masat e duhura dhe efektive për të eliminuar diskriminimin ndaj personave me aftësi të kufizuara në të gjitha çështjet lidhur me martesën, familjen, prindërimin dhe raportet njerëzore, në bazë të barabartë me të tjerët, për të siguruar se:

a) njihet e drejta e të gjithë personave me aftësi të kufizuara, të cilët janë në një moshë për martesë, për t'u martuar dhe për të krijuar një familje bazuar në pëlqimin e lirë dhe të plotë të çiftit;

b) njihen të drejtat e personave me aftësi të kufizuara për të vendosur lirshëm dhe me përgjegjësi për numrin dhe hapësirën e fëmijëve të tyre dhe të kenë mundësi informacioni sipas moshës, edukim mbi planifikimin familjar dhe riprodhimin, si dhe sigurohen mjetet e nevojshme që i mundësojnë ata të ushtrojnë këto të drejta.

c) personat me aftësi të kufizuara, përfshirë fëmijët, ruajnë aftësinë riprodhuese e tyre në bazë të barabartë me të tjerët.

2. Shtetet palë sigurojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e personave me aftësi të kufizuara lidhur me kujdestarinë, ruajtjen dhe birësimin e fëmijëve apo institucione të ngjashme ku këto koncepte ekzistojnë në legjislacionin kombëtar; në të gjitha rastet interesi i lartë i fëmijës do të jetë dominues. Shtetet palë duhet të japin asistencën e duhur ndaj personave me aftësi të kufizuara në përmbushjen e përgjegjësiave për rritjen e fëmijëve të tyre.

3. Shtetet palë duhet të sigurojnë se fëmijët me aftësi të kufizuara kanë të drejta të barabarta lidhur me jetën në familje. Me qëllim realizimin e këtyre të drejtave dhe parandalimin e fshehjes, të braktisjes, neglizhimit dhe izolimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, shtetet palë duhet të marrin përsipër të sigurojnë informacion, shërbime dhe mbështetje të hershme dhe të gjithanshme për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre.

4. Shtetet palë duhet të sigurojnë se fëmija nuk duhet të ndahet nga prindërit e tij apo të saj kundër dëshirës së tyre, përveç rasteve kur autoritetet kompetente sipas rishikimit gjyqësor përcaktojnë, në përputhje me ligjet dhe procedurat e zbatueshme, që një ndarje e tillë është e domosdoshme për interesin më të mirë të fëmijës. Në asnjë mënyrë nuk duhet ndarë një fëmijë nga prindërit bazuar në aftësinë e kufizuar të fëmijës apo në aftësinë e kufizuar të njërit apo të dy prindërve.

5. Shtetet palë, në rastet kur rrethi më i afërt familjar nuk është në gjendje të kujdeset për fëmijën me aftësi të kufizuar, do të ndërmarrë çdo përpjekje për të siguruar kujdes alternativ brenda familjes së zgjeruar, dhe në rast se dështon, brenda komunitetit në një ambient familjeje.

#### Neni 24 **Edukimi**

1. Shtetet palë njohin të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për edukim. Me qëllim që të realizohet kjo e drejtë pa diskriminim dhe në bazë të mundësive të barabarta, shtetet palë duhet të sigurojnë një sistem edukimi përfshirës në të gjitha nivelet, dhe të mësuar gjatë gjithë jetës, të drejtuar nga:

- a) zhvillimi i plotë i potencialit njerëzor dhe sensit të dinjitetit dhe vlerës së vetvetes, fuqizimit të respektit për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, dhe diversitetit njerëzor;
- b) zhvillimi nga personat me aftësi të kufizuara të personalitetit, talenteve dhe krijimtarisë së tyre, si dhe aftësive të tyre mendore dhe fizike, në potencialin e tyre të plotë;
- c) mundësimin e personave me aftësi të kufizuara për të marrë pjesë në mënyrë efektive në një shoqëri të lirë.

2. Për të realizuar këtë të drejtë, shtetet palë duhet të sigurojnë se:

- a) personat me aftësi të kufizuara nuk janë përjashtuar nga sistemi i edukimit të përgjithshëm për shkak të aftësisë së kufizuar, dhe se fëmijët me aftësi të kufizuara nuk janë përjashtuar nga arsimi pa pagesë dhe i detyruar fillor, ose arsimi i mesëm, me bazë aftësinë e kufizuar;
- b) personat me aftësi të kufizuara mund të kenë mundësinë për edukimin fillor gjithëpërfshirës, cilësor dhe pa pagesë dhe arsimin tetëvjeçar në baza të barabarta me të tjerët në komunitetet ku ata jetojnë;
- c) sigurohet akomodimi i arsyeshëm i kërkesave individuale;
- d) personat me aftësi të kufizuara marrin mbështetjen e kërkuar brenda sistemit të edukimit të përgjithshëm, për të mundësuar arsimimin e tyre efektiv.
- e) sigurohen masa mbështetëse efektive të individualizuara në ambiente që rrisin zhvillimin akademik dhe shoqëror, në pajtim me qëllimin për përfshirje të plotë.

3. Shtetet palë duhet të mundësojnë personat me aftësi të kufizuara të mësojnë mjeshteri për zhvillim shoqëror dhe jetësor për të lehtësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe të barabartë në edukim dhe si anëtarë të komunitetit. Për këtë qëllim shtetet palë duhet të marrin masat e duhura, përfshirë:

- a) lehtësimin e të mësuarit të *Braille*, shkrimeve alternative, mënyrave shpesh dhe alternative, mjeteve dhe formateve të komunikimit, aftësive të orientimit dhe lëvizshmërisë, dhe lehtësim të mbështetjes dhe kujdesit nga moshatarët;



b) lehtësimin e të mësuarit të gjuhës së shenjave dhe promovimin e identitetit linguistik të komunitetit të personave që nuk dëgjojnë;

c) sigurimin e faktit se edukimi i personave, dhe në veçanti i fëmijëve të cilët janë të verbër, që nuk dëgjojnë apo që nuk dëgjojnë e nuk shikojnë, në të njëjtën kohë u është dhënë në gjuhën, mënyrat dhe mjetet e komunikimit më të përshtatshme për individin dhe në ambiente të cilat rrisin zhvillimin akademik dhe shoqëror.

4. Me qëllim që të sigurohet realizimi i kësaj të drejte, shtetet palë duhet të marrin masat e duhura për të punësuar mësuesit, përfshirë mësuesit me aftësi të kufizuara, të cilët janë të kualifikuar në gjuhën e shenjave dhe/apo *Braille*, dhe të trajnojnë profesionistët dhe stafin që punon në të gjitha nivelet e edukimit. Trajnime të tilla duhet të përfshijnë ndërgjegjësimin mbi aftësinë e kufizuar dhe përdorimin e mënyrave të duhura shpesh dhe alternative, mjeteve dhe formateve të komunikimit, teknikave edukuese dhe materialeve për të mbështetur personat me aftësi të kufizuara.

5. Shtetet palë duhet të sigurojnë që personat me aftësi të kufizuara të jenë në gjendje të kenë mundësi për arsimin e lartë, trajnime profesionale, edukimin për të rritur dhe të mësuarit gjatë të gjithë jetës pa diskriminim dhe në baza të barabarta me të tjerët. Për këtë qëllim, shtetet palë duhet të sigurojnë që akomodimi i arsyeshëm është siguruar për personat me aftësi të kufizuara.

#### Neni 25

#### **Shëndeti**

Shtetet palë pranojnë se personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtën të gëzojnë standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit pa diskriminim mbi bazë aftësinë e kufizuar. Shtetet palë duhet të marrin masat e duhura për të siguruar mundësimin për personat me aftësi të kufizuara të shërbimet shëndetësore të lidhura me gjininë, përfshirë rehabilitimin në lidhje me shëndetin. Në veçanti, shtetet palë:

a) do të sigurojnë për personat me aftësi të kufizuara të njëjtën gamë, cilësi dhe standarde të shërbimeve shëndetësore pa pagesë ose të përbalueshme, siç u sigurohet personave të tjerë, përfshirë programe të shëndetit publik me bazë popullsinë në fushat e shëndetit riprodhues dhe seksual;

b) do të sigurojnë ato shërbime shëndetësore të nevojshme për personat me aftësi të kufizuara, për shkak të aftësisë së tyre të kufizuar, përfshirë dhe identifikimin e hershëm dhe ndërhyrjen sipas rastit, si dhe shërbime të planifikuara, për të minimizuar dhe parandaluar përkeqësimin e aftësive të kufizuara, përfshirë ato të fëmijët dhe të moshuarit;

c) do të sigurojnë këto shërbime shëndetësore sa më pranë të jetë e mundur komuniteteve të këtyre personave, përfshirë zonat rurale;

d) do të kërkojnë profesionistë të kujdesit shëndetësor për të siguruar kujdes të së njëjtës cilësi për personat me aftësi të kufizuara si për të tjerët, përfshirë dhe faktin se në bazë të pëlqimit të lirë dhe të informuar, ndër të tjera, të rrisë ndërgjegjësimin mbi të drejtat, dinjitetin, autonominë e njeriut dhe nevojave të personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet trajnimeve dhe shpalljes së standardeve etike për kujdesin shëndetësor publik dhe privat;

e) do të ndalojnë diskriminimin ndaj personave me aftësi të kufizuara në realizimin e sigurimit shëndetësor dhe sigurimit për jetën, kur një sigurim i tillë lejohet nga ligji kombëtar, i cili duhet të sigurohet në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme;

f) do të parandalojë mohimin diskriminues të kujdesit shëndetësor, shërbimeve shëndetësore apo të ushqimeve dhe pijeve mbi bazën e aftësisë së kufizuar.

#### Neni 26

#### **Aftësimi dhe rehabilitimi**

1. Shtetet palë duhet të marrin masat e duhura dhe efektive, përfshirë dhe mbështetjen e moshatarëve, për të bërë të mundur që personat me aftësi të kufizuara të arrijnë dhe të ruajnë pavarësinë e tyre maksimale, aftësinë e plotë fizike, mendore, shoqërore dhe profesionale, dhe përfshirjen e pjesëmarrjen e plotë në të gjitha aspektet e jetës. Për këtë qëllim, shtetet palë do të organizojnë, fuqizojnë

dhe zgjerojnë shërbimet aftësuese dhe rehabilituese gjithëpërfshirëse, veçanërisht në fushat e shërbimeve të shëndetit, punësimit, edukimit dhe shërbimeve shoqërore, në mënyrë të tillë që këto shërbime dhe programe:

a) të fillojnë në fazën më të hershme të mundshme dhe të jenë të bazuara në vlerësimet multidisiplinore të nevojave dhe pikave të forta;

b) të mbështesin pjesëmarrjen dhe përfshirjen në komunitet dhe në të gjitha aspektet e shoqërisë, dhe të jenë me bazë vullnetare, dhe të disponueshme për personat me aftësi të kufizuara sa më pranë komuniteteve të tyre të jetë e mundur, përfshirë zonat rurale.

2. Shtetet palë duhet të promovojnë zhvillimin e trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm për profesionistët dhe stafin që punon në shërbimet aftësuese dhe rehabilituese.

3. Shtetet palë duhet të promovojnë ekzistencën, njohuritë dhe përdorimin e pajisjeve ndihmëse dhe teknologjisë, të projektuar për personat me aftësi të kufizuara, pasi ato lidhen me aftësimin dhe rehabilitimin.

#### Neni 27

#### **Puna dhe punësimi**

1. Shtetet palë njohin të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për të punuar, në baza të barabarta me të tjerët; kjo përfshin të drejtën për të pasur mundësinë për të fituar jetesën, duke bërë punë të zgjedhur lirisht apo të pranuar në tregun e punës dhe ambientin e punës që është i hapur, përfshirës dhe i arritshëm nga personat me aftësi të kufizuara. Shtetet palë duhet të mbrojnë dhe promovojnë realizimin e së drejtës për punë, përfshirë dhe ata që e fitojnë aftësinë e kufizuar gjatë punësimit, duke marrë hapat e duhur, përfshirë nëpërmjet legjisllacionit, ndër të tjera:

a) Për të ndaluar diskriminimin me bazë aftësinë e kufizuar në të gjitha çështjet lidhur me punësimin, përfshirë kushtet e rekrutimit, punësimit, vazhdimësisë së punësimit, përparimit në karrierë dhe ofrimin e kushteve të punës të sigurta dhe të shëndetshme;

b) Për të mbrojtur të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, duke përfshirë mundësi të barabarta dhe pagesë të barabartë për punën me vlerë, siguri dhe kushte pune të shëndetshme të barabarta, përfshirë dhe mbrojtjen nga ngacmimet dhe trajtimin e ankesave;

c) Për të siguruar se personat me aftësi të kufizuara janë në gjendje të ushtrojnë të drejtat e punës dhe të drejtat sindikaliste në baza të barabarta me të tjerët;

d) Për të mundësuar personat me aftësi të kufizuara për të pasur mundësi efektive për programet e përgjithshme udhëzuese teknike dhe profesionale, shërbimet e vendosjes në vendin e punës dhe trajnim të vazhdueshëm profesional;

e) Për të promovuar mundësitë dhe përparimin në karrierë për personat me aftësi të kufizuara në tregun e punës, si dhe asistencë në gjetjen, fitimin, mbajtjen dhe kthimin në punë;

f) Për të promovuar mundësitë për vetëpunësim, aktivitet të lirë privat, zhvillimin e kooperativave dhe për të filluar biznesin e vet;

g) Për të punësuar personat me aftësi të kufizuara në sektorin publik;

h) Për të promovuar punësimin e personave me aftësi të kufizuara në sektorin privat nëpërmjet politikave dhe masave të duhura, të cilat mund të përfshijnë programe veprimi afirmative, nxitëse dhe masa të tjera;

i) Për të siguruar se akomodimi i arsyeshëm u është siguruar personave me aftësi të kufizuara në vendin e punës;

j) Për të promovuar fitimin e përvojës së punës nga personat me aftësi të kufizuara në tregun e hapur të punës;

k) Për të promovuar programe për rehabilitim profesional, mbajtjen e vendit të punës dhe kthimit në punë për personat me aftësi të kufizuara.

2. Shtetet palë duhet të sigurojnë se personat me aftësi të kufizuara nuk mbahen në skllavëri apo si shërbëtorë dhe janë të mbrojtur, në baza të barabarta me të tjerët, nga puna e detyruar.



## Neni 28

### Standardi i përshtatshëm i jetesës dhe mbrojtja shoqërore

1. Shtetet palë njohin të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për një standard të përshtatshëm jetese për ta dhe për familjet e tyre, përfshirë ushqimin, veshjen dhe strehimin e përshtatshëm dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetesës dhe duhet të ndërmarrin hapat e duhur për të mbrojtur dhe përmirësuar realizimin e kësaj të drejte pa diskriminim me bazë aftësinë e kufizuar.

2. Shtetet palë njohin të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për mbrojtje shoqërore, dhe që ata ta gëzojnë atë të drejtë pa diskriminim me bazë aftësinë e kufizuar dhe duhet të marrin hapat e duhur për të mbrojtur dhe përmirësuar realizimin e kësaj të drejte, përfshirë masat:

a) Për t'u siguruar mundësim të barabartë personave me aftësi të kufizuara ndaj shërbimeve për ujë të pastër dhe për të siguruar mundësimin e shërbimeve, pajisjeve dhe formave të tjera të asistencës të përshtatshme dhe të përballeshme për nevoja të lidhura me aftësinë e kufizuar;

b) Për të siguruar mundësi për personat me aftësi të kufizuara në veçanti gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara dhe personat më të moshuar me aftësi të kufizuara, në programet e mbrojtjes shoqërore dhe programeve të reduktimit të varfërisë;

c) Për të siguruar mundësi për personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre që jetojnë në kushtet e varfërisë, në asistencën e ofruar nga shteti me shpenzime lidhur me aftësinë e kufizuar, përfshirë trajnimin, këshillimin, ndihmën financiare dhe kujdesin gjatë pushimeve;

d) Për të siguruar mundësi për personat me aftësi të kufizuara në programet e strehimit publik;

e) Për të siguruar mundësi të barabartë për personat me aftësi të kufizuara nga programet dhe përfitimet e pensionit.

## Neni 29

### Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike

Shtetet palë duhet t'u garantojnë personave me aftësi të kufizuara të drejtat politike dhe mundësinë për t'i gëzuar ato në baza të barabarta me të tjerët dhe duhet të marrin përsipër:

a) Të sigurojnë se personat me aftësi të kufizuara mund të marrin pjesë në mënyrë të plotë dhe efektive në jetën politike dhe publike mbi bazë të barabartë me të tjerët, drejtpërsëdrejti apo nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, përfshirë dhe të drejtën dhe mundësinë për personat me aftësi të kufizuara për të votuar dhe për t'u zgjedhur, ndër të tjera duke:

i) siguruar që procedurat, mjetet dhe materialet e votimit të jenë të përshtatshme, të mundshme dhe të thjeshta për t'u kuptuar dhe përdorur;

ii) mbrojtur të drejtën e personave me aftësi të kufizuara të votojnë me votë të fshehtë në zgjedhje dhe referendume publike, pa kërcënim, të kandidojnë për zgjedhje, të punojnë në zyrë në mënyrë efektive dhe të kryejnë të gjitha funksionet publike në të gjitha nivelet e qeverisë, duke lehtësuar përdorimin e teknologjive ndihmëse dhe të reja, kur të jetë e përshtatshme;

iii) garantuar shprehjen e lirë të vullnetit të lirë të personave me aftësi të kufizuara si zgjedhës dhe për këtë qëllim, kur është e nevojshme, me kërkesën e tyre, lejohet asistencë në votim nga një person që zgjidhet prej tyre,

b) Promovimin në mënyrë aktive një ambient në të cilin personat me aftësi të kufizuara mund të marrin pjesë në mënyrë efektive dhe të plotë në kryerjen e punëve publike, pa diskriminim dhe në një bazë të barabartë me të tjerët dhe të inkurajojë pjesëmarrjen e tyre në punët publike, përfshirë:

i) pjesëmarrjen në organizatat joqeveritare dhe shoqatat që kanë të bëjnë me jetën publike dhe politike në vend dhe në aktivitetet dhe administrimin e partive politike;

ii) krijimin apo pjesëmarrjen në organizata për personat me aftësi të kufizuara për të përfaqësuar personat me aftësi të kufizuara në nivele ndërkombëtare, kombëtare, rajonale dhe lokale.

Neni 30

**Pjesëmarrja në jetën kulturore, argëtim, kohën e lirë dhe sport**

1. Shtetet palë njohin të drejtën e personave me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në bazë të barabartë me të tjerët në jetën kulturore dhe duhet të marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar se personat me aftësi të kufizuara:

- a) gëzojnë mundësimin për materialet kulturore në të gjitha formatet e realizueshme;
- b) gëzojnë mundësimin për programet televizive, filmat, teatrot dhe aktivitete të tjera kulturore, në formate të realizueshme;
- c) gëzojnë mundësimin në vendet për punë apo shërbime kulturore, të tilla si: teatrot, muzetë, kinematë, bibliotekat dhe shërbimet për turistët dhe aq sa është e mundur, gëzojnë mundësi hyrjeje për në monumentet dhe sheshet me rëndësi për kulturën kombëtare.

2. Shtetet palë duhet të marrin masat e duhura për të bërë të mundur që personat me aftësi të kufizuara të kenë mundësinë për të zhvilluar dhe përdorur potencialin e tyre krijues, artistik dhe intelektual, jo vetëm për të mirën e tyre, por edhe për pasurimin e shoqërisë.

3. Shtetet palë duhet të marrin hapat e duhur në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, për të siguruar se ligjet që mbrojnë të drejtat e pronësisë intelektuale nuk përbëjnë një barrierë të paarsyeshme apo diskriminuese që personat me aftësi të kufizuara të kenë mundësinë e materialeve kulturore.

4. Personat me aftësi të kufizuara duhet të kenë të drejtën, në baza të barabarta me të tjerët, që t'u njihet dhe të mbështetet identiteti i tyre specifik kulturor dhe linguistik, përfshirë dhe gjuhën e shenjave dhe kulturën e të shurdhërve.

5. Me idenë për të mundësuar që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në aktivitete, argëtuese, të kohës së lirë dhe sportive, shtetet palë duhet të marrin masat e duhura:

- a) Për të inkurajuar dhe promovuar pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në aktivitetet sportive gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet, në masën më të madhe të mundshme;
- b) Për të siguruar se personat me aftësi të kufizuara kanë mundësinë të organizojnë, zhvillojnë dhe marrin pjesë në aktivitete sportive specifike për aftësinë e kufizuar dhe argëtuese dhe për këtë qëllim, të inkurajojë sigurimin e udhëzimeve, trajnimit dhe burimeve të duhura, në baza të barabarta me të tjerët;
- c) Për të siguruar se personat me aftësi të kufizuara kanë mundësi hyrjeje në vendet sportive, argëtuese dhe turistike;
- d) Për të siguruar se fëmijët me aftësi të kufizuara kanë mundësi të barabartë për të marrë pjesë në lojë, argëtim, aktivitete sportive dhe të kohës së lirë, përfshirë dhe ato aktivitete që zhvillohen në sistemin shkollor;
- e) Për të siguruar se personat me aftësi të kufizuara kanë mundësi në shërbimet nga ato që përfshihen në organizimin e aktiviteteve argëtuese, turistike, sportive dhe të kohës së lirë.

Neni 31

**Statistikat dhe mbledhja e të dhënave**

1. Shtetet palë marrin përsipër të mbledhin informacionin e duhur, përfshirë të dhëna statistikore dhe kërkimore, për të mundur që këto shtete të formulojnë dhe zbatojnë politika që do i japin fuqi kësaj konvente. Procesi i mbledhjes dhe i mbajtjes së këtij informacioni:

- a) duhet të jetë në përputhje me masat mbrojtëse ligjore, përfshirë legjislacionin mbi mbrojtjen e të dhënave, për të siguruar fshehtësinë dhe respektimin e jetës private të personit me aftësi të kufizuar;
- b) duhet të jetë në përputhje me normat ndërkombëtare të pranuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, si dhe parimet etike në mbledhjen dhe përdorimin e statistikave.

2. Informacioni i mbledhur në përputhje me këtë nen mund të shpërndalet sipas rastit dhe përdoret për të ndihmuar për të vlerësuar zbatimin e detyrimeve të shteteve palë në këtë konventë, dhe të identifikojë dhe adresojë barrierat që ndeshen nga personat me aftësi të kufizuara gjatë ushtrimit të të drejtave të tyre.





3. Shtetet palë marrin përgjegjësinë për përhapjen e këtyre statistikave dhe sigurojnë që ato të jenë të mundshme për personat me aftësi të kufizuara dhe për të tjerët.

#### Neni 32

### **Bashkëpunimi ndërkombëtar**

1. Shtetet palë pranojnë rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe promovimin e tij, në mbështetje të përpjekjeve kombëtare për realizimin e qëllimit dhe objektivave të kësaj konvente dhe do të ndërmarrin masat e duhura dhe efektive në këtë drejtim, ndërmjet shteteve dhe sipas rastit në partneritet me organizatat përkatëse ndërkombëtare dhe rajonale dhe shoqërinë civile, në veçanti organizatat për personat me aftësi të kufizuara. Këto masa mund të përfshijnë ndër të tjera:

a) të sigurojnë se bashkëpunimi ndërkombëtar, përfshirë dhe programet ndërkombëtare të zhvillimit, të jenë përfshirëse dhe të mundshme për personat me aftësi të kufizuara;

b) të lehtësojnë dhe mbështesin krijimin e kapaciteteve, përfshirë faktin e shkëmbimit dhe ndarjes së informacionit, përvojës, programeve të trajnimit dhe praktikës më të mirë;

c) të lehtësojnë bashkëpunimin në punën kërkimore dhe mundësimin e njohurive shkencore dhe teknike; dhe

d) të sigurojnë, sipas rastit, asistencë teknike dhe ekonomike, përfshirë dhe lehtësimin e mundësimit dhe përdorimin e përbashkët të teknologjisë ndihmëse dhe të mundshme dhe nëpërmjet transferimit të teknologjisë.

2. Dispozitat e këtij neni nuk cenojnë detyrimet e secilit shtet palë për të plotësuar detyrimet e tij në këtë konventë.

#### Neni 33

### **Zbatimi dhe monitorimi kombëtar**

1. Shtetet palë, në përputhje me sistemin e tyre të organizimit, duhet të caktojnë një apo më shumë pika kontakti në qeveri për çështje që kanë të bëjnë me zbatimin e kësaj konvente dhe duhet të shqyrtojnë ngritjen apo caktimin e një mekanizmi bashkëpunimi brenda qeverisë për të lehtësuar veprimet e lidhura me të në sektorë të ndryshëm dhe në nivele të ndryshme.

2. Shtetet palë, në përputhje me sistemet e tyre ligjore dhe administrative, mbajnë, fuqizojnë, caktojnë ose ngrenë brenda shtetit palë, një kuadër, i cili do të përfshijë një apo më shumë mekanizma të pavarur, si të jetë më e përshtatshme, për të promovuar, mbrojtur dhe monitoruar zbatimin e kësaj konvente. Gjatë caktimit apo ngritjes së një mekanizmi të tillë, shtetet palë duhet të kenë parasysh parimet lidhur me statusin dhe funksionimin e institucioneve kombëtare për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut.

3. Shoqëria civile dhe veçanërisht personat me aftësi të kufizuara dhe organizatat e tyre përfaqësuese, duhet të përfshihen dhe të marrin pjesë plotësisht në procesin monitorues.

#### Neni 34

### **Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara**

1. Do të ngrihet një Komitet për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (më poshtë quhet “Komiteti”), i cili do të kryejë funksionet e paraqitura më poshtë.

2. Komiteti, në momentin kur kjo konventë hyn në fuqi, do të përbëhet prej dymbëdhjetë ekspertësh. Pas gjashtëdhjetë ratifikimesh apo aderimesh shtesë në konventë, anëtarësia e Komitetit do të shtohet me gjashtë anëtarë, duke ruajtur një numër maksimal prej tetëmbëdhjetë anëtarësh.

3. Anëtarët e Komitetit do të shërbejnë në zotësinë e tyre personale dhe do të jenë me një qëndrim të lartë moral dhe kompetencë e përvojë të njohur në fushën e paraqitur në këtë konventë. Shtetet palë ftohen t’i kushtojnë vëmendjen e duhur dispozitës së parashtruar në nenin 4.3 të kësaj konvente, kur bëjnë caktimin e kandidatëve të tyre.

4. Anëtarët e Komitetit do të zgjidhen nga shtetet palë, ku do t'u kushtohet vëmendje shpërndarjes së barabartë gjeografike, përfaqësimit të formave të ndryshme të civilizimit dhe të sistemeve ligjore kryesore, përfaqësimit të barabartë gjinor dhe pjesëmarrjes së ekspertëve me aftësi të kufizuara.

5. Anëtarët e Komitetit do të zgjidhen me votim të fshehtë nga një listë me shtetas të caktuar nga shtetet palë në takimet e konferencës së shteteve palë. Në ato takime, për të cilat dy të tretat e shteteve palë duhet të përbëjnë kuorumin, personat e zgjedhur në Komitet do të jenë ata që sigurojnë numrin më të madh të votave dhe një shumicë absolute të votave të përfaqësuesve të shteteve palë që janë të pranishëm dhe votojnë.

6. Zgjedhjet fillestare do të mbahen jo më vonë se gjashtë muaj pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj konvente. Së paku katër muaj para datës së zgjedhjeve, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do t'u dërgojë një letër shteteve palë duke i ftuar ata që të paraqesin caktimet brenda dy muajve. Sekretari i Përgjithshëm do të përgatitë më pas në rend alfabetik një listë me të gjithë personat e caktuar, duke treguar shtetet palë që i kanë caktuar ata dhe do t'ua paraqesë atë shteteve palë të kësaj konvente.

7. Anëtarët e Komitetit do të zgjidhen për një mandat katërvjeçar. Ata do të kenë të drejtën e rizgjedhjes një herë. Megjithatë, mandati për të gjashtë anëtarët e zgjedhur në zgjedhjet e para do të skadojë në fund të dy viteve; menjëherë pas zgjedhjeve të para, emrat e këtyre gjashtë anëtarëve do të zgjidhen me short nga kryetari i takimit siç referohet në paragrafin 5 të këtij neni.

8. Zgjedhja e gjashtë anëtarëve shtesë të Komitetit do të mbahet me rastin e zgjedhjeve të rregullta, në përputhje me dispozitat përkatëse të këtij neni.

9. Në qoftë se një anëtar i Komitetit vdes apo jep dorëheqjen apo deklaron se për çfarëdo shkak ai apo ajo nuk mund të kryejë detyrat e tij apo të saj, shteti palë, i cili ka caktuar anëtarin/anëtaren duhet të emërojë një ekspert tjetër që i ka kualifikimet dhe plotëson kriteret e përcaktuara në dispozitat përkatëse të këtij neni, që të shërbejë për pjesën e mbetur të mandatit.

10. Komiteti duhet të vendosë rregullat e tij të procedurës.

11. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të sigurojë stafin dhe mjetet e nevojshme për realizimin efektiv të funksioneve të Komitetit në këtë konventë dhe do të thërrasë mbledhjen e tij të parë.

12. Me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme, anëtarët e Komitetit të ngritur sipas kësaj konvente do të marrin pagesë nga burimet e Kombeve të Bashkuara sipas termave dhe kushteve që mund të vendosë Asambleja, duke pasur parasysh rëndësinë e përgjegjësive të Komitetit.

13. Anëtarët e Komitetit do të kenë të drejtë për lehtësi, privilegje dhe imunitete të ekspertëve në misionet për Kombet e Bashkuara siç parashtrahet në seksionet përkatëse të konventës mbi privilegjet dhe imunitetet e Kombeve të Bashkuara.

#### Neni 35

#### **Raportet nga shtetet palë**

1. Çdo shtet palë do të paraqesë në Komitet, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, një raport gjithëpërfshirës mbi masat e marra për të bërë efektive detyrimet e tij në këtë konventë dhe mbi progresin e bërë në këtë drejtim, brenda dy viteve pas hyrjes në fuqi të kësaj konvente për atë shtet palë.

2. Pas kësaj, shtetet palë paraqesin raportet pasuese të paktën çdo katër vjet, si dhe sa herë që kërkohet nga Komiteti.

3. Komiteti do të vendosë udhëzimet e zbatueshme për përmbajtjen e raporteve.

4. Shteti palë, i cili i ka paraqitur Komitetit një raport fillestar gjithëpërfshirës nuk nevojitet të përsërisë informacionin e paraqitur më parë në raportet e tij të tjera pasuese. Kur bëjnë përgatitjen e raporteve për Komitetin, shtetet palë ftohen të kenë parasysh që ta bëjnë këtë në një proces të hapur dhe transparent, si dhe t'u kushtojnë vëmendjen e duhur dispozitave të përcaktuara në nenin 4.3 të kësaj konvente.

5. Raportet mund të tregojnë faktorë dhe vështirësi që ndikojnë në shkallën e plotësisht të detyrimeve të kësaj konvente.



#### Neni 36

### **Shqyrtimi i raporteve**

1. Çdo raport duhet të shqyrtohet nga Komiteti, i cili do të bëjë sugjerime dhe rekomandime të përgjithshme mbi raportin siç ai e konsideron të përshtatshme dhe do t'ua dërgojë ato shtetit palë përkatës. Shteti palë mund të përgjigjet me çdo informacion, që ai zgjedh për Komitetin. Komiteti mund të kërkojë nga shtetet palë informacion të mëtejshëm lidhur me zbatimin e kësaj konvente.

2. Në qoftë se shteti palë e ka tejkaluar shumë afatin për paraqitjen e raportit, Komiteti mund të njoftojë shtetin palë përkatës lidhur me nevojën për të shqyrtuar zbatimin e kësaj konvente në atë shtet palë, mbi bazën e informacionit të besueshëm të disponueshëm për Komitetin, në qoftë se raporti përkatës nuk paraqitet brenda tre muajve nga njoftimi. Komiteti do të ftojë shtetin palë përkatës për të marrë pjesë në këtë shqyrtim. Nëse shteti palë përgjigjet me paraqitjen e raportit përkatës, do të zbatohen dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.

3. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të vërë raportet në dispozicion të të gjitha shteteve palë.

4. Shtetet palë do t'ia paraqesin raportin e tyre sa më gjerësisht publikut të vendeve të tyre dhe do të lehtësojnë mundësimin e sugjerimeve dhe rekomandimeve të përgjithshme lidhur me këto raporte.

5. Komiteti do të transmetojë, siç mund ta çmojë të përshtatshme, tek agjencitë e specializuara, fondet dhe programet e Kombeve të Bashkuara dhe organizma të tjerë kompetentë, raportet nga shtetet palë me qëllim për të paraqitur një kërkesë apo tregues të nevojës për këshillim apo asistencë teknike të përfshirë në raport, krahas vëzhgimeve dhe rekomandimeve të Komitetit, në rast se ka të tilla, lidhur me këto kërkesa ose tregues.

#### Neni 37

### **Bashkëpunimi midis shteteve palë dhe Komitetit**

1. Çdo shtet palë do të bashkëpunojë me Komitetin dhe do të asistojë anëtarët e tij në përmbushjen e mandatit të tyre.

2. Komiteti, në marrëdhëniet e tij me shtetet palë, do t'i kushtojë vëmendjen e duhur rrugëve dhe mënyrave për rritjen e kapaciteteve kombëtare për implementimin e kësaj konvente, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkombëtar.

#### Neni 38

### **Marrëdhëniet e Komitetit me organizmat e tjerë**

Me qëllim për të inkurajuar implementimin efektiv të kësaj konvente dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e mbuluar nga kjo konventë:

a) Agjencitë e specializuara dhe organet e tjera të Kombeve të Bashkuara do të kenë të drejtë të përfaqësohen në shqyrtimin e implementimit të dispozitave të kësaj konvente, të cilat bëjnë pjesë gjithashtu në mandatin e tyre. Komiteti mund të ftojë agjencitë e specializuara dhe organet e tjera kompetente, siç mund ta çmojë të përshtatshme, për të siguruar këshillim të specializuar lidhur me implementimin e konventës në ato çështje që bëjnë pjesë në mandatet e tyre përkatëse. Komiteti mund të ftojë agjenci të specializuara dhe organe të tjera të Kombeve të Bashkuara të paraqesin raportet mbi zbatimin e konventës për çështje që bëjnë pjesë në gamën e aktiviteteve të tyre;

b) Komiteti, në realizimin e mandatit të tij, do të konsultojë, si të jetë e përshtatshme, organe të tjera përkatëse të institucionalizuara nga traktatet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, me qëllim për të siguruar përputhshmëri të udhëzimeve të tyre raportuese përkatëse, sugjerimeve dhe rekomandimeve të tyre të përgjithshme dhe për të mënjeluar duplikimin apo mbivendosjen në realizimin e këtyre funksioneve.

Neni 39

**Raporti i Komitetit**

Komiteti do të raportojë çdo dy vjet tek Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli Ekonomik dhe Shoqëror lidhur me aktivitetet e tij dhe mund të bëjë sugjerime dhe rekomandime të përgjithshme bazuar në shqyrtimin e raporteve dhe informacionin e marrë nga shtetet palë. Këto sugjerime dhe rekomandime të përgjithshme do të përfshihen në raportin e Komitetit së bashku me komentet, në rast se ka, nga shtetet palë.

Neni 40

**Konferenca e shteteve palë**

1. Shtetet palë do të takohen rregullisht në Konferencën e shteteve palë, për të shqyrtuar çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e kësaj konvente.

2. Konferenca e shteteve palë do të thirret nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara jo më vonë se gjashtë muaj pasi kjo konventë të hyjë në fuqi. Takimet pasuese do të thirren nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara çdo dy vjet ose me vendim të Konferencës së shteteve palë.

Neni 41

**Depozitari**

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të jetë depozitari i kësaj konvente.

Neni 42

**Nënshkrimi**

Kjo konventë do të jetë e hapur për t'u nënshkruar nga të gjitha shtetet dhe nga organizata integruese rajonale në zyrat qendrore të Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork më 30 mars 2007.

Neni 43

**Pëlqimi për ta respektuar**

Kjo konventë i nënshtrohet ratifikimit nga shtetet nënshkruese dhe konfirmimit formal nga organizata integruese rajonale nënshkruese. Do të jetë e hapur për aderimin e çdo shteti apo organizate rajonale integruese, që nuk e ka firmosur konventën.

Neni 44

**Organizatrat integruese rajonale**

1. "Organizatrat integruese rajonale" do të thotë një organizatë e përbërë nga shtetet sovrane të një rajoni të caktuar, tek të cilat shtetet anëtare kanë transferuar kompetenca lidhur me çështjet e përcaktuara nga kjo konventë. Organizata të tilla do të deklarohen, në instrumentet e tyre të konfirmimit apo pranimit formal, nivelin e kompetencave të tyre lidhur me çështjet e përcaktuara nga kjo konventë. Si rrjedhojë, ato duhet të informojnë autoritetin përgjegjës për çdo modifikim thelbësor në nivelin e kompetencave.

2. Termi "shtete palë" në këtë konventë do të zbatohet për organizata të tilla brenda kufijve të kompetencave të tyre.

3. Për qëllimet e nenit 45 paragrafi 1 dhe nenit 47 paragrafi 2 dhe 3, asnjë instrument i depozituar nga organizata integruese rajonale nuk do të numërohet.

4. Organizatat integruese rajonale, në çështjet brenda kompetencave të tyre, mund të ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar në Konferencën e shteteve palë, me një numër votash të barabartë me numrin



e shteteve të tyre anëtare, që janë palë në këtë konventë. Një organizatë e tillë nuk do të ushtrojë të drejtën e saj për të votuar nëse ndonjë prej shteteve anëtare ushtron të drejtën e tij dhe anasjellas.

#### Neni 45 **Hyrja në fuqi**

1. Kjo konventë do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas depozitimit të instrumentit të njëzet të ratifikimit apo aderimit.

2. Për çdo shtet apo organizatë integruese rajonale që ratifikon, konfirmon apo pranon formalisht konventën pas depozitimit të instrumentit të njëzet, konventa do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas depozitimit të instrumentit të saj.

#### Neni 46 **Rezervat**

1. Rezervat e papajtueshme me objektin dhe qëllimin e kësaj konvente nuk do të lejohen.
2. Rezervat mund të tërhiqen në çdo moment.

#### Neni 47 **Ndryshimet**

1. Çdo shtet palë mund të propozojë një ndryshim të kësaj konvente dhe ta paraqesë atë te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara. Sekretari i Përgjithshëm do t'ua komunikojë çdo ndryshim të propozuar shteteve palë, me një kërkesë për të njoftuar nëse ato janë në favor të një konference të shteteve palë, me qëllim për të shqyrtuar dhe vendosur lidhur me propozimet. Në rast se brenda katër muajve nga data e një komunikimi të tillë dhe së paku një e treta e shteteve palë janë në favor të një konference, Sekretari i Përgjithshëm do të mbledhë konferencën nën kujdesin e Kombeve të Bashkuara. Çdo ndryshim i miratuar duhet të paraqitet nga Sekretari i Përgjithshëm në Asamblenë e Përgjithshme për miratim dhe pas kësaj te shtetet palë për pranim.

2. Ndryshimi i mbështetur dhe i miratuar në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë, pasi numri i instrumenteve të pranimit të depozituar arrin dy të tretat e numrit të shteteve palë në datën e miratimit të ndryshimit. Pas kësaj, ndryshimi do të hyjë në fuqi për çdo shtet palë në ditën e tridhjetë pas depozitimit të instrumentit të tij të pranimit. Ndryshimi do të jetë detyrues vetëm për ato shtete të cilat e kanë pranuar atë.

3. Nëse vendoset me konsensus në Konferencën e shteteve palë, një ndryshim i mbështetur dhe i miratuar në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, i cili lidhet ekskluzivisht me nenet 34, 38, 39 dhe 40, do të hyjë në fuqi për të gjitha shtetet palë në ditën e tridhjetë pasi numri i instrumenteve të pranimit të depozituara arrin dy të tretat e numrit të shteteve palë në datën e miratimit të ndryshimit.

#### Neni 48 **Denoncimi i marrëveshjes**

Një shtet palë mund të denoncojë marrëveshjen për këtë konventë me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Denoncimi i marrëveshjes do të bëhet efektiv një vit pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

#### Neni 49 **Formati i lexueshëm**

Teksti i kësaj konvente do të përgatitet në format të lexueshëm.

Neni 50  
**Tekstet autentike**

Tekstet e kësaj konvente në gjuhët arabe, kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle janë njëloj autentike.

Në dëshmi sa më sipër, të plotfuqishmit e poshtëshënuar, të autorizuar për këtë qëllim nga qeveritë përkatëse, kanë firmosur këtë konventë.

**LIGJ**  
**Nr. 109/2012**

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN PËR NJOHJEN E  
DIVORCEVE DHE NDARJEVE LIGJORE**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën për Njohjen e Divorceve dhe Ndarjeve Ligjore, bërë në Hagë më 1 qershor 1970.

**Neni 2**

Në kontekst të konventës, termi “divorc” ka të njëjtin kuptim me termin “zgjidhje e martesës”, të parashikuar në ligjin shqiptar.

**Neni 3**

Në përputhje me paragrafin e parë të nenit 19 të konventës, Republika e Shqipërisë rezervon të drejtën të refuzojë njohjen e një divorci ose të një ndarjeje ligjore ndërmjet dy bashkëshortëve, të cilët, në kohën e divorcit ose të ndarjes ligjore, kanë qenë shtetas të Republikës së Shqipërisë dhe të asnjë shteti tjetër, në rast se është aplikuar një ligj i ndryshëm nga ligji që referon legjislacioni shqiptar për të drejtën ndërkombëtare private, përveçse kur rezultati i arritur është i njëjtë me atë që është arritur duke zbatuar ligjin e referuar prej tij.

**Neni 4**

Në përputhje me nenin 21 të konventës, Republika e Shqipërisë rezervon të drejtën për të refuzuar njohjen e një ndarjeje ligjore kur, në kohën që ajo është marrë, njëri nga bashkëshortët ishte shtetas shqiptar ose i një shteti kontraktues, ligji i të cilit nuk e parashikonte ndarjen ligjore.

**Neni 5**

Në përputhje me paragrafin e dytë të nenit 24 të konventës, Republika e Shqipërisë deklaron se do të zbatojë dispozitat e Konventës për Njohjen e Divorceve dhe Ndarjeve Ligjore për divorcet dhe



ndarjet ligjore të bëra para datës së hyrjes në fuqi të saj dhe rezervon të drejtën të mos e zbatojë atë kur aplikimi i dispozitave nuk sjell pasoja mbi të drejtat e pronësisë, të fituara nga çdo person përpara hyrjes në fuqi të konventës.

#### Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 15.11.2012

**Shpallur me dekretin nr. 7843, datë 3.12.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

### KONVENTA MBI NJOHJEN E DIVORCEVE DHE NDARJES LIGJORE (Lidhur më 1 qershor 1970)

Shtetet nënshkruese të kësaj konvente,  
*Duke dëshiruar* të lehtësojnë njohjen e divorceve dhe ndarjeve ligjore të marra në territoret e tyre përkatëse;

Kanë vendosur të lidhin një konventë për këtë qëllim dhe kanë rënë dakord për dispozitat e mëposhtme:

#### Neni 1

Kjo konventë zbatohet për njohjen në një shtet kontraktues të divorceve dhe ndarjeve ligjore të marra në një shtet tjetër kontraktues, të cilat ndjekin procedura gjyqësore ose të tjera, të njohura zyrtarisht dhe që janë ligjërish në fuqi në këtë shtet.

Konventa nuk zbatohet për përcaktimin e fajit apo disponimet plotësuese të shpallura gjatë marrjes së një vendimi divorci apo ndarjeve ligjore, në veçanti, ajo nuk zbatohet për disponimet e vendimit në lidhje me detyrimet ushqimore ose kujdestarinë e fëmijëve.

#### Neni 2

Vendimet e divorceve dhe të ndarjes ligjore njihen në të gjitha shtetet e tjera kontraktuese, sipas përcaktimeve të kësaj konvente, nëse, në datën e fillimit të procedimit në shtetin e divorcit ose ndarjes ligjore (më poshtë i quajtur “shteti i origjinës”):

1. I padituri ka pasur vendqëndrimin e tij të zakonshëm atje; ose  
2. Padiësi ka pasur vendqëndrimin e tij të zakonshëm atje dhe përmbushet një nga kushtet e mëposhtme:

a) vendqëndrimi i zakonshëm ka vazhduar të jetë i tillë, por jo më pak se një vit që nga data e fillimit të procedimit;

b) bashkëshortët kishin vendbanimin e tyre të përbashkët në këtë shtet.

3. Të dy bashkëshortët ishin shtetas të atij shteti; ose

4. Padiësi ka qenë shtetas i këtij shteti dhe përmbushet një nga kushtet e mëposhtme:

a) padiësi ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm atje; ose

b) ai kishte banuar zakonisht atje për një periudhë të vazhdueshme prej një viti, qoftë dhe pjesërisht, brenda një periudhe dyvjeçare para fillimit të procedimit; ose

5. Padiësi që ka kërkuar divorcin, ishte një shtetas i atij shteti dhe përmbushen të dyja kushtet e mëposhtme:

a) padiësi ishte i pranishëm në atë shtet në datën e fillimit të procedimit; dhe

b) bashkëshortët kanë banuar zakonisht bashkë në një shtet, ligji i të cilit, në datën e fillimit të procedimit, nuk parashikonte divorcin.

#### Neni 3

Kur shteti i origjinës përdor konceptin e vendbanimit, si një provë të juridiksionit në çështjet e divorcit apo të ndarjes ligjore, shprehja “vendqëndrim i zakonshëm” në nenin 2 konsiderohet se përfshin vendbanimin sipas termit të përdorur në atë shtet.

Megjithatë, paragrafi i mësipërm nuk zbatohet për vendbanimin e varësisë së një bashkëshorteje.

#### Neni 4

Në rastet e paraqitjes së një kundërpadie divorci ose ndarjeje ligjore, që vjen si pasojë e një padie apo kundërpadie, njihet nëse secila prej tyre përmbush kushtet e përcaktuara në nenet 2 ose 3 të kësaj konvente.

#### Neni 5

Kur një ndarje ligjore, që është në pajtim me kushtet e kësaj konvente është konvertuar në një divorc në shtetin e origjinës, njohja e divorcit nuk refuzohet me arsyetimin se kushtet e përcaktuara në nenin 2 ose 3 nuk ishin plotësuar në kohën e fillimit të procedimit të divorcit.

#### Neni 6

Kur i padituri është paraqitur në procedim, autoritetet e shtetit në të cilin kërkohet njohja e një divorci apo ndarjeje ligjore, janë të detyruar të paraqesin faktin mbi të cilin është pretenduar juridiksioni.

Njohja e një divorci ose ndarjeje ligjore nuk refuzohet për shkak se:

a) ligji i brendshëm i shtetit në të cilin kërkohet një njohje e tillë, nuk lejon divorcin ose sipas rastit, ndarjen ligjore mbi të njëjtat fakte; ose

b) është zbatuar një ligj i ndryshëm nga ligji që zbatohet sipas rregullave të së drejtës private ndërkombëtare të këtij shteti.

Pa cenuar këtë parashikim, kur është e nevojshme për zbatimin e dispozitave të tjera të kësaj konvente, autoritetet e shtetit, në të cilin kërkohet njohja e një divorci ose ndarjeje ligjore, nuk shqyrtojnë themelin e vendimit.

#### Neni 7

Shtetet kontraktuese mund të refuzojnë të njohin një divorc kur, në kohën që ai është marrë, të dyja palët ishin shtetas vetëm të shteteve të cilat nuk parashikonin divorcin.

#### Neni 8

Nëse, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat, kur nuk janë marrë masat e duhura për të njoftuar të paditurin, për procesin e divorcit ose ndarjeje ligjore, ose kur atij nuk i është dhënë një mundësi e mjaftueshme për të paraqitur çështjen e tij, mund të refuzohet njohja e divorcit apo ndarjes ligjore.

#### Neni 9

Shtetet kontraktuese mund të refuzojnë të njohim një divorc ose ndarjeje ligjore, nëse ajo është e papajtueshme me një vendim të mëparshëm që përcakton statusin martesor të bashkëshortëve dhe se vendimi ose është dhënë në shtetin në të cilin kërkohet njohja ose është njohur, ose i përmbush kushtet e kërkuara për njohje në atë shtet.





#### Neni 10

Shtetet kontraktuese mund të refuzojnë të njohin një divorc ose ndarje ligjore nëse një njohje e tillë është haptazi e papajtueshme me politikën e tyre publike “*ordre public*”.

#### Neni 11

Një shtet, i cili është i detyruar të njohë një divorc në bazë të kësaj konvente, nuk mund të ndalojë asnjërin nga bashkëshortët nga rimartesa, me arsyen se ligji i një shteti tjetër nuk e njeh atë divorc.

#### Neni 12

Procedimi për divorc ose ndarje ligjore, i filluar në një shtet kontraktues, mund të pezullohet, kur procedimi në lidhje me statusin martesor të të dyja palëve është në prirje të zgjidhjes në një shtet tjetër kontraktues.

#### Neni 13

Në zbatim të kësaj konvente për divorcet ose ndarjet ligjore të marra apo që kërkohen të njihen në shtetet kontraktuese që kanë, në çështjet e divorcit apo ndarjes ligjore, dy ose më shumë sisteme ligjore që zbatohen në njësi të ndryshme territoriale:

1. Çdo referencë ndaj legjislacionit të shtetit të origjinës, interpretohet si referim ndaj ligjit të territorit në të cilin është marrë divorci ose ndarja;
2. Çdo referencë ndaj legjislacionit të shtetit në të cilin kërkohet njohja, interpretohet si referim ndaj ligjit të forumit; dhe
3. Çdo referencë ndaj vendbanimit ose vendqëndrimit në shtetin e origjinës, interpretohet si referim ndaj vendbanimit ose vendqëndrimit në territorin në të cilin është marrë ose ndarje ligjore.

#### Neni 14

Për qëllimet e neneve 2 dhe 3, kur shteti i origjinës ka në çështjet e divorcit ose ndarjes ligjore, dy ose më shumë sisteme ligjore, që zbatohen në njësi të ndryshme territoriale:

1. Neni 2 nënparagrafi 3 zbatohet kur të dy bashkëshortët ishin shtetas të shtetit në të cilin njësi territoriale, ku divorci ose ndarja ligjore ishte marrë, është pjesë e tij dhe pavarësisht nga vendqëndrimi i zakonshëm i bashkëshortëve.
2. Neni 2, nënparagrafët 4 dhe 5 zbatohen kur paditësi ishte një shtetas i shtetit në të cilin njësi territoriale, ku divorci ose ndarja ligjore ishte marrë, është pjesë e tij.

#### Neni 15

Në lidhje me një shtet kontraktues, që në çështjet e divorcit ose të ndarjes ligjore, që zbaton dy ose më shumë sisteme ligjore për kategori të ndryshme personash, çdo referencë ndaj ligjit të atij shteti interpretohet si referim ndaj sistemit ligjor të përcaktuar nga ligji i atij shteti.

#### Neni 16

Kur për qëllimet e kësaj konvente, është e nevojshme për t’iu referuar ligjit të një shteti, nëse është apo jo një shtet kontraktues, të ndryshëm nga shteti i origjinës ose shteti në të cilin kërkohet njohja, dhe që në çështjet e divorcit ose të ndarjes ligjore kanë dy ose më shumë sisteme ligjore të zbatimit territorial ose personal, referimi bëhet ndaj sistemit të përcaktuar nga ligji i atij shteti.

#### Neni 17

Kjo konventë nuk pengon zbatimin në një shtet kontraktues të rregullave më të favorshme të ligjit për njohjen e divorceve dhe ndarjeve ligjore.

#### Neni 18

Kjo konventë nuk ndikon në zbatimin e konventave të tjera, për të cilat një ose disa shtete kontraktuese janë ose mund të bëhen në të ardhmen palë dhe të cilat përmbajnë dispozita që lidhen me objektin e kësaj konvente.

Shtetet kontraktuese, megjithatë, duhet të evitojnë lidhjen e konventave të tjera për çështje të njëjta të papajteshme me kushtet e kësaj konvente, përveç për arsye të veçanta në bazë të lidhjeve rajonale ose të tjera; dhe pavarësisht nga kushtet e këtyre konventave, ato marrin përsipër të njohin në përputhje me këtë konventë, divorcet dhe ndarje ligjore të dhëna në shtetet kontraktuese, që nuk janë palë të këtyre konventave të tjera.

#### Neni 19

Shtetet kontraktuese jo më vonë se koha e ratifikimit ose aderimit, mund të rezervojnë të drejtën:

1. Të refuzojnë të njohin një divorc ose ndarje ligjore ndërmjet dy bashkëshortëve, të cilët në kohën e divorcit ose ndarjes ligjore, ishin shtetas të shtetit në të cilin kërkohet njohja, dhe e asnjë shteti tjetër, dhe një ligj tjetër përveç atij të treguar nga rregullat e së drejtës private ndërkombëtare të shtetit të njohjes është aplikuar, përveç kur rezultati i arritur është i njëjtë me atë që do të ishte arritur duke zbatuar ligjin e treguar nga këto rregulla;

2. Të refuzojnë të njohin një divorc kur, në kohën që ai është marrë, të dyja palët kishin vendbanimin e zakonshëm në shtete, të cilat nuk e parashikojnë divorcin. Një shtet që përdor rezervën e përcaktuar në këtë paragraf, nuk mund të refuzojë njohjen me zbatimin e nenit 7.

#### Neni 20

Shtetet kontraktuese, ligji i të cilave nuk parashikon divorcin jo më vonë se koha e ratifikimit ose aderimit, mund të rezervojnë të drejtën për të mos njohur divorc, nëse në datën që ai është marrë, njëri nga bashkëshortët ishte shtetas i një shteti, ligji i të cilit nuk e parashikon divorcin.

Kjo rezervë ka efekt vetëm për aq kohë sa ligji i shtetit që e përdor atë nuk e parashikon divorcin.

#### Neni 21

Shtetet kontraktuese, ligji i të cilave nuk parashikon ndarjen ligjore, jo më vonë se koha e ratifikimit ose aderimit, mund të rezervojnë të drejtën për të refuzuar njohjen e një ndarjeje ligjore, kur në kohën që ajo është marrë, njëri nga bashkëshortët ishte shtetas i një shteti kontraktues, ligji i të cilit nuk e parashikonte ndarjen ligjore.

#### Neni 22

Shtetet kontraktuese mund, herë pas here, të mund deklarojnë se disa kategori personash, që kanë shtetësinë e tyre, nuk duhet të konsiderohen shtetas të tyre për qëllimet e kësaj konvente.

#### Neni 23

Nëse një shtet kontraktues ka më shumë se një sistem ligjor në çështjet e divorcit ose ndarjes ligjore, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit ose aderimit, mund të deklarojë se kjo konventë shtrihet në të



gjitha sistemet e saj ligjore ose vetëm në një ose më shumë prej tyre, dhe mund të ndryshojë deklaratën e tij, duke paraqitur një deklaratë tjetër në çdo kohë pas kësaj.

Këto deklarata do t'i njoftohen Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës dhe deklarojnë shprehimisht sistemet ligjore për të cilat zbatohet konventa.

Shtetet kontraktuese mund të refuzojnë të njohim një divorc ose ndarje ligjore nëse, në datën në të cilën kërkohet njohja, konventa nuk është e zbatueshme për sistemin ligjor, sipas të cilit është marrë divorci ose ndarja ligjore.

#### Neni 24

Kjo konventë zbatohet pavarësisht nga data në të cilën është marrë divorci ose ndarja ligjore.

Megjithatë, një shtet kontraktues, jo më vonë se koha e ratifikimit ose aderimit, mund të rezervojë të drejtën për të mos zbatuar këtë konventë për një divorc ose ndarje ligjore të marrë para datës në të cilën, në lidhje me atë shtet, konventa hyn në fuqi.

#### Neni 25

Çdo shtet, jo më vonë se momenti i ratifikimit ose aderimit, mund të bëjë një ose më shumë rezerva të përmendura në nenet 19, 20, 21 dhe 24 të kësaj konvente. Asnjë rezervë tjetër nuk lejohet.

Secili shtet kontraktues, gjithashtu, kur njoftohet një shtrirje e konventës në përputhje me nenin 29, mund të bëjë një ose më shumë rezerva të tilla, me efektin e saj të kufizuar në të gjitha ose në disa nga territoret e përmendura në shtrirje.

Secili shtet kontraktues në çdo kohë mund të tërheqë një rezervë që ka bërë. Një tërheqje e tillë i njoftohet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës.

Një rezervë e tillë pushon së pasuri fuqi në ditën e gjashtëdhjetë pas njoftimit të përmendur në paragrafin e mësipërm.

#### Neni 26

Kjo konventë është e hapur për nënshkrim nga shtetet e përfaqësuara në sesionin e njëmbëdhjetë të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private.

Ajo ratifikohet dhe instrumentet e ratifikimit depozitohen pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës.

#### Neni 27

Kjo konventë hyn në fuqi në ditën e gjashtëmbëdhjetë pas depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit të përmendur në paragrafin e dytë të nenit 26.

Konventa hyn në fuqi për çdo shtet nënshkrues që e ratifikon më pas në ditën e gjashtëdhjetë pas depozitimit të instrumentit të ratifikimit.

#### Neni 28

Çdo shtet që nuk është përfaqësuar në sesionin e njëmbëdhjetë të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private, i cili është anëtar i kësaj konference ose i Kombeve të Bashkuara, ose i një agjencie të specializuar të asaj organizate, ose i një pale të statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mund të aderojë në këtë konventë, pasi ajo të ketë hyrë në fuqi në përputhje me paragrafin e parë të nenit 27.

Instrumenti i aderimit depozitohet pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës.

Konventa hyn në fuqi për një shtet që aderon në të në ditën e gjashtëdhjetë pas depozitimit të instrumentit të tij të aderimit.

Aderimi ka efekt vetëm në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet shtetit aderues dhe atyre shteteve kontraktuese, pasi kanë deklaruar pranimin e tyre të aderimit. Një deklaratë e tillë depozitohet pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës; kjo Ministri u përcjell, nëpërmjet kanaleve diplomatike, një kopje e vërtetuar secilit prej shteteve kontraktuese.

Konventa hyn në fuqi ndërmjet shtetit aderues dhe shtetit që ka deklaruar pranimin e tij të aderimit në ditën e gjashtëdhjetë pas depozitimit të deklaratës së pranimin.

#### Neni 29

Çdo shtet në kohën e nënshkrimit, ratifikimit ose aderimit, mund të deklarojë se kjo konventë shtrihet në të gjitha territoret për marrëdhëniet ndërkombëtare, për të cilat ai është përgjegjës, ose në një ose më shumë prej tyre. Një deklaratë e tillë hyn në fuqi në datën e hyrjes në fuqi të konventës për shtetet në fjalë.

Në çdo kohë pas kësaj, shtrirje të tilla i njoftohen Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës.

Shtrirja ka efekt vetëm në lidhje me marrëdhëniet me këto shtete kontraktuese, pasi kanë deklaruar pranimin e tyre të shtrirjes. Një deklaratë e tillë depozitohet pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës; kjo Ministri u përcjell, nëpërmjet kanaleve diplomatike, një kopje të vërtetuar secilit prej shteteve kontraktuese.

Shtrirja hyn në fuqi në çdo rast gjashtëdhjetë ditë pas depozitimit të deklaratës së pranimin.

#### Neni 30

Kjo konventë mbetet në fuqi për pesë vjet nga data e hyrjes në fuqi të saj, në përputhje me paragrafin e parë të nenit 27, edhe për shtetet, të cilat e kanë ratifikuar atë ose kanë aderuar në të më pas.

Nëse nuk ka pasur asnjë denoncim, ajo rinovohet në mënyrë të heshtur çdo pesë vjet.

Çdo denoncim i njoftohet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës, të paktën gjashtë muaj para përfundimit të periudhës pesëvjeçare.

Ajo mund të kufizohet në disa nga territoret për të cilat zbatohet konventa.

Denoncimi ka efekt vetëm në lidhje me shtetin, i cili e ka njoftuar atë. Konventa mbetet në fuqi për shtetet e tjera kontraktuese.

#### Neni 31

Ministria e Punëve të Jashtme të Holandës njofton shtetet e përmendura në nenin 26 dhe shtetet që kanë aderuar në përputhje me nenin 28, për sa më poshtë:

- a) nënshkrimet dhe ratifikimet e përmendura në nenin 26;
- b) datën në të cilën kjo konventë hyn në fuqi në përputhje me paragrafin e parë të nenit 27;
- c) aderimet e përmendura në nenin 28 dhe datat në të cilat ato hyjnë në fuqi;
- d) shtrirjet e përmendura në nenin 29 dhe datat në të cilat ato hyjnë në fuqi;
- e) denoncimet e përmendura në nenin 30;
- f) rezervat dhe tërheqjet e përmendura në nenet 19, 20, 21, 24 dhe 25;
- g) deklaratimet e përmendura në nenet 22, 23, 28 dhe 29.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar sipas rregullit për këtë, kanë nënshkruar këtë konventë.

Bërë në Hagë, në ditën e parë të qershorit, 1970, në gjuhët anglisht dhe frëngjisht, ku të dyja tekstet janë njëloj autentike, në një kopje të vetme, e cila depozitohet në arkivat e qeverisë së Holandës dhe nga e cila, një kopje e vërtetuar i dërgohet, nëpërmjet kanaleve diplomatike, secilit prej shteteve të përfaqësuara në sesionin e njëmbëdhjetë të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private.



**LIGJ**  
**Nr. 110/2012**

**PËR BASHKIMIN NDËRKUFITAR TË SHOQËRIVE TREGTARE<sup>1</sup>**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i kushteve, procedurave dhe pasojave juridike të një bashkimi ndërkufitar ndërmjet shoqërive shqiptare dhe shoqërive europiane, si dhe parashikimi i masave mbrojtëse për punëmarrësit dhe kreditorët e këtyre shoqërive.

**Neni 2**  
**Fusha e zbatimit**

1. Ky ligj zbatohet për bashkimet ndërkufitare, të përcaktuara sipas nenit 3 të këtij ligji, nëse, të paktën, njëra nga shoqëritë pjesëmarrëse në bashkim është shoqëri shqiptare.

2. Dispozitat e neneve 11 dhe 16 deri në 26 të këtij ligji janë të zbatueshme vetëm nëse shoqëria që rezulton nga bashkimi është shoqëri shqiptare. Nëse shoqëria që rezulton nga bashkimi është shoqëri europiane, atëherë çështjet e trajtuara në këto nene rregullohen sipas ligjeve të zbatueshme në territorin e vendit europian, në të cilin është vendosur shoqëria europiane që rezulton nga bashkimi, por parashikimet e nenit 19 pika 2 shkronjat “c” dhe “ç” të këtij ligji gjejnë zbatim për emërimin apo zgjedhjen e anëtarëve të organit të posaçëm të negocimit, nga punëmarrësit e punësuar në Shqipëri prej njësisive të prekura nga bashkimi.

3. Ky ligj nuk zbatohet për bashkimet ndërkufitare që përfshijnë shoqëri, objekt i aktivitetit të të cilave është investimi kolektiv i kapitalit të dhënë nga publiku, që veprojnë në bazë të parimit të shpërndarjes së rrezikut dhe që titujt e të cilave, me kërkesë të mbajtësit të tyre, riblihen ose shlyhen, drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë, nëpërmjet aktiveve të kësaj shoqërie. Çdo veprim i kryer nga këto shoqëri për të garantuar që vlera e këmbimit të titujve të mos ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme me vlerën neto të aktiveve njësohet me veprimet e riblerjes ose të shlyerjes së titujve të tyre.

---

<sup>1</sup> Ky ligj është përafshuar plotësisht me: Direktivën 2005/56/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 26 tetor 2005 “Për Bashkimin Ndërkufitar të Shoqërive me Përgjegjësi të Kufizuar”. Numri CELEX: 32005L0056, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 310, datë 25.11.2005, faqe 1 – 9.

### Neni 3 Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Bashkim” është tërësia e veprimeve juridike përmes të cilave:

a) një ose më shumë shoqëri tregtare prishen pa kaluar në procesin e likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese (shoqëria objekt), duke transferuar të gjitha aktivet dhe pasivet e veta në favor të një shoqërie tjetër tregtare ekzistuese (shoqëria përthithëse), në këmbim të emetimit në favor të ortakëve/aksionarëve të shoqërisë objekt, të titujve apo aksioneve/kuotave të kapitalit të shoqërisë përthithëse dhe, nëse është e zbatueshme, të një pagese në mjete monetare, e cila nuk është më e madhe se 10 për qind e vlerës nominale ose, në mungesë të vlerës nominale, të vlerës kontabël të këtyre titujve apo aksioneve/kuotave të kapitalit; ose

b) dy a më shumë shoqëri tregtare prishen pa kaluar në procesin e likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese (shoqëria objekt), duke transferuar të gjitha aktivet dhe pasivet e veta në favor të një shoqërie tjetër tregtare të themeluar rishtazi (shoqëria e re), në këmbim të emetimit për ortakët/aksionarët e shoqërisë objekt të titujve apo aksioneve/kuotave të kapitalit të shoqërisë së re dhe, nëse është e zbatueshme, të një pagese në mjete monetare, e cila nuk është më e madhe se 10 për qind e vlerës nominale ose, në mungesë të vlerës nominale, të vlerës kontabël të këtyre titujve apo aksioneve/kuotave të kapitalit; ose

c) një shoqëri tregtare, pas prishjes, pa kaluar në procesin e likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese (shoqëria objekt), i transferon të gjitha aktivet dhe pasivet e veta në favor të shoqërisë tregtare, e cila zotëron të gjithë titujt apo aksionet/kuotat e kapitalit të shoqërisë që priset (shoqëria përthithëse).

2. “Bashkim ndërkuftar” është bashkimi, siç është përcaktuar në këtë nen, ndërmjet një ose më shumë shoqërive shqiptare dhe një a më shumë shoqërive europiane. Një bashkim ndërkuftar konsiderohet i përfshirë në përcaktimet e pikës 1 të këtij neni, edhe në rastin kur, sipas legjislacionit të një a më shumë vendeve europiane, në territorin e të cilave janë vendosur shoqëritë europiane që marrin pjesë në bashkimin ndërkuftar, lejohet që pagesa në mjete monetare, përmendur në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 1 të këtij neni, të jetë më e madhe se 10 për qind e vlerës nominale të titujve apo aksioneve/kuotave të kapitalit, cituar në këto pika, apo në mungesë të vlerës nominale, të vlerës kontabël të këtyre titujve apo aksioneve/kuotave të kapitalit.

3. “Certifikata e parabashkimit” është deklarata e redaktuar nga noteri i autorizuar, në bazë të kërkesave të ligjit shqiptar që rregullon noterinë e në përputhje dhe me parashikimet e këtij ligji, me kërkesë të përfaqësuesit ligjor të shoqërive shqiptare pjesëmarrëse në bashkim, që vërteton përmbushjen e kushteve juridike të parabashkimit ndërkuftar, sipas parashikimeve të nenit 10 të këtij ligji.

4. “Direktiva e Bashkimit Ndërkuftar” është direktiva 2005/56/EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit të 26 tetorit 2005 “Për bashkimet ndërkuftare të shoqërive me përgjegjësi të kufizuara, të cilat ofrojnë përgjegjësi të kufizuar për ortakët ose aksionarët tyre”, ndryshuar me direktivën 2009/109/EC.

5. “Ministria” është ministria përgjegjëse për ekonominë.

6. “Noteri i autorizuar” është noteri i licencuar, i cili ka kaluar testimin për bashkimet ndërkuftare, të përgatitur nga Dhoma Kombëtare e Noterëve, dhe që është përfshirë në listën e noterëve të autorizuar për bashkimet ndërkuftare, të hartuar dhe të mbajtur nga Dhoma Kombëtare e Noterëve.

7. “Njësitë e prekura” janë, sipas rastit, të gjitha shoqëritë pjesëmarrëse, shqiptare dhe europiane, shoqëritë e kontrolluara prej tyre dhe njësitë e tyre që preken nga bashkimi ndërkuftar.

8. “QKR” është Qendra Kombëtare e Regjistrimit, e cila mban regjistrin tregtar të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjin që rregullon organizimin dhe funksionimin e këtij institucioni.

9. “Shoqëri europiane” është shoqëria tregtare me selinë e regjistruar, zyrën qendrore apo vendndodhjen kryesore të veprimtarisë në territorin e një vendi europian, e cila ka formën ligjore të përcaktuar sipas Direktivës së Bashkimit Ndërkuftar dhe që merr pjesë në bashkimin ndërkuftar, sipas këtij ligji.

10. “Shoqëri shqiptare” është shoqëria me përgjegjësi të kufizuar dhe/ose shoqëria aksionare, me zyrë qendrore në territorin e Republikës së Shqipërisë, e përcaktuar sipas ligjit shqiptar që rregullon



organizimin dhe funksionimin e shoqërive tregtare, që merr pjesë në bashkimin ndërkufitar, sipas këtij ligji.

11. “Shoqëritë pjesëmarrëse” janë bashkërisht secila nga shoqëritë shqiptare dhe ato europiane që marrin pjesë në bashkimin ndërkufitar, përveçse kur ky ligj i referohet shprehimisht vetëm një a më shumë shoqërive shqiptare apo atyre europiane që marrin pjesë në bashkimin ndërkufitar.

12. “Shoqëria që rezulton nga bashkimi” është, sipas rastit, shoqëria, shqiptare apo shoqëria europiane, që është shoqëri përthithëse apo shoqëri e re, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni.

13. “Vend european” është shteti që është palë në traktatet e Bashkimit European dhe të Zonës Ekonomike Europiane.

#### Neni 4

#### Zbatimi i ligjeve të tjera

1. Shoqëritë shqiptare pjesëmarrëse mbeten të detyruara të zbatojnë dispozitat e ligjit shqiptar që rregullon organizimin dhe funksionimin e shoqërive tregtare, duke përfshirë edhe dispozitat që mbrojnë kreditorët dhe ortakët/aksionarët në pakicë, që janë kundër bashkimit ndërkufitar, për aq sa këto dispozita nuk bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

2. Bashkimi ndërkufitar i shoqërive, sipas parashikimeve të këtij ligji, nuk përjashton zbatimin e kërkesave dhe miratimeve rregullatore, të përcaktuara nga legjislacioni i zbatueshëm shqiptar, në lidhje me përqendrimet e ndërmarrjeve dhe mbrojtjen e konkurrencës apo të kërkesave dhe miratimeve të autoriteteve të tjera rregullatore e licencuese, të parashikuara me ligj.

#### KREU II

#### PROCEDURA E BASHKIMIT

#### Neni 5

#### Kushtet e përbashkëta të projekt marrëveshjes së bashkimit ndërkufitar

Përfaqësuesit ligjorë të secilës shoqëri tregtare shqiptare, pjesëmarrëse në bashkim, duhet të hartojnë një projekt marrëveshje me shkrim, për kushtet e përbashkëta të bashkimit ndërkufitar, ku të parashikohen, të paktën, këto çështje:

a) forma, emërtimi dhe selia e regjistruar e shoqërive pjesëmarrëse dhe, në rastin e parashikuar sipas shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 3 e këtij ligji, të dhënat që propozohen për shoqërinë e re;

b) raporti i zbatueshëm për këmbimin e titujve apo aksioneve/kuotave të kapitalit të shoqërisë dhe vlera e pagesës në mjete monetare, nëse ka;

c) kushtet e shpërndarjes së titujve apo aksioneve/kuotave të kapitalit të shoqërisë që rezulton nga bashkimi;

ç) pasojat që bashkimi ndërkufitar mund të ketë mbi marrëdhëniet e punësimit të shoqërisë;

d) data e mbajtjes së titujve apo aksioneve/kuotave të kapitalit të shoqërisë që rezulton nga bashkimi, që u jep të drejtë mbajtësve të tyre të marrin pjesë në fitim dhe çdo kusht të veçantë që prek këtë të drejtë;

dh) data kur veprimet e shoqërive pjesëmarrëse do të trajtohen në kontabilitet si veprime të shoqërisë që rezulton nga bashkimi;

e) të drejtat që shoqëria që rezulton nga bashkimi u njeh ortakëve/aksionarëve me të drejta të veçanta apo mbajtësve të titujve, që nuk janë aksione të shoqërisë objekt, si dhe masat që propozohen në lidhje me ta;

ë) çdo avantazh a përfitim që u jepet ekspertëve, të cilët bëjnë vlerësimin e kushteve të përbashkëta të projekt marrëveshjes së bashkimit ndërkufitar, apo që u jepet anëtarëve të organeve administrative, drejtuese, mbikëqyrëse a kontrolluese të shoqërive pjesëmarrëse;

f) statuti i shoqërisë përthithëse ose, në rastin e parashikuar sipas shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 3 të këtij ligji, projektstatuti i shoqërisë e re;

g) sipas rastit, informacioni për procedurat, përmes të cilave vendosen masat për përfshirjen e punëmarrësve në përcaktimin, sipas nenit 16 të këtij ligji, të të drejtave të tyre për të marrë pjesë në organizimin dhe funksionimin e shoqërisë që rezulton nga bashkimi;

gj) informacioni për vlerësimin e aktiveve dhe pasiveve që i kalojnë shoqërisë që rezulton nga bashkimi;

h) datat e mbylljes ushtrimore të pasqyrave financiare të shoqërive pjesëmarrëse, që do të përdoren për caktimin e kushteve të bashkimit ndërkufitar.

#### Neni 6

### **Raporti i bashkimit të organit administrativ**

Përfaqësuesit ligjorë të secilës shoqëri shqiptare pjesëmarrëse duhet të hartojnë një raport të hollësishëm, ku të shpjegohet marrëveshja e bashkimit dhe të përshkruhen bazat ligjore dhe ekonomike për të e, në veçanti, raporti i këmbimit të aksioneve, kuotave apo të drejtave të veçanta. Në këtë raport duhet të përshkruhen edhe vështirësitë që janë hasur, lidhur me vlerësimet e kryera, si dhe pasojat që do të ketë bashkimi ndërkufitar mbi ortakët/aksionarët, kreditorët dhe punëmarrësit e shoqërive pjesëmarrëse.

#### Neni 7

### **Raporti i ekspertit të pavarur**

1. Përfaqësuesit ligjorë të secilës shoqëri shqiptare pjesëmarrëse caktojnë një a më shumë ekspertë të pavarur, të licencuar, për të shqyrtuar kushtet e përbashkëta të projekt marrëveshjes së bashkimit ndërkufitar. Ekspertët mund të caktohen për secilën shoqëri shqiptare ose bashkërisht për të gjitha shoqëritë pjesëmarrëse. Të gjitha shoqëritë pjesëmarrëse mund të vendosin bashkërisht që ekspertët të caktohen nga autoritetet kompetente të një vendi europian, në territorin e të cilit është vendosur njëra prej shoqërive europiane pjesëmarrëse, ose në Shqipëri, nga gjykata kompetente.

2. Ekspertët hartojnë një raport me shkrim, në të cilin duhet të deklarojnë se, sipas mendimit të tyre, raporti i këmbimit të aksioneve/kuotave është i drejtë e i arsyeshëm. Në deklaratën e tyre ekspertët duhet të shprehen dhe të përshkruajnë, të paktën:

a) metodën ose metodat që janë përdorur për të arritur në raportin e propozuar të këmbimit të aksioneve/kuotave;

b) nëse kjo metodë apo këto metoda janë të përshtatshme për rastin në fjalë, të tregojnë vlerat e arritura përmes përdorimit të metodës dhe të japin një mendim për rëndësinë relative që i jepet secilës metodë për të arritur në vlerën e përcaktuar;

c) vështirësitë e veçanta të hasura gjatë vlerësimit.

3. Secili prej ekspertëve ka të drejtë të marrë nga shoqëritë pjesëmarrëse gjithë informacionin dhe dokumentet përkatëse, si dhe të kryejë të gjitha hetimet e nevojshme.

4. Detyrimi për angazhimin e ekspertëve, sipas pikave 1 deri në 3 të këtij neni, si dhe detyrimi për publikimin e raportit të ekspertëve, sipas nenit 8 të këtij ligji, mund të përjashtohen, nëse për këtë japin miratimin të gjithë aksionarët/ortakët e shoqërive pjesëmarrëse.

#### Neni 8

### **Publikimi**

1. Përfaqësuesit ligjorë të secilës shoqëri shqiptare pjesëmarrëse, të paktën një muaj përpara datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, të referuar në nenin 9 të këtij ligji, publikojnë pranë QKR-së dhe në faqen e internetit të shoqërisë, nëse ka:

a) kushtet e përbashkëta të projekt marrëveshjes së bashkimit ndërkufitar, të hartuara sipas nenit 5 të këtij ligji;





b) raportin e përfaqësuesve ligjorë të shoqërisë, të përgatitur sipas përcaktimeve të nenit 6 të këtij ligji, së bashku me pasqyrat financiare dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë, për tre vitet e fundit, apo të gjitha pasqyrat financiare dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë, nëse shoqëria është regjistruar prej më pak se tre vjetësh;

c) raportet e ekspertit/ekspertëve të pavarur, të përgatitur sipas përcaktimeve të nenit 7 të këtij ligji;

ç) nëse përfaqësuesit ligjorë të secilës shoqëri shqiptare pjesëmarrëse, përpara përfundimit të afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, marrin nga përfaqësuesit e punëmarrësve një opinion në lidhje me bashkimin ndërkufitar, atëherë përfaqësuesit ligjorë të këtyre shoqërive janë të detyruar të publikojnë, sipas kërkesave të pikës 1 të këtij neni, edhe opinionin e dhënë nga përfaqësuesit e punëmarrësve.

2. QKR-ja, në bazë të aplikimit për publikim të secilës shoqëri shqiptare pjesëmarrëse, regjistron dhe publikon, sipas dispozitave të ligjit që rregullon organizimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit:

a) shënimin, ku të vërtetohet se janë depozituar për publikim kushtet e përbashkëta të projekt marrëveshjes së bashkimit ndërkufitar, përfaqësuesve ligjorë të shoqërisë, pasqyrat financiare dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë së tre viteve të fundit, apo të gjitha pasqyrat financiare e raportet e ecurisë së veprimtarisë, nëse shoqëria është regjistruar prej më pak se tre vjetësh, si dhe raportet e ekspertit/ekspertëve të pavarur;

b) formën ligjore, emërtimin dhe selinë e regjistruar të secilës shoqëri pjesëmarrëse;

c) regjistrin tregtar, në të cilin janë regjistruar shoqëritë pjesëmarrëse, dhe numrin e tyre të regjistrimit;

ç) shënimin për masat e marra nga shoqëritë shqiptare pjesëmarrëse për ushtrimin e të drejtave të kreditorëve dhe të ortakëve/aksionarëve të tyre të pakicës, nëse ka, dhe adresën ku mund të merret informacioni i plotë, pa pagesë, për këto masa.

3. Ministria, në përputhje me kërkesat e parashikimeve të ligjit që rregullon organizimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, miraton formatin dhe përmbajtjen e dokumenteve të nevojshme për kryerjen e aplikimeve dhe regjistrimeve, sipas këtij neni.

#### Neni 9

#### **Miratimi i marrëveshjes së bashkimit nga asambleja**

1. Pasi vlerëson raportet e përgatitura, sipas neneve 6 e 7 të këtij ligji, asambleja e përgjithshme e secilës prej shoqërive shqiptare pjesëmarrëse vendos për miratimin ose jo të kushteve të përbashkëta të projekt marrëveshjes së bashkimit ndërkufitar.

2. Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme merr vendim me tri të katërtat e votave të ortakëve/aksionarëve pjesëmarrës me të drejtë vote, sipas parashikimeve të ligjit shqiptar që rregullon organizimin dhe funksionimin e shoqërive tregtare.

3. Asambleja e përgjithshme e secilës shoqëri shqiptare pjesëmarrëse mund të ruajë të drejtën për të kushtëzuar realizimin e bashkimit ndërkufitar të miratuar, me ratifikimin prej saj, në mënyrë të shprehur, të marrëveshjeve të arritura, lidhur me të drejtat e pjesëmarrjes së punëmarrësve në organizimin dhe funksionimin e shoqërisë që rezultojnë nga bashkimi.

4. Kur bashkimi ndërkufitar cenon të drejtat e ortakëve/aksionarëve të veçantë, apo të drejtat që rrjedhin nga aksione të kategorive të veçanta, atëherë vendimi i asamblesë së përgjithshme të secilës shoqëri shqiptare pjesëmarrëse për miratimin e bashkimit ndërkufitar i nënshtrohet, sipas rastit, miratimit të ortakëve apo aksionarëve të prekur ose një votimi të veçantë, në përputhje me parashikimet e ligjit shqiptar që rregullon organizimin dhe funksionimin e shoqërive tregtare.

5. Secili aksionar apo ortak i shoqërive shqiptare pjesëmarrëse ka të drejtë të shqyrtojë dokumentet, në bazë të të cilave kryhet bashkimi ndërkufitar. Këta aksionarë apo ortakë mund të kërkojnë informacione për bashkimin ndërkufitar gjatë mbledhjes së asamblesë së përgjithshme.

6. Secila shoqëri shqiptare pjesëmarrëse, jo më vonë se 30 ditë nga data e miratimit, publikon në QKR dhe në faqen e internetit të shoqërisë, nëse ka, një kopje të vendimit të asamblesë së përgjithshme që miraton kushtet e përbashkëta të marrëveshjes së bashkimit, sipas këtij neni.

#### Neni 10

#### **Certifikata e parabashkimit**

1. Përfaqësuesit ligjorë të shoqërisë shqiptare pjesëmarrëse caktojnë, bashkërisht, një noter të autorizuar për lëshimin e certifikatave të parabashkimit. Në rastin kur përfaqësuesit ligjorë të shoqërive shqiptare pjesëmarrëse nuk bien dakord për caktimin e noterit të autorizuar, atëherë secila prej tyre mund t'i kërkojë Dhomës Kombëtare të Noterëve caktimin e një noterit të autorizuar. Përfaqësuesit ligjorë të secilës shoqëri shqiptare, që merr pjesë në bashkimin ndërkuftar, publikojnë caktimin e noterit të autorizuar, në përputhje me kërkesat e nenit 8 të këtij ligji.

2. Noteri i autorizuar shqyrton kushtet juridike të bashkimit ndërkuftar dhe zbatimin e dispozitave ligjore, sipas kërkesave të këtij ligji, nga secila shoqëri shqiptare pjesëmarrëse dhe lëshon, për secilën prej tyre, certifikatën e parabashkimit, duke konfirmuar në mënyrë përfundimtare realizimin e rregullt të formaliteteve të parabashkimit nga këto shoqëri.

3. Noteri i autorizuar është i detyruar të bëjë publik çdo konflikt interesi që mund të ketë në çdo moment gjatë ndjekjes së procedurave të lëshimit të certifikatave të parabashkimit.

#### Neni 11

#### **Shqyrtimi i kushteve juridike të bashkimit ndërkuftar**

1. Nëse shoqëria që rezulton nga bashkimi është shoqëri shqiptare, atëherë secila shoqëri europiane pjesëmarrëse i dorëzon noterit të autorizuar, sipas përcaktimit të pikës 1 të nenit 10 të këtij ligji, certifikatën e parabashkimit, lëshuar nga autoriteti kompetent i vendit europian, sipas Direktivës së Bashkimit Ndërkuftar, jo më vonë se 6 muaj nga data e lëshimit të kësaj certifikate, së bashku me kushtet e përbashkëta të projekt marrëveshjes së bashkimit ndërkuftar, miratuar nga asambleja e përgjithshme e asaj shoqërie europiane.

2. Nëse shoqëria që rezulton nga bashkimi është shoqëri shqiptare, secila shoqëri pjesëmarrëse ka të drejtë t'i kërkojë Dhomës Kombëtare të Noterëve caktimin e një noterit tjetër të autorizuar, nëse vlerëson se ekzistojnë rrethana që mund të shkaktojnë konflikt interesi. Në këto raste, noterit i autorizuar, sipas përcaktimit të pikës 1 të nenit 10 të këtij ligji, pajis noterin e ri të autorizuar me kopje të vërtetuar të të gjitha dokumenteve të shoqërive shqiptare, të vlerësuara sipas nenit 10 të këtij ligji. Përfaqësuesit ligjorë të secilës shoqëri shqiptare, që merr pjesë në bashkimin ndërkuftar, publikojnë caktimin noterit ri të autorizuar, në përputhje me kërkesat e nenit 8 të këtij ligji.

3. Noteri i autorizuar, që shqyrton kushtet juridike të bashkimit ndërkuftar, është i detyruar të bëjë publik çdo konflikt interesi që mund të ketë në çdo moment, gjatë ndjekjes së procedurave të shqyrtimit, sipas përcaktimeve të këtij neni.

4. Pas marrjes së dokumentacionit, sipas pikës 1 të këtij neni, noterit i autorizuar sigurohet, në veçanti, që shoqëritë pjesëmarrëse në bashkim të kenë miratuar të njëjtat kushte të përbashkëta të projekt marrëveshjes së bashkimit ndërkuftar dhe, kur është e zbatueshme, që masat për pjesëmarrjen e punëmarrësve të jenë përcaktuar në përputhje me nenin 16 të këtij ligji. Nëse bashkimi ndërkuftar kryhet nëpërmjet themelimit të një shoqërie të re dhe shoqëria e re është shoqëri shqiptare, atëherë noterit i autorizuar shqyrton edhe procedurat e themelimit të shoqërisë së re.

5. Gjatë vlerësimit të kushteve e dokumentacionit të bashkimit ndërkuftar, sipas këtij neni, përputhshmëria e akteve të shoqërive europiane për bashkimin ndërkuftar me ligjin përkatës të vendit europian konsiderohet si përfundimisht e vërtetuar nga certifikata e parabashkimit, lëshuar sipas Direktivës së Bashkimit Ndërkuftar nga autoritetet kompetente të vendeve europiane përkatëse, dhe noterit i autorizuar vlerëson ekskluzivisht nëse certifikatat e parabashkimit janë lëshuar për të gjitha shoqëritë pjesëmarrëse, në përputhje me pikën 4 të këtij neni, si dhe me procedurat, sipas ligjit shqiptar për themelimin e shoqërisë së re shqiptare.



6. Në rastet e parashikuara nga ky nen, nëse noteri i autorizuar vlerëson se kushtet ligjore të bashkimit ndërkufitar janë realizuar nga shoqëritë pjesëmarrëse, atëherë ai vërteton lidhjen e marrëveshjes së bashkimit ndërkufitar, e cila ka formën e aktit noterial, sipas parashikimeve të ligjit shqiptar që rregullon noterinë, dhe i njofton QKR-së për regjistrim marrëveshjen e nënshkruar të bashkimit ndërkufitar.

7. Nëse shoqëria e re është shoqëri shqiptare, atëherë noteri i autorizuar, së bashku me marrëveshjen e realizimit të bashkimit ndërkufitar, i njofton QKR-së për regjistrim, sipas parashikimeve të ligjit që rregullon organizimin dhe funksionimin e këtij institucioni, edhe aktet e themelimit të shoqërisë së re, nënshkruar nga përfaqësuesit ligjorë të shoqërive pjesëmarrëse, akte të cilat nuk është e detyrueshme të hartohen në formën e aktit noterial.

8. Brenda 10 ditëve nga marrja e akteve të përcaktuara sipas pikave 6 e 7 të këtij neni, QKR-ja njofton të gjithë regjistrat tregtarë ku janë regjistruar shoqëritë europiane pjesëmarrëse, për kryerjen e regjistrimit të bashkimit ndërkufitar në favor të shoqërisë shqiptare që rezulton nga bashkimi.

9. Ministria, me kërkesë të Dhomës Kombëtare të Noterëve, i dërgon kësaj të fundit një listë të përditësuar të autoriteteve të caktuara nga secili vend europian për lëshimin e certifikatës së parabashkimit, sipas Direktivës së Bashkimit Ndërkufitar.

#### Neni 12

#### **Hyrja në fuqi dhe fillimi i efekteve të bashkimit ndërkufitar**

1. Nëse shoqëria që rezulton nga bashkimi është shoqëri shqiptare, atëherë bashkimi ndërkufitar hyn në fuqi në datën e regjistrimit në QKR, sipas rastit, të marrëveshjes së bashkimit ndërkufitar apo shoqërisë së re.

2. Nëse shoqëria që rezulton nga bashkimi është shoqëri europiane, bashkimi ndërkufitar hyn në fuqi në datën e përcaktuar sipas ligjit të vendit europian, në juridiksionin e të cilit vendoset shoqëria që rezulton nga bashkimi, sipas njoftimit që merr QKR-ja nga regjistri tregtar përkatës.

3. Bashkimi ndërkufitar, që ka hyrë në fuqi sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, nuk mund të deklarohet nul ose i pavlefshëm.

#### Neni 13

#### **Pasojat e bashkimit ndërkufitar**

1. Bashkimi ndërkufitar, i kryer sipas parashikimeve të shkronjave “a” dhe “c” të pikës 1 të nenit 3 të këtij ligji, në datën e përcaktuar sipas pikave 1 ose 2 të nenit 12 të këtij ligji, prodhon pasojat e mëposhtme:

a) të gjitha aktivet, të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë objekt i kalojnë menjëherë shoqërisë përthithëse, pavarësisht kërkesave ligjore për kryerjen e formaliteteve të posaçme, të cilat në çdo rast kanë efekt deklarativ;

b) ortakët ose aksionarët e shoqërisë objekt bëhen ortakë ose aksionarë të shoqërisë përthithëse;

c) shoqëria objekt konsiderohet e prishur dhe nëse shoqëria objekt është shoqëri shqiptare, atëherë ajo çregjistrohet menjëherë nga QKR-ja, në bazë të parashikimeve të ligjit të posaçëm që rregullon organizimin dhe funksionimin e këtij institucioni, pa kaluar në procesin e likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese.

2. Bashkimi ndërkufitar, i kryer sipas parashikimeve të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 3 të këtij ligji, në datën e përcaktuar sipas pikës 1 ose 2 të nenit 12 të këtij ligji, sipas rastit, prodhon pasojat e mëposhtme:

a) të gjitha aktivet dhe pasivet e shoqërisë objekt i kalojnë menjëherë shoqërisë së re, pavarësisht kërkesave ligjore për kryerjen e formaliteteve të posaçme, të cilat, në çdo rast, kanë efekt deklarativ;

b) ortakët ose aksionarët e shoqërisë objekt bëhen ortakë ose aksionarë të shoqërisë së re;

c) shoqëria objekt konsiderohet e prishur dhe nëse shoqëria objekt është shoqëri shqiptare, atëherë ajo çregjistrohet menjëherë nga QKR-ja, në bazë të parashikimeve të ligjit që rregullon organizimin dhe funksionimin e këtij institucioni, pa kaluar në procesin e likuidimit në gjendjen e aftësisë pague.

#### Neni 14

### **Të drejtat dhe detyrimet e shoqërive pjesëmarrëse në bashkim**

1. Nëse, sipas legjislacionit shqiptar, shoqëria shqiptare që rezulton nga bashkimi duhet të kryejë deklarime apo regjistrime të posaçme, në lidhje me kalimin e pasurive, të drejtave dhe detyrimeve që tashmë janë kaluar automatikisht nga shoqëria objekt, atëherë këto deklarime ose formalitete kryhen nga përfaqësuesit ligjorë të shoqërisë shqiptare që rezulton nga bashkimi.

2. Të drejtat dhe detyrimet ekzistuese të shoqërive shqiptare pjesëmarrëse, të cilat rrjedhin nga kontratat apo marrëdhëniet e punës në datën në të cilën bashkimi hyn në fuqi, sipas nenit 12 të këtij ligji, kalojnë në favor të shoqërisë që rezulton nga bashkimi.

3. Aksionet ose kuotat e kapitalit të shoqërisë përthithëse nuk mund të shkëmbehen me aksionet ose kuotat e shoqërisë objekt, të cilat zotërohen nga:

a) vetë shoqëria përthithëse, drejtpërdrejt apo nëpërmjet një personi që vepron në emër dhe/ose për llogari të saj;

b) vetë shoqëria objekt, drejtpërdrejt apo nëpërmjet një personi që vepron në emër dhe/ose për llogari të saj.

#### Neni 15

### **Procedurat e thjeshtuara**

1. Nëse në një bashkim ndërkuftar, të kryer sipas përcaktimeve të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 3 të këtij ligji, shoqëria përthithëse është shoqëri shqiptare, atëherë përcaktimet e shkronjave “b”, “c” dhe “d” të neneve 5, 7 dhe të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 13 të këtij ligji, nuk zbatohen. Pika 1 e nenit 9 të këtij ligji nuk zbatohet për shoqërinë objekt shqiptare.

2. Në rastet e përcaktuara sipas pikës 1 të këtij neni, përfaqësuesit ligjorë të secilës shoqëri objekt shqiptare, pjesëmarrëse, kryejnë gjithsesi publikimet e tjera, sipas nenit 8 të këtij ligji, duke llogaritur si afat publikimi një periudhë njëmuajore përpara datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme të shoqërisë përthithëse shqiptare, referuar në nenin 9 të këtij ligji, datë e cila duhet të bëhet publike nga shoqëria përthithëse.

3. Nëse shoqëria përthithëse është shoqëri shqiptare, e cila zotëron 90 për qind ose më shumë, por jo të gjitha kuotat ose aksionet me të drejtë vote në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë/shoqërive objekt, hartimi i raporteve të ekspertëve të pavarur dhe dokumentacioni tjetër i nevojshëm për shqyrtimin e kushteve të bashkimit ndërkuftar, sipas nenit 11 të këtij ligji, janë të detyrueshme vetëm kur këto dokumente kërkohen nga ligji i zbatueshëm në vendin europian, në territorin e të cilit është vendosur shoqëria objekt europiane.

#### KREU III

### **PJESËMARRJA E PUNËMARRËSVE**

#### Neni 16

### **Dispozitat e zbatueshme për pjesëmarrjen e punëmarrësve**

1. Në rastin kur shoqëria që rezulton nga bashkimi është shoqëri shqiptare, legjislacioni shqiptar për të drejtat e pjesëmarrjes së punëmarrësve në organizimin dhe funksionimin e shoqërisë zbatohet si për punëmarrësit e punësuar prej saj në Shqipëri, ashtu dhe për punëmarrësit e punësuar në vendet europiane, nga njësitë e prekura.



2. Pavarësisht përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni, në rastet e parashikuara në vijim të kësaj pike, të drejtat e punëmarrësve të punësuar në Shqipëri nga shoqëria shqiptare që rezultojnë nga bashkimi, si dhe ato të punëmarrësve të punësuar në një nga vendet europiane, nga njësitë e prekura, për pjesëmarrjen në organizimin dhe funksionimin e shoqërisë shqiptare që rezultojnë nga bashkimi, rregullohen sipas parashikimeve të neneve 17 deri në 23 të këtij ligji:

a) kur, të paktën, njëra prej shoqërive shqiptare ose europiane, pjesëmarrëse në bashkim, gjatë një periudhe gjatshëmujore përpara publikimit të kushteve të përbashkëta të projekt marrëveshjes së bashkimit, sipas parashikimeve të nenit 8 të këtij ligji, ka pasur një numër mesatar punëmarrësish më të lartë se 500 dhe kjo shoqëri zbaton një sistem pjesëmarrjeje që u njeh punëmarrësve mundësi të ushtrojë ndikim në drejtimin e shoqërisë, përmes:

i) së drejtës për të zgjedhur ose emëruar anëtarë të organeve mbikëqyrëse apo administrative të shoqërisë; ose

ii) së drejtës për të rekomanduar dhe/ose kundërshtuar emërimin e disa ose të gjithë anëtarëve të organeve mbikëqyrëse apo administrative të shoqërisë; ose

b) nëse legjislacioni shqiptar nuk parashikon të njëjtin nivel të pjesëmarrjes së punëmarrësve, për punëmarrësit e punësuar në një vend europian, nga njësitë e prekura, në krahasim me nivelin e pjesëmarrjes që zbatohet për punëmarrësit e punësuar në Shqipëri nga shoqëria shqiptare që rezultojnë nga bashkimi; ose

c) nëse legjislacioni shqiptar nuk u njeh punëmarrësve, të punësuar në një vend europian nga shoqëria shqiptare që rezultojnë nga bashkimi, të njëjtin nivel pjesëmarrjeje që u njehet punëmarrësve të saj të punësuar në Shqipëri.

#### Neni 17

### **Ruajtja e nivelit të pjesëmarrjes së punëmarrësve në nivelet përpara bashkimit**

1. Në rastet e parashikuara në pikën 2 të nenit 16 të këtij ligji, përfaqësuesit ligjorë të shoqërive pjesëmarrëse duhet të fillojnë procedurën e negociimit me përfaqësuesit e punëmarrësve, sipas parashikimeve të neneve 18 deri në 22 të këtij ligji.

2. Dispozitat për pjesëmarrjen e detyrueshme të punëmarrësve, sipas parashikimeve të nenit 18 të këtij ligji, zbatohen kur:

a) kjo vendoset në marrëveshje ndërmjet përfaqësuesve ligjorë të shoqërive pjesëmarrëse dhe organit të posaçëm të negociimit; ose

b) negociatat ndërmjet organit të posaçëm të negociimit dhe përfaqësuesve ligjorë të shoqërive pjesëmarrëse nuk kanë sjellë asnjë rezultat brenda 6 muajve pas krijimit të organit të posaçëm të negociimit, nëse periudha e negociimit nuk është zgjatuar me pëlqimin e ndërsjellë të palëve, deri në një vit nga data e krijimit të organit të posaçëm të negociimit; ose

c) përfaqësuesit ligjorë të shoqërive pjesëmarrëse vendosin të pranojnë zbatimin e kushteve të pjesëmarrjes së detyrueshme të punëmarrësve në organizimin dhe funksionimin e shoqërisë shqiptare që rezultojnë nga bashkimi, duke vazhduar me procedurat e bashkimit ndërkufitar; ose

ç) organi i posaçëm i negociimit nuk ka marrë një vendim, sipas pikës 3 të këtij neni.

3. Organi i posaçëm i negociimit, me shumicën e dy të tretave të të gjithë anëtarëve, të cilët përfaqësojnë të paktën dy të tretat e të gjithë punëmarrësve, duke përfshirë votat e anëtarëve që përfaqësojnë punëmarrësit e punësuar, të paktën në Shqipëri dhe në një vend europian, ose në dy vende europiane, mund të vendosë të ndërpresë negociatat e nisura dhe të zbatojë dispozitat për informimin dhe konsultimin e punëmarrësve, që janë në fuqi në Shqipëri ose në vendet europiane, ku njësitë e prekura kanë punësuar punëmarrës. Ky vendim ndërpret procedurën për lidhjen e marrëveshjes, sipas pikës 1 të këtij neni. Organi i posaçëm i negociimit mund të rimblidhet me kërkesë të shkruar të të paktën 10 për qind të punëmarrësve apo të përfaqësuesve të punëmarrësve, të njëjtit të prekura, jo më parë se dy vjet nga data e këtij vendimi, me përjashtim të rastit kur përfaqësuesit ligjorë të shoqërive pjesëmarrëse në bashkim dhe organi i posaçëm i negociimit vendosin të rihapin më herët negociatat. Nëse organi i posaçëm i negociimit vendos të rihapë negociatat me përfaqësuesit ligjorë të shoqërive pjesëmarrëse, por nuk arrihet asnjë marrëveshje, dispozitat e nenit 18 të këtij ligji nuk zbatohen.

4. Nëse në njësitë e prekura zbatohet më shumë se një sistem pjesëmarrjeje e punëmarrësve, atëherë organi i posaçëm i negocimit vendos se cili nga këto sisteme pjesëmarrjeje do të zbatohet në shoqërinë shqiptare që rezulton nga bashkimi.

5. Organi i posaçëm i negocimit njofton përfaqësuesit ligjorë të shoqërive pjesëmarrëse në bashkim për vendimet e marra, sipas pikave 3 e 4 të këtij neni.

#### Neni 18

### **Pjesëmarrja e detyrueshme në këshill, në mungesë të marrëveshjes**

1. Në rastet e parashikuara nga pika 2 e nenit 17 të këtij ligji, punëmarrësit e njësisve të prekura dhe/ose përfaqësuesit e tyre kanë të drejtë të zgjedhin ose të emërojnë një numër anëtarësh të organit mbikëqyrës të shoqërisë shqiptare që rezulton nga bashkimi, i cili është i barabartë me numrin më të lartë të anëtarëve, që punëmarrësit ose përfaqësuesit e tyre kishin të drejtë të zgjidhnin, në shoqëritë pjesëmarrëse, përpara hyrjes në fuqi të bashkimit ndërkuftar, sipas pikës 1 të nenit 12 të këtij ligji. Shoqëria shqiptare që rezulton nga bashkimi nuk është e detyruar t'ua njohë këto të drejta punëmarrësve të saj, nëse punëmarrësit e shoqërive, pjesëmarrëse përpara realizimit të bashkimit ndërkuftar, nuk kishin të drejtë të emëronin apo zgjidhnin asnjë anëtar në organet mbikëqyrëse të shoqërive pjesëmarrëse.

2. Nëse shoqëria shqiptare që rezulton nga bashkimi është një shoqëri aksionare, atëherë ajo duhet të organizohet me sistemin e administrimit me dy nivele, sipas parashikimeve të ligjit shqiptar që rregullon organizimin dhe funksionimin e shoqërive tregtare.

3. Nëse shoqëria shqiptare që rezulton nga bashkimi është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, atëherë ajo duhet të krijojë një organ të posaçëm, i cili duhet të ushtrojë këto funksione të mbikëqyrjes:

a) të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratorët;  
b) të përgatisë, me kërkesë të asamblesë së përgjithshme, propozimin e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, dhe t'i rekomandojë vendimet e nevojshme për t'u marrë, si dhe të mbikëqyrë zbatimin e vendimeve të asamblesë;

c) të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;

ç) të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;

d) të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;

dh) të sigurojë që pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratorët;

e) të sigurojë, kur kjo është e detyrueshme, sipas ligjit dhe/ose statutit, se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet, të paktën, një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur, e raporti i auditimit t'i vihet në dispozicion asamblesë së përgjithshme;

ë) t'i propozojë asamblesë së përgjithshme shpërblimin e administratorëve;

f) të miratojë marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5 për qind të aktiveve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare, të certifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emetimit të obligacioneve ose instrumenteve të tjera të borxhit.

4. Organi i posaçëm i negocimit vendos për ndarjen e mandateve të organeve administrative ose të mbikëqyrjes së shoqërisë shqiptare që rezulton nga bashkimi, në dispozicion të përfaqësuesve të punëmarrësve të punësuar në Shqipëri ose në vendet e ndryshme europiane, apo për mënyrën me të cilën punëmarrësit e shoqërisë shqiptare që rezulton nga bashkimi mund të rekomandojnë ose kundërshtojnë emërimin e anëtarëve të këtyre organeve, sipas raporteve proporcionale të numrit të punëmarrësve të punësuar në Shqipëri apo në vende europiane të ndryshme. Nëse numri i punëmarrësve të punësuar në Shqipëri ose në një vend europian nuk përputhet me këtë kriter proporcional, organi i posaçëm i negocimit përzgjedh një anëtar nga Shqipëria dhe një anëtar nga një ose më shumë vende europiane, ku ndodhet selia e regjistruar e shoqërisë së bashkuar. Secili vend europian mund të vendosë për shpërndarjen e vendeve të anëtarëve të organit administrativ ose mbikëqyrës që i jepen.



5. Çdo anëtar i organit administrativ apo mbikëqyrës të shoqërisë shqiptare që rezulton nga bashkimi, i cili është zgjedhur, emëruar apo rekomanduar nga organi i posaçëm i negocimit ose, në varësi të rrethanave, nga punëmarrësit, është anëtar me të drejta të plota, të njëjta me të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve që përfaqësojnë ortakët apo aksionarët, duke përfshirë edhe të drejtën e votës.

#### Neni 19

### **Krijimi dhe shpërbërja e organit të posaçëm të negocimit**

1. Përfaqësuesit ligjorë të shoqërive pjesëmarrëse në bashkim, jo më vonë se 5 ditë pas publikimit të kushteve të përbashkëta të projekt marrëveshjes së bashkimit ndërkufitar, duhet të marrin masat e nevojshme për të nisur, me përfaqësuesit e punëmarrësve të njësive të prekura, negociatat për përcaktimin e masave të pjesëmarrjes së punëmarrësve në organizimin dhe funksionimin e shoqërisë shqiptare që rezulton nga bashkimi, përfshi këtu dhënien e informacionit për identitetin e të gjitha njësive të prekura dhe numrin e punëmarrësve të secilës prej tyre.

2. Me qëllim nisjen e negociatave, sipas pikës 1 të këtij neni, punëmarrësit e njësive të prekura krijojnë një organ të posaçëm negociimi, sipas këtyre parashikimeve:

a) organi i posaçëm i negocimit përbëhet nga, të paktën, 10 anëtarë ose nga një numër më i lartë anëtarësh, të rënë dakord ndërmjet përfaqësuesve të punëmarrësve të njësive të prekura, të cilët emërohen ose zgjidhen, sipas përcaktimeve vijuese të kësaj pike, nga radhët e të gjithë punëmarrësve të njësive të prekura;

b) zgjedhja ose emërimi i anëtarëve të organit të posaçëm të negocimit bëhet nga përfaqësuesit përkatës të punëmarrësve, sipas shkronjës “a” të kësaj pike ose, në mungesë të tyre, nga të gjithë punëmarrësit e njësive të prekura. Zgjedhja ose emërimi bëhet sipas legjislacionit dhe/ose praktikës së zbatueshme për përfaqësimin e punëmarrësve në njësitë e prekura;

c) punëmarrësit e punësuar nga njësitë e prekura, përkatësisht në Shqipëri dhe në secilin vend europian, kanë të drejtë të emërojnë ose të zgjedhin bashkërisht, nga numri i përgjithshëm i mandateve të organit të posaçëm të negocimit, një numër anëtarësh, i cili është i barabartë me numrin që rezulton nga:

i) pjesëtimi i numrit të përgjithshëm të punëmarrësve të punësuar në Shqipëri dhe në secilin vend europian, nga të gjitha njësitë e prekura, me numrin e përgjithshëm të mandateve të organit të posaçëm të negocimit, përcaktuar sipas shkronjës “a” të kësaj pike; dhe

ii) duke pjesëtuar këtë rezultat me numrin e përgjithshëm të punëmarrësve të punësuar, përkatësisht në Shqipëri dhe në secilin vend europian; dhe

iii) nëse rezultati është një numër me presje dhjetore, duke rrumbullakosur këtë rezultat, në rritje apo në zbritje, në numrin e plotë më të afërt;

ç) nëse punëmarrësit e punësuar në Shqipëri punësohen nga më shumë se një prej njësive të prekura, atëherë, me përjashtim të rastit kur këta punëmarrës ose përfaqësuesit e tyre bien dakord ndryshe, formula e përfaqësimit proporcional, sipas shkronjës “c” të kësaj pike, zbatohet edhe ndërmjet këtyre punëmarrësve;

d) pavarësisht përcaktimeve të shkronjave “c dhe “ç” të kësaj pike, organi i posaçëm i negocimit rezervon një mandat shtesë për përfaqësuesit e punëmarrësve të secilës njësi të prekur, që ka punëmarrës në Shqipëri ose në një vend europian, dhe që propozohet të mbyllet, ose personi juridik të mos ekzistojë më pas hyrjes në fuqi të bashkimit ndërkufitar, me kusht që:

i) numri i përgjithshëm i këtyre mandateve shtesë të mos rrisë me më shumë se 20 për qind numrin e përgjithshëm të anëtarëve të organit të posaçëm të negocimit, të përcaktuar sipas shkronjës “a” të kësaj pike; dhe

ii) përbërja e organit të posaçëm të negocimit të mos ketë përfaqësim të dyfishtë të punëmarrësve përkatës;

dh) nëse numri i njësive të prekura është më i lartë se numri i mandateve shtesë, sipas nënndarjes “i” të shkronjës “d” të kësaj pike, këto vende shtesë do t’u vihen në dispozicion përfaqësuesve të punëmarrësve të njësive të prekura në Shqipëri apo në secilin vend europian, në rend zbritës, duke nisur

nga njësia e prekur që punëson më pak punëmarrës;

e) organi i posaçëm i negocimit miraton rregulloren e tij të organizimit e të funksionimit;

ë) organi i posaçëm i negocimit informon përfaqësuesit ligjorë të shoqërive pjesëmarrëse për formimin dhe përbërjen e tij.

3. Organi i posaçëm i negocimit dhe përfaqësuesit ligjorë të shoqërive pjesëmarrëse nisin negociatat për çështjet e parashikuara, sipas këtij ligji, menjëherë pas formimit të organit të posaçëm të negocimit, të cilat mund të vazhdojnë deri në gjashtë muaj në vijim, nëse ky afat nuk shtyhet për afatin dhe sipas përcaktimeve të shkronjës “b” të pikës 2 të nenit 17 të këtij ligji.

4. Organi i posaçëm i negocimit shpërbëhet në rastet e parashikuara në pikat 2 ose 3 të nenit 17 të këtij ligji. Në rast se arrihet një marrëveshje me përfaqësuesit ligjorë të shoqërive pjesëmarrëse, organi i posaçëm i negocimit shpërbëhet me formimin e organit përfaqësues të punëmarrësve, krijuar në bazë të marrëveshjes së arritur, sipas nenit 21 të këtij ligji.

## Neni 20

### Kompetencat e organit të posaçëm të negocimit

1. Organi i posaçëm i negocimit dhe përfaqësuesit ligjorë të shoqërive pjesëmarrëse vendosin, nëpërmjet një marrëveshjeje me shkrim, masat për pjesëmarrjen e punëmarrësve në organizimin dhe funksionimin e shoqërisë shqiptare që rezultojnë nga bashkimi. Për këtë qëllim, përfaqësuesit ligjorë të shoqërive pjesëmarrëse informojnë organin e posaçëm të negocimit, lidhur me planin dhe procesin faktik të regjistrimit të bashkimit në favor të shoqërisë përfituese shqiptare ose të themelimit të shoqërisë së re, deri në regjistrimin e saj.

2. Organi i posaçëm i negocimit është kompetent për çështjet që kanë të bëjnë me objektin e marrëveshjes, sipas nenit 21 të këtij ligji, apo çështje të tjera që rrjedhin nga bashkimi, për të cilat arrihet marrëveshje me përfaqësuesit ligjorë të shoqërive pjesëmarrëse.

3. Organi i posaçëm i negocimit vendos me shumicën e të gjithë anëtarëve të tij, me kusht që kjo shumicë të përfaqësojë edhe shumicën e të gjithë punëmarrësve të punësuar në Shqipëri dhe në secilin vend evropian, nga njësitë e prekura. Çdo anëtar i organit të posaçëm të negocimit ka një votë. Nëse rezultati i negociatave me përfaqësuesit ligjorë të shoqërive pjesëmarrëse sjell zvogëlim të të drejtave të pjesëmarrjes së punëmarrësve, organi i posaçëm i negocimit miraton këtë marrëveshje me votat e dy të tretave të anëtarëve, të cilët përfaqësojnë, të paktën, dy të tretat e të gjithë punëmarrësve të punësuar në Shqipëri dhe në secilin vend evropian. Kjo shumicë kërkohet vetëm kur, të paktën, 25 për qind e të gjithë punëmarrësve të punësuar nga njësitë prekura ndikohen nga ky zvogëlim në të drejtat e pjesëmarrjes. Zvogëlimi i të drejtave të pjesëmarrjes ndodh kur përqindja e anëtarëve të organeve të shoqërisë shqiptare që rezultojnë nga bashkimi është më e vogël se përqindja më e lartë, që ekzistonte në shoqëritë pjesëmarrëse përpara bashkimit.

4. Për qëllimet e negociatave, organi i posaçëm i negocimit mund të kërkojë të asistohet në punën e tij nga një a më shumë ekspertë, të cilët i zgjedh vetë, ndër të cilët mund të përfshihen edhe përfaqësues të sindikatave në nivel të Bashkimit Evropian.

5. Organi i posaçëm i negocimit mund të vendosë në çdo kohë të veprojë sipas pikës 3 të nenit 17 të këtij ligji.

6. Çdo shpenzim i kryer në lidhje me funksionimin e organit të posaçëm të negocimit dhe në përgjithësi me negociatat mbulohet nga shoqëritë pjesëmarrëse, për t'i dhënë mundësi organit të posaçëm të negocimit t'i kryejë detyrat në mënyrën e duhur. Shoqëritë pjesëmarrëse, përveçse kur bihet dakord ndryshe me organin e posaçëm të negocimit, mbulojnë veçanërisht kostot e organizimit të mbledhjeve, të shërbimeve të përkthimit me gojë dhe shpenzimet e strehimit e të udhëtimit të anëtarëve të organit të posaçëm të negocimit.





## Neni 21

### Përmbajtja e marrëveshjes

1. Përfaqësuesit ligjorë të shoqërive pjesëmarrëse dhe organi i posaçëm i negocimit negociojnë me frymën e bashkëpunimit për të arritur një marrëveshjeje për masat, në lidhje me pjesëmarrjen e punëmarrësve në organizimin dhe funksionimin e shoqërisë shqiptare që rezulton nga bashkimi.

2. Marrëveshja e përmendur në pikën 1 të këtij neni, pa cenuar autonominë negociuese të palëve, përmban veçanërisht:

- a) objektin;
- b) përbërjen, numrin e anëtarëve dhe shpërndarjen e vendeve të organit përfaqësues të punëmarrësve, i cili do të jetë partneri i diskutimeve të organit kompetent të shoqërisë shqiptare që rezulton nga bashkimi, në lidhje me masat për informimin dhe konsultimet e punëmarrësve të njësisve të prekura;
- c) funksionet dhe procedurën për informimin dhe konsultimin e organit përfaqësues;
- ç) shpeshhtësinë e mbledhjeve të organit përfaqësues;
- d) burimet financiare dhe materiale që do t'i caktohen organit përfaqësues;
- dh) masat për zbatimin e procedurave të informimit dhe konsultimeve, nëse, gjatë negocimit, palët vendosin procedura të tilla në vend të një organi përfaqësues;
- e) përmbajtjen e masave për pjesëmarrjen, nëse, gjatë negocimit, palët vendosin masa të tilla, duke përfshirë, nëse ka, numrin e anëtarëve të organit administrativ ose mbikëqyrës të shoqërisë shqiptare që rezulton nga bashkimi, që zgjidhen, emërohen, rekomandohen apo kundërshtohen nga punëmarrësit, procedurat se si mund të zgjidhen, emërohen, rekomandohen apo kundërshtohen këta anëtarë nga punëmarrësit, si dhe të drejtat e tyre;
- ë) datën e hyrjes në fuqi të marrëveshjes dhe kohëzgjatjen e saj, si dhe rastet kur duhet rinegociuar marrëveshja dhe procedura për rinegocimin e saj.

## Neni 22

### E drejta e informimit

1. Pa cenuar të drejtat e tjera, që i njihen sipas këtij ligji, organi i posaçëm i negocimit dhe, pas formimit të tij, organi përfaqësues i punëmarrësve, kanë të drejtën të informohen, të konsultohen dhe të takohen, për këtë qëllim, me përfaqësuesit ligjorë të shoqërive pjesëmarrëse dhe shoqërisë shqiptare që rezulton nga bashkimi.

2. Përfaqësuesit ligjorë i sigurojnë organit të posaçëm të negocimit dhe, pas formimit të tij, organit përfaqësues të punëmarrësve, rendin e ditës për mbledhjet e organit administrativ e, nëse ka, të organit mbikëqyrës, si edhe kopjet e të gjitha dokumenteve të depozituara në asamblenë e ortakëve apo aksionarëve.

3. Mbledhja zhvillohet në veçanti për strukturën, situatën ekonomike dhe financiare, zhvillimin e mundshëm të aktivitetit tregtar dhe të prodhimit e shitjeve, situatën dhe trendin e mundshëm të punësimit, të investimeve dhe ndryshimet me rëndësi, lidhur me organizimin, futjen e metodave të reja të punës apo të proceseve të reja të prodhimit, transferimin e prodhimit, bashkimet, shkurtimet apo mbylljet e ndërmarrjeve, njësisve ose pjesëve të rëndësishme të tyre dhe shkurtimet kolektive të vendeve të punës.

4. Organi i posaçëm i negocimit dhe, pas formimit të tij, organi përfaqësues i punëmarrësve, kanë të drejtën të informohen kur ka rrethana të veçanta, të cilat prekin në shkallë të konsiderueshme interesat e punëmarrësve, sidomos në rast të rivendosjeve, transferimeve, mbylljes së njësisve apo ndërmarrjeve ose në rast të shkurtimit kolektiv të vendeve të punës. Organi i posaçëm i negocimit dhe, pas formimit të tij, organi përfaqësues i punëmarrësve, ose kur vendoset kështu nga ky organ, sidomos për arsye urgjence, komiteti i përzgjedhur ka të drejtë, me kërkesën e vet, të takohet me përfaqësuesit ligjorë të shoqërisë përfituese, ose shoqërisë së re, apo me një nivel më të përshtatshëm të drejtuesve të shoqërisë, të cilët kanë kompetenca vendimarrëse, me qëllim informimin dhe konsultimin, lidhur me masat që prekin ndjeshëm interesat e punëmarrësve.

5. Përfaqësuesit ligjorë nuk vënë në dispozicion informacionin, përhapja e të cilit, për nga natyra e tij dhe sipas kritereve objektive, do të dëmtonte seriozisht funksionimin e shoqërisë shqiptare që rezulton nga bashkimi, apo të njëjsteve të prekura.

6. Nëse përfaqësuesit ligjorë nuk vënë në dispozicion të organit të posaçëm të negocimit dhe, pas formimit të tij, të organit përfaqësues të punëmarrësve, informacionin e kërkuar sipas këtij ligji, atëherë këta kanë të drejtë të kërkojnë dhënien e këtij informacioni në rrugë gjyqësore.

#### Neni 23

#### **Fshehtësia e informacionit**

1. Anëtarët e organit të posaçëm të negocimit dhe, pas formimit të tij, të organit përfaqësues të punëmarrësve, si dhe ekspertët që i asistojnë nuk lejohen të përhapin tek të tretët informacionin konfidencial që u është dhënë nga përfaqësuesit ligjorë, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

2. Ky detyrim nuk vazhdon të zbatohet edhe pasi personat e përmendur në këtë nen kanë pushuar së ushtruar mandatin e tyre.

3. Personi që shkel detyrimin e konfidencialitetit, përcaktuar sipas këtij neni, mban përgjegjësi civile dhe/ose penale, sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

#### KREU IV

#### DISPOZITA TË FUNDIT

#### Neni 24

#### **Mbrojtja e përfaqësuesve të punëmarrësve**

Anëtarët e organit të posaçëm të negocimit, anëtarët e organit përfaqësues, përfaqësuesit e punëmarrësve, që ushtrojnë funksione të informimit dhe konsultimit dhe përfaqësuesit e punëmarrësve në organin mbikëqyrës ose administrativ të shoqërisë shqiptare që rezulton nga bashkimi, të cilët janë punëmarrës të njëjsteve të prekura, gëzojnë, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, të njëjtën mbrojtje dhe garanci që u jep përfaqësuesve të punëmarrësve legjislacioni dhe/ose praktika e brendshme e shtetit ku janë në marrëdhënie pune.

#### Neni 25

#### **Mbrojtja e formimit dhe veprimtaria**

1. Askujt nuk i lejohet:

a) të pengojë formimin e organit të posaçëm të negocimit apo zgjedhjen e përfaqësuesve të punëmarrësve në këshillin mbikëqyrës ose në organin e posaçëm të mbikëqyrjes;

b) të pengojë ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të anëtarëve të organit të posaçëm të negocimit apo të përfaqësuesve të punëmarrësve në këshillin mbikëqyrës apo në organin e posaçëm të mbikëqyrjes;

c) të diskriminojë apo të preferojë një anëtar të organit të posaçëm të negocimit apo të përfaqësuesve të punëmarrësve në këshillin mbikëqyrës apo në organin e posaçëm të mbikëqyrjes.

2. Personi që shkel detyrimet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni mban përgjegjësi civile dhe/ose penale, sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

#### Neni 26

#### **Bashkime vijuese kombëtare**

Në rastin kur, pas një bashkimi ndërkuftar, shoqëria shqiptare që rezulton nga bashkimi bashkohet me një shoqëri tjetër shqiptare, atëherë pjesëmarrja e punëmarrësve rregullohet nga ligji shqiptar. Nëse ky nivel pjesëmarrjeje është më i ulët se niveli i arritur, sipas këtij ligji, në zbatim të bashkimit ndërkuftar, atëherë niveli i pjesëmarrjes së punëmarrësve, i arritur nëpërmjet zbatimit të



bashkimit ndërkufitar, do të vazhdojë të zbatohet edhe për tre vite pas regjistrimit në QKR të bashkimit kombëtar.

Neni 27  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 15.11.2012

**Shpallur me dekretin nr.7844, datë 3.12.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

**LIGJ**  
**Nr. 111/2012**

**PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË BURIMEVE UJORE<sup>2</sup>**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1  
**Qëllimi**

Ky ligj ka si qëllim:

- a) mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit ujor, të ujërave sipërfaqësore, qofshin të përkohshme apo të përhershme, të ujërave të brendshme detare, të ujërave territoriale, zonave ekonomike ekskluzive, shelfit kontinental, të ujërave ndërkufitare, të ujërave nëntokësore, si dhe të statusit të tyre;
- b) sigurimin, ruajtjen, zhvillimin dhe shfrytëzimin sa më racional të burimeve ujore, të domosdoshme për jetën dhe për zhvillimin social e ekonomik të vendit;
- c) shpërndarjen e drejtë të burimeve ujore, sipas qëllimeve të përdorimit dhe drejtimin e administrimit e efektshëm të tyre;
- ç) mbrojtjen e burimeve ujore nga ndotja, shpërdorimi dhe harxhimi mbi nevojat faktike;
- d) përcaktimin e kuadrit institucional, në nivel kombëtar e vendor, për vënien në jetë të një politike kombëtare për administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore në të mirë të komunitetit dhe interesave sociale dhe ekonomike të vendit.

<sup>2</sup> Ky ligj është përafëruar plotësisht me:

*Direktivën 2000/60/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 23 tetor 2000, "Ngritja e një kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujërave". Numri CELEX: 32000L0060, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 327, datë 22.12.2000, faqe 1 - 73.*

## Neni 2 Fusha e veprimit

1. Dispozitat e këtij ligji rregullojnë marrëdhëniet juridike që lindin nga përdorimi i burimeve ujore në Republikën e Shqipërisë.

2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për:

a) ujërat brendshme detare, ujërat territoriale, vijën bregdetare, zonën ekonomike ekskluzive, shelfin kontinental, ujërat sipërfaqësore e nëntokësore, së bashku me shtresat ujëmbajtëse dhe reshjet atmosferike, ujërat ndërkufitare, burimet natyrore dhe ujërat e lagunave e zonat e mbrojtura;

b) ujërat kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale, me përjashtim të ujërave minerale dhe gjeotermale që janë të përshtatshme për nxjerrjen e lëndëve të para minerare ose shfrytëzimin e energjisë termike të akumuluar për qëllime të prodhimit të energjisë, të cilat rregullohen me ligj të veçantë.

## Neni 3 Objekti i ligjit

Dispozitat e këtij ligji kanë si objekt të përcaktojnë:

a) sigurimin, mbrojtjen dhe shfrytëzimin racional të burimeve ujore;

b) zbatimin e planeve konkrete për përmirësimin e burimeve ujore, mbrojtjen e ujërave sipërfaqësore, të përkohshme apo të përhershme, të ujërave të brendshme detare, zonës ekonomike ekskluzive, shelfit kontinental, të ujërave ndërkufitare, të ujërave nëntokësore dhe të statusit të tyre;

c) promovimin e përdorimit të qëndrueshëm të ujit nëpërmjet mbrojtjes afatgjatë të burimeve ujore;

ç) zbatimin e metodave dhe kushtet për menaxhimin e integruar, përdorimin racional të burimeve ujore e mbrojtjen e cilësisë ekologjike të tyre;

d) krijimin e strukturave administrative për menaxhimin e burimeve ujore, si dhe ushtrimin e funksioneve të tyre;

dh) marrjen e masave për zbutjen efektive të përmytjeve dhe thatësirave;

e) monitorimin e statusit të ujërave, përdorimin racional dhe pakësimin e ndotjes;

ë) parandalimin e përkeqësimit të mëtejshëm, mbrojtjen dhe përmirësimin e gjendjes së brigjeve, të ekosistemeve tokësore dhe ligatinave që varen drejtpërdrejt nga ekosistemet ujore.

## Neni 4 Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Agjencia Kombëtare e Mjedisit” është institucioni që është ngritur dhe funksionon sipas ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

2. “Agjencia Rajonale e Mjedisit” është dega rajonale përkatëse e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

3. “Akuifer” është një apo disa shtresa nënsipërfaqësore të shkëmbinjeve a formacioneve të tjera gjeologjike të tokës, me porozitet dhe përshkueshmëri të mjaftueshme, që mundësojnë ose një rrjedhje të konsiderueshme të ujërave nëntokësore ose nxjerrjen e një sasive të konsiderueshme të ujërave nëntokësore.

4. “Autoriteti përkatës i qeverisjes vendore” është njësi e qeverisjes vendore, në territorin e së cilës kryhet veprimtaria lidhur me ujërat.

5. “Autorizim” është akti administrativ, me anën e të cilit i njihet titullarit të saj e drejta të kryejë një apo disa veprime, në përputhje me kushtet e përcaktuara në të. Formulari i autorizimit përcaktohet me vendim të Këshillit Kombëtar të Ujit.



6. “Autorizim i posaçëm” është akti administrativ, me anën e të cilit i njihet titullarit të saj e drejta të kryejë një veprim të caktuar, në përputhje me kushtet e përcaktuara në të. Formulari i këtij autorizimi përcaktohet me vendim të Këshillit Kombëtar të Ujit.

7. “Basen ujqor” është sipërfaqja e tokës prej ku, përmes një numri përrenjsh, lumenjsh apo edhe liqenesh, të gjitha rrjedhat sipërfaqësore derdhen në një lumë, i cili derdhet në det, në një grykëderdhje të gjerë të vetme, në një deltë apo në një lumë tjetër.

8. “Brigjet” janë rripat anësorë të tokës përgjatë deteve, liqeneve, rezervuarëve, lagunave dhe pellgjeve, si dhe përgjatë rrjedhës së shtratit të lumenjve e përrenjve që, në funksion të përdorimit, përfshijnë të paktën dy zona:

a) me gjerësi 5 m në drejtim normal me tokën nga brinja e sipërme e shtratit natyror në brigjet e pjerrëta dhe 20 m nga vija e nivelit maksimal të plotave me probabilitet përsëritjeje, një herë në 25 vjet, të ujit në brigjet e sheshta, që përdoret për qëllime publike me dispozita të veçanta;

b) me gjerësi 100 m në drejtim normal me tokën nga brinja e sipërme e shtratit natyror në brigjet e pjerrëta dhe 200 m nga vija e nivelit maksimal të plotave me probabilitet përsëritjeje një herë në 25 vjet të ujit në brigjet e sheshta, në të cilën çdo veprimtari e zhvilluar përcaktohet nga organet e administrimit a menaxhimit të burimeve ujore. Kufiri i ndarjes së bregut të pjerrët me bregun e sheshtë është pjerrësia 10 për qind në drejtim normal me bregun.

9. “Burimet ujore” janë të gjitha ujërat e brendshme detare, ujërat territoriale, vija bregdetare, zona ekonomike ekskluzive, shelfi kontinental, ujërat sipërfaqësore e nëntokësore, së bashku me shtresat ujëmbajtëse, reshjet atmosferike, nën juridiksionin dhe kontrollin e Republikës së Shqipërisë.

10. “Burimet ujore gjeotermale” janë ujërat që kanë temperatura vazhdimisht më të larta se temperaturat mesatare vjetore atmosferike të rajonit, me efektin e temperaturës së nëntokës, në varësi të strukturës gjeologjike, që mund të përmbajnë materiale të shkrira dhe gaz në një sasi më të lartë se burimet ujore përreth, ku uji, avujt dhe gazi natyrshëm shpërthejnë ose nxirren nga vendet ku ato mbahen nëpërmjet ngrohjes nga nëntoka ose nga shkëmbinj të thatë dhe të nxehtë, nëpërmjet strukturave nëntokësore të modifikuara nga njeriu.

11. “Burimet ujore minerale dhe termominerale” janë ujërat e ngrohta dhe të ftohta natyrore që ndodhen natyrshëm në thellësi të ndryshme të nëntokës e në kushte të përshtatshme gjeologjike, që ndodhen ose janë nxjerrë në sipërfaqe të tokës më vete nga një ose shumë burime, që janë të përcaktuara nga përmbajtja e tyre minerare apo komponentë të tjerë, të tillë si uji i pijshëm, uji kurativ dhe emra të ngjashëm.

12. “Enti Rregullator i Ujit (ERRU)” është institucioni që ushtron veprimtarinë në bazë të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1999 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar.

13. “Eutrofikim” është pasurimi i ujit me përbërës ushqyes, veçanërisht me komponime azotike ose fosforike që shkakton zhvillim të shtuar të algave dhe llojeve më të larta bimore, që krijojnë prishje të padëshirueshme të baraspeshës së organizmave të pranishëm në ujë dhe të kualitetit të këtij uji.

14. “Horizont ujqor” është një shtresë nënsipërfaqësore, shtresa të një shkëmbi ose shtresa të tjera gjeologjike me një porozitet të mjaftueshëm dhe një depërtueshmëri për të lejuar një rrjedhje të konsiderueshme të ujërave nëntokësore ose shkëputjen e sasive të konsiderueshme të tyre.

15. “Inspektorati që mbulon fushën e mjedisit” është autoriteti inspektues, sipas përcaktimit të dhënë në ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

16. “Kadastra Kombëtare e Burimeve Ujore” përmban inventarin publik ku regjistrohen të gjitha të dhënat për ujërat nëntokësore, ujërat sipërfaqësore dhe zonat e mbrojtura.

17. “KKU” është Këshilli Kombëtar i Ujit.

18. “Koncesion” është marrëveshja ndërmjet autoritetit kontraktues dhe koncesionarit, siç përcaktohet në ligjin nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar.

19. “Kontrollet e shkarkimeve” janë kontrollet që kërkojnë një kufi specifik të shkarkimit, për shembull një vleftë kufi të shkarkimit ose ndryshe specifikimin e kufijve apo kushteve mbi efektet, natyrën ose karakteristika të tjera të një emisioni ose kushtet operacionale, të cilat ndikojnë në shkarkimet.

20. “Kufi hidrografik i basenit ujëmbledhës” është vija imagjinare, e cila formohet duke lidhur pikat më të larta të peizazhit, si majat e maleve, kodrave, kreshtave që ndajnë luginat nga njëra-tjetra dhe që lë jashtë saj të gjitha degët e përrrenjve dhe lumenjve që rrjedhin në anë të kundërt.

21. “Kufijtë territorialë të menaxhimit” janë kufijtë artificialë të miratuar për arsye menaxhimi, brenda të cilëve përfshihen një ose më shumë basene apo pjesë basenesh hidrografike.

22. “Leje” është akti administrativ, sipas përcaktimit të bërë në ligjin nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

23. “Leje mjedisi” është leja e mjedisit e tipit A, B apo C, sipas rastit, siç përcaktohet në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”.

24. “Licencë” është akti administrativ, sipas përcaktimit të bërë në ligjin nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

25. “Ligji për mbrojtjen e mjedisit” është ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

26. “Liqen” është një trup me ujëra të brendshme sipërfaqësore dhe nëntokësore të qëndrueshme.

27. “Lumë” është një trup ujqor i brendshëm, me ujë, që në pjesën më të madhe të tij rrjedh mbi sipërfaqen e tokës, por që në një pjesë të rrjedhës së tij mund të rrjedhë edhe nën tokë.

28. “Ministër përgjegjës” është ministri që mbulon fushën e veprimtarisë, sipas përcaktimit të legjisllacionit në fuqi.

29. “Ministri” është ministri i ministrisë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore.

30. “Ministria” është ministria përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore.

31. “Mjedis” janë përbërësit natyrorë, si ajri, toka, ujërat, klima, flora dhe fauna në tërësinë e ndërveprimeve me njëra-tjetrën, si dhe trashëgimia kulturore, si pjesë e mjedisit të krijuar nga njeriu, sipas kuptimit të dhënë në ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

32. “Ndotës” është çdo substancë e rrezikshme që shkakton ndotje, sipas kuptimit të dhënë në ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

33. “Ndotje” është futja e drejtpërdrejtë ose jo, si rezultat i veprimtarisë së njeriut, e substancave, dridhjeve, rrezatimit, erërave të pakëndshme, nxehtësisë apo zhurmës në ajër, ujë apo tokë, në atë masë që mund të jetë e dëmshme për cilësinë e mjedisit ose shëndetin e njeriut, që mund të çojë në dëmtimin e pronës materiale apo të përkeqësojë dhe të ndërhyjë në shërbimet e përdorimit e tjera të ligjshme të mjedisit, sipas kuptimit të dhënë në ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

34. “Normë e cilësisë së mjedisit për ujërat” është përqendrimi i një substance ndotëse të veçantë ose i një grupi substancash ndotëse në ujë, në sedimente ose në biotë.

35. “Normë e cilësisë së ujërave nëntokësore” është norma mjedisore, teknike dhe shëndetësore që shprehet si përqendrim i një substance ndotëse të veçantë apo i një grupi substancash ndotëse ose si tregues i ndotjes së ujërave nëntokësore.

36. “Normë teknike e shkarkimit në mjedis” janë kufijtë e vlerave dhe të përqendrimeve të parametrave fiziko-kimikë të ujërave të ndotura industriale, të cilat derdhen në sistemin e kanalizimeve publike, sipas kuptimit të dhënë në vendimin nr. 1340, datë 11.12.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për furnizimin me ujë dhe kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës - kanalizimeve”.

37. “Përdorues” është çdo rreth, bashki, komunë, fshat, shoqatë e përdoruesve të ujit, ndërmarrje shtetërore apo private, person fizik dhe juridik, që merret me eksplorimin, prodhimin, përdorimin e burimeve ujore, shkarkon, trajton apo kryen çdo lloj aktiviteti tjetër në fushën e menaxhimit të ujërave, në përputhje me legjisllacionin në fuqi.

38. “Përdorim i ujit” janë shërbimet e ujit, si eksplorimi, prodhimi, përdorimi i burimeve ujore, shkarkimi, trajtimi apo kryerja e çdo lloj aktiviteti tjetër në fushën e menaxhimit të ujërave, duke pasur një impakt të rëndësishëm mbi statusin e ujit.

39. “Përmbytje” është mbulimi i përkohshëm nga uji i një toke që normalisht nuk mbulohet nga uji. Kjo përfshin përmbytjet nga lumenjtë, përrrenjtë malorë, nga shkarkimet e digave, rrjedhat ujore



kalimtare dhe përmbytjet nga deti në zonat bregdetare, me përjashtim të përmbytjeve nga sistemet e kanalizimit të ujërave të ndotura.

40. “Potencial i mirë ekologjik” është potenciali ekologjik i një trupi ujqor tepër të modifikuar ose i një trupi ujqor artificial, kur ai vlerësohet po aq “i mirë” sa është përcaktuar në akte ligjore të veçanta.

41. “Prurje me qëndrueshmëri 355 ditë (Q355)” është prurja bazuar në prurjen e mesatareve ditore të studimit hidrologjik, e cila nuk tejkalohet më shumë se 355 ditë në një vit. Kjo nënkupton se mesatarisht prurja natyrale është më e vogël se vlera e Q355 vetëm për 10 ditë të vitit.

42. “QKL” është Qendra Kombëtare e Licencimit, sipas përcaktimit të ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

43. “Regjistër Kombëtar i autorizimeve, lejeve dhe koncesioneve për përdorimin e burimeve ujqore” është portali i integruar i të dhënave elektronike, që shërben si instrument procedural publikimi, shpalljeje, që siguron transparencën në fushën e licencimit, të autorizimit dhe dhënies së lejeve.

44. “Regjistër Kombëtar i Licencave dhe Lejeve” është një portal i integruar të dhënash elektronike, që shërben si instrument procedural publikimi, shpalljeje, si dhe një arkiv elektronik zyrtar që siguron transparencën në fushën e licencimit, të autorizimit dhe dhënies së lejeve.

45. “Rreziku nga përmbytjet” është kombinimi i probabilitetit të ngjarjes së përmbytjes dhe të pasojave negative të mundshme për shëndetin e njeriut, për gjënë e gjallë, pronën, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe aktivitetin ekonomik që lidhet me ngjarjen e përmbytjes.

46. “Rrjedhje minimale ekologjike” është regjimi i rrjedhjes në një trup ujqor sipërfaqësor, shtrat lumor, basen ujqor apo zonë bregdetare, e nevojshme për të ruajtur një qëndrueshmëri të ekosistemit natyror dhe përfitimeve të tyre.

47. “Servituti” ka kuptimin që jepet nga dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

48. “Sistemi i kanalizimeve” janë të gjitha tubacionet, kolektorët, pajisjet, ndërtesat dhe strukturat, që shërbejnë për mbledhjen e ujërave të ndotura, stacionet e pompimit ose paratrajtimi i ujërave të ndotura nga njësitë e qeverisjes vendore, por që nuk përfshijnë ujërat e shiut. Instalimet e të tretëve për shkarkimin e ujërave të ndotura, janë, gjithashtu, pjesë e sistemit të kanalizimeve, si dhe pajisjet që duhen për implementimin, zgjerimin, rehabilitimin ose mirëmbajtjen e sistemit.

49. “Status ekologjik” është shprehja e cilësisë së strukturës dhe funksionimit të ekosistemeve ujqore, që lidhen me ujërat sipërfaqësore dhe klasifikohet në përputhje me akte të veçanta ligjore.

50. “Status i mirë ekologjik” është statusi ekologjik i arritur nga një trup ujqor sipërfaqësor që vlerësohet po aq “i mirë” sa është përcaktuar në akte të veçanta ligjore.

51. “Status i mirë i ujërave nëntokësore” është statusi i arritur nga një trup me ujëra nëntokësore, kur si statusi i tij sasior, ashtu edhe statusi i tij kimik vlerësohen të paktën po aq “të mirë”, siç përcaktohet në aktet ligjore në fuqi.

52. “Status i mirë i ujërave sipërfaqësore” është gjendja e arritur nga një trup ujqor sipërfaqësor, ku si gjendja e tij ekologjike, ashtu edhe gjendja e tij kimike janë vlerësuar të paktën po aq “të mira”, siç përcaktohet në aktet ligjore në fuqi.

53. “Status i mirë kimik i ujërave nëntokësore” është statusi kimik i një trupi ujqor nëntokësor që vlerësohet po aq “i mirë”, siç përcaktohet në aktet ligjore në fuqi.

54. “Status i mirë kimik i ujërave sipërfaqësore” është statusi kimik që kërkohet për të përmbushur objektivat mjedisore për ujërat sipërfaqësore, siç përcaktohet në aktet ligjore në fuqi.

55. “Status i mirë sasior i ujërave nëntokësore” është statusi sasior i një trupi ujqor nëntokësor që vlerësohet po aq “i mirë”, siç përcaktohet në aktet ligjore në fuqi.

56. “Status i ujërave nëntokësore” është shprehja e përgjithshme e statusit të një trupi ujqor nëntokësor, që përcaktohet nga statusi referuar limiteve të sipërme të standardit, siç përcaktohet në aktet ligjore në fuqi.

57. “Status i ujërave sipërfaqësore” është shprehja e përgjithshme e gjendjes së një trupi ujqor sipërfaqësor, që përcaktohet nga gjendja e tij ekologjike, cilësore dhe kimike më e varfër.

58. “Status sasior” është shprehja e masës, në të cilën një trup ujqor nëntokësor ndikohet nga nxjerrjet e drejtpërdrejta ose jo të drejtpërdrejta.

59. “Standarde të cilësisë mjedisore” është përqendrimi i ndotësve të veçantë ose i grupit të ndotësve në ujë, sedimente ose biota, i cili nuk duhet të tejkalohet, me qëllim mbrojtjen e shëndetit njerëzor dhe të mjedisit.

60. “STKKU” është Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit.

61. “Subjekt ndotës” është çdo person, fizik apo juridik, veprimtaria e drejtpërdrejtë ose jo e drejtpërdrejtë e të cilit shkakton ndotjen e mjedisit, sipas kuptimit që i është dhënë nga ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

62. “Substanca ndotëse” janë të gjitha substancat e prirura për të shkaktuar ndotje, në veçanti ato që janë përcaktuar si të tilla në akte ligjore e nënligjore specifike.

63. “Substanca prioritare” janë ato substanca ku përfshihen “substancat prioritare të rrezikshme”, të përcaktuara si të tilla në akte ligjore të veçanta, për ndalimin apo ndërprerjen e shkarkimeve, çlirimeve dhe humbjeve të të cilave duhen marrë masa të posaçme.

64. “Substanca të rrezikshme” është një substancë apo grup substancash, të cilat janë toksike, të qëndrueshme dhe me prirje për t’u akumuluar biologjikisht në mënyrë të natyrshme, si dhe substanca apo grupe të tjera substancash, të cilat paraqesin rrezikshmëri të ngjashme, sipas kuptimit që i është dhënë nga ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

65. “Shelfi kontinental” ka kuptimin që jepet nga dispozitat e Kodit Detar të Republikës së Shqipërisë.

66. “Shërbimet e ujit” janë të gjitha shërbimet që sigurojnë për konsumatorët familjarë, publikë e privatë, si dhe për veprimtaritë e biznesit, nxjerrjen, mbajtjen, ruajtjen, trajtimin dhe shpërndarjen e ujit sipërfaqësor ose nëntokësor, grumbullimin, largimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura, të cilat më pas shkarkohen në ujërat sipërfaqësore.

67. “Shkarkim në ujë” janë shkarkimet në trupat ujorë, ku përfshihen shkarkimet në rrjetin e tubacioneve të ujërave të ndotura dhe të shiut.

68. “Shkarkime industriale” janë mbetjet e lëngshme, të cilat prodhohen pas proceseve të ndryshme industriale, me rrezik kontaminimi ose ndotjeje të mjedisit ku ato shkarkohen.

69. “Titullar i licencës, autorizimit, lejes, koncesionit” është personi juridik apo fizik, që ka marrë një licencë, autorizim, leje apo koncesion.

70. “Trajtim i kombinuar” është kontrolli i shkarkimeve dhe derdhjeve në ujërat sipërfaqësore, sipas mënyrës së trajtimit të përcaktuar në akte nënligjore të veçanta.

71. “Trup me ujëra nëntokësore” është ai formacion gjeologjik që ka aftësinë e ujëmbajtjes në një vëllim dhe kusht të caktuar dhe që përbën një akuifer.

72. “Trup ujqor artificial” është trupi ujqor sipërfaqësor i krijuar nga veprimtaria njerëzore, si rezervuar, depo ruajtjeje, kanal, pellg për rritje peshku.

73. “Trup ujqor sipërfaqësor” është një element i dallueshëm dhe i rëndësishëm i ujërave sipërfaqësore, p.sh. një liqen, rezervuar, përrua, lumë ose kanal, një pjesë e një përroi, lumi ose kanali, ujëra të përkohshme ose një shtrirje e ujit bregdetar.

74. “Trup ujqor tepër i modifikuar” është trupi ujqor sipërfaqësor, i cili, si rezultat i ndryshimeve fizike nga aktiviteti njerëzor, ka ndryshuar rrënjësisht karakterin e tij në krahasim me atë që është shpallur me legjisllacionin përkatës nga autoriteti kompetent.

75. “Thatësiirë” është periudha e gjatë kohore me prurje të vogla, të cilat janë të pamjaftueshme për të plotësuar nevojat për ujë të një kategorie përdoruesish.

76. “Ujërat e brendshme detare” përfshijnë ujërat e limaneve detare, ngushticat, ujërat brenda arkipelagëve, detet e brendshme, hapësirat ujore mes vijës së baticës më të lartë dhe zbaticës më të ulët, si dhe deltat e lumenjve.

77. “Ujërat e ndotura industriale” janë të gjitha ujërat e përdorura që shkarkohen nga mjediset që përdoren për të zhvilluar veprimtari tregtare ose industriale, të cilat nuk janë ujëra të përdorura shtëpiake apo rrjedha të ujërave të shiut.

78. “Ujërat e ndotura shtëpiake” janë ujërat e përdorura nga zonat rezidenciale dhe sektori i shërbimeve, që e kanë origjinën kryesisht nga metabolizmi i njeriut dhe veprimtaritë e sektorit shtëpiak.





79. “Ujërat e ndotura urbane” janë ujërat e përdorura shtëpiake ose një përzierje e ujërave shtëpiake me ujëra të ndotura industriale dhe rrjedhat nga ujërat e shirave.

80. “Ujëra territoriale” kanë kuptimin që jepet nga dispozitat e Kodit Detar të Republikës së Shqipërisë.

81. “Uji i përdorur industrial” është uji i prodhuar nga proceset e ndryshme industriale, i cili mund të jetë me rrezik kontaminimi apo ndotjeje për mjedisin në të cilin ai shkarkohet.

82. “Ujë i pijshëm” është uji i përcaktuar për përdorim nga njerëzit, ku futen:

a) ujërat e trajtuara ose të patrajtuara, të përcaktuara për qëllim pirjeje, gatimi, përgatitjeje të ushqimeve dhe për nevojat e higjienës, pavarësisht nga origjina e tyre dhe nga fakti nëse janë furnizuar prej një rrjeti shpërndarës, publik apo privat, prej depozitave, prej autoboteve, prej puseve, individuale apo kolektive, apo të ambalazuara në shishe ose enë;

b) ujërat që përdoren në ndërmarrjet e prodhimit të ushqimeve për prodhimin, fabrikimin, përpunimin, ruajtjen apo tregtimin e prodhimeve ose lëndëve të përcaktuara për përdorim nga njerëzit, si dhe ujërat për pastrimin e sipërfaqeve, objekteve apo materialeve që mund të jenë në kontakt me artikuj ushqimorë;

c) artikujt ushqimorë me origjinë ujore;

ç) ujërat e furnizuara për përdorim nga njerëzit, si pjesë e një aktiviteti tregtar apo publik, pavarësisht nga sasia mesatare e ujit të furnizuar në ditë.

83. “Ujëra bregdetare” janë ujërat sipërfaqësore, të cilat ndodhen në brendësi të një vije imagjinare, e cila është e baraslarguar në secilën nga pikat e saj 1 milje detare nga pjesa e jashtme e pikës më të afërt të vijës bazë dhe që shërben si referim për të përcaktuar shtrirjen e ujërave territoriale dhe që shtrihen eventualisht deri në kufirin e jashtëm të ujërave transitore.

84. “Ujëra nëntokësore” janë të gjitha ujërat që ndodhen nën sipërfaqen e tokës apo kanë dalje të drejtpërdrejtë në sipërfaqen e tokës në formën e burimeve natyrore.

85. “Ujëra ndërkuftare” janë ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, të cilat përshkojnë ose janë të lokalizuara në kufijtë midis dy ose më shumë shteteve.

86. “Ujëra të brendshme” janë të gjitha ujërat e ndenjura ose ujërat e rrjedhshme mbi sipërfaqen e një terreni dhe të gjitha ujërat nëntokësore në drejtim të bazamentit të tokës, mbi të cilën është matur gjerësia territoriale e ujërave.

87. “Ujëra të përkohshme” janë trupat ujorë sipërfaqësorë në afërsi të grykëderdhjeve të lumenjve në det, që janë pjesërisht me karakter të kripur, si rezultat i afërsisë së tyre me ujërat bregdetare, por që kryesisht ndikohen nga rrjedha me ujëra të ëmbla.

88. “Ujëra sipërfaqësore” janë ujërat e brendshme, me përjashtim të ujërave nëntokësore, ujërat e përkohshme, ujërat bregdetare dhe ujërat territoriale.

89. “Vlefëta kufitare e shkarkimit” është masa, e shprehur në termat e parametrave specifike të sigurt, përqendrimi dhe niveli i shkarkimit, i cili mund të mos tejkalohet gjatë një ose më shumë periudhave kohore.

90. “Zona ekonomike ekskluzive” ka kuptimin që jepet nga dispozitat e Kodit Detar të Republikës së Shqipërisë.

91. “Zonë e mbrojtur” është çdo zonë e përcaktuar, sipas kuptimit të dhënë në ligjin nr. 8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar.

92. “Zona të veçanta ruajtjeje” janë zonat e përcaktuara, sipas kuptimit të dhënë në ligjin nr. 8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar.

93. “Zona termominerale” është ajo zonë, kufijet e së cilës janë përcaktuar me anë të studimeve të kryera nga institucionet e specializuara, kombëtare ose ndërkombëtare, bazuar në legjislativonin në fuqi dhe që përmbajnë burimet termominerale së bashku me ujërat natyrore minerale.

94. “Zonë e vërshimit” është sipërfaqja në të dyja anët e shtretërve të lumit ku parashikohet të ndodhin përmbytje të përkohshme.

## Neni 5

### Pronësia e burimeve ujore

1. Janë në pronësi të shtetit dhe në administrim të organeve shtetërore:

a) të gjitha burimet ujore të Republikës së Shqipërisë;

b) të gjithë shtretërit dhe brigjet e lumenjve, përrrenjve dhe rrjedhave të tjera natyrore, qofshin të përkohshme apo të përhershme, ujërat kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale, kanalet, liqenet, pellgjet, lagunat dhe ujëmbledhësit natyrorë apo artificialë, ishujt dhe grumbullimet e rërës, gurëve dhe dherave në shtretërit e lumenjve, liqeneve dhe ujëmbledhësve, si dhe formacionet gjeologjike të ujërave nëntokësore;

c) toka e përftuar nga tërheqja e ujit ose nga përparimi i tokës në drejtim të ujit, kur ajo lidhet me tokën, që është në pronësi të shtetit;

ç) të gjitha strukturat dhe punimet hidroteknike të realizuara nga shteti, si digat, sistemet e ujitjes, kullimit dhe lundrimit, stacionet e ujit të pijshëm dhe kanalet, si dhe punimet që lidhen me to.

2. E drejta e pronësisë së shtetit, sipas përcaktimeve në shkronjat "a", "b" dhe "c" të pikës 1 të këtij neni, është e patjetërsueshme dhe paparashkrueshme.

## Neni 6

### Parimet e menaxhimit të integruar të burimeve ujore

1. Menaxhimi i integruar i burimeve ujore bazohet në parimet e mëposhtme:

a) respektimi i integritetit të baseneve ujore, bazuar në kërkesat sociale dhe ekonomike për burime ujore, duke mbrojtur dhe ruajtur cilësinë e këtyre burimeve dhe cilësinë e mjedisit për brezat e ardhshëm;

b) koordinimi i kontrollit publik mbi burimet ujore përmes planifikimit të territorit dhe projekteve të zhvillimit social-ekonomik, në nivel kombëtar dhe vendor;

c) përdorimi racional i burimeve ujore dhe kontrolli i shkarkimeve;

ç) respektimi i parimit të rikuperimit të kostove të shërbimeve të ujit, përfshirë edhe kostot e mjedisit, në përputhje me parimin "ndotësi paguan";

d) parimet e mbrojtjes së mjedisit, të përcaktuara në ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit";

dh) garantimi i një furnizimi të mjaftueshëm të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore me cilësi të mirë për një përdorim ujor të qëndrueshëm, të ekuilibruar dhe të barabartë;

e) ndërmarrja e veprimeve parandaluese për të mos dëmtuar burimet ujore, si një përparësi, e cila duhet të korrigjohet që në burim.

2. Menaxhimi i integruar i burimeve ujore kontribuon në mënyrë të veçantë për:

a) sigurimin e një sasive të mjaftueshme ujërash sipërfaqësore dhe nëntokësore me cilësi të mirë, të nevojshme për një përdorim të qëndrueshëm, të balancuar dhe të drejtë të ujit;

b) reduktimin e ndjeshëm të ndotjes së ujërave nëntokësore;

c) arritjen e objektivave, në përputhje me marrëveshjet përkatëse ndërkombëtare, përfshirë edhe ato që synojnë të parandalojnë dhe t'i japin fund ndotjes së mjedisit detar.

## KREU II

### ORGANET E ADMINISTRIMIT DHE MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE

## Neni 7

### Organet kombëtare të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore

1. Organet qendrore për administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore janë:

a) Këshilli i Ministrave;

b) Këshillit Kombëtar i Ujit;



- c) Ministria;
- ç) Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit.
- 2. Organet vendore për menaxhimin e integruar të burimeve ujore janë:
  - a) këshillat e baseneve ujore;
  - b) agjencitë e baseneve ujore.

#### Neni 8

##### **Këshilli i Ministrave**

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Këshillit Kombëtar të Ujit, nëpërmjet ministrit:
  - a) miraton akte nënligjore për përmirësimin e legjislacionit për menaxhimin e integruar të burimeve ujore;
  - b) miraton përbërjen dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit;
2. Këshilli i Ministrave miraton përbërjen dhe rregulloren e funksionimit të Këshillit Kombëtar të Ujit, si dhe emëron një komision të posaçëm për administrimin e ujërave ndërkufitare.
3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Këshillit Kombëtar të Ujit:
  - a) përcakton kufijtë territorialë të çdo baseni ujqor të Republikës së Shqipërisë, si dhe qendrën dhe përbërjen e këshillit të secilit prej tyre;
  - b) miraton kufijtë hidrografikë të baseneve ujore.
4. Këshilli i Ministrave, pas miratimit në parim nga Këshilli Kombëtar i Ujit:
  - a) miraton planet e menaxhimit të baseneve ujore;
  - b) miraton Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore.

#### Neni 9

##### **Këshilli Kombëtar i Ujit**

1. Këshilli Kombëtar i Ujit është organi qendror vendimmarrës, përgjegjës për administrimin e burimeve ujore.
  2. Këshilli Kombëtar i Ujit është organ ndërministror që kryesohet nga Kryeministri dhe trajton çështjet e administrimit dhe menaxhimit të integruar të burimeve ujore.
  3. Kompetencat e Këshillit Kombëtar të Ujit janë:
    - a) miraton planet dhe projektet, ndërrajonale dhe kombëtare, në fushën e bujqësisë, urbanistikës, zhvillimit industrial e territorial, kur ato lidhen me ruajtjen dhe menaxhimin e ujërave;
    - b) merr masat e duhura për zbatimin e çdo marrëveshjeje ndërkombëtare, konvente për burimet ujore, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë;
    - c) jep leje dhe autorizime për përdorimin e ujit dhe për shkarkimet, kur veprimtaria kryhet jashtë kufirit të një baseni të vetëm;
    - ç) miraton në parim kërkesën për dhënie koncesioni për burimet ujore për rastet e parashikuara në vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave. Pas lidhjes së kontratës koncesionare, pajis koncesionarin me lejen për përdorimin e burimit ujqor, të nënshkruar nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Ujit.
- Kur këto burime ujore kanë rëndësi kombëtare, sipas përcaktimeve të Këshillit të Ministrave, marrëveshja e koncesionit hyn në fuqi pas ratifikimit nga Kuvendi;
- d) miraton rregulloren e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, të këshillit të basenit ujqor dhe të agjencisë së basenit ujqor.

#### Neni 10

##### **Ministria**

1. Ministria, në bashkëpunim me ministritë e linjës, harton dhe zbaton politika, strategji, programe dhe projekte që synojnë menaxhimin e integruar të burimeve ujore, ruajtjen sasiore dhe cilësore, si dhe konsolidimin e mëtejshëm të tyre.

2. Politikat e ministrisë orientohen drejt zhvillimit efikas dhe të qëndrueshëm të burimeve ujore, me qëllim rritjen e nivelit ekonomik dhe të cilësisë së jetës të brezave të sotëm dhe të ardhshëm.

3. Ministria është autoriteti kontraktues që, në përputhje me aktet ligjore në fuqi, është përgjegjëse për veprimtarinë ekonomike të burimeve ujore, për të cilën jepet koncesioni.

#### Neni 11

#### **Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit**

Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit është organ ekzekutiv i Këshillit Kombëtar të Ujit, i cili krijohet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe ka këto kompetenca:

- a) zbaton politikat kombëtare të burimeve ujore, të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Ujit;
- b) zbaton dispozitat e marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare për burimet ujore dhe ato ndërkufitare, palë e të cilave është edhe Republika e Shqipërisë;
- c) harton inventarin kombëtar të burimeve ujore, si në aspektin sasior, ashtu edhe në atë cilësor, sipas rregullave që vendos Këshilli Kombëtar i Ujit;
- ç) i propozon Këshillit Kombëtar të Ujit dhënien e lejeve dhe autorizimeve për përdorimin e ujit dhe shkarkimeve kur veprimtaria kryhet jashtë kufirit të një baseni të vetëm;
- d) kërkon nga organet dhe institucionet shtetërore, agjencitë dhe entet publike informacion, të dhëna teknike, analiza apo mbështetje tekniko-konsultative që shërbejnë për nevojat e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore;
- dh) organizon punën për përgatitjen e mbledhjeve të Këshillit Kombëtar të Ujit;
- e) nxit pjesëmarrësit e përdoruesve të ujit në drejtimin dhe administrimin e burimeve ujore;
- ë) nxit studime e kërkime për zhvillimin e novacioneve teknike që lidhen me përdorimin, zbulimin, shfrytëzimin, ruajtjen, trajtimin, mbrojtjen, administrimin dhe përdorimin efikas të burimeve ujore;
- f) në bashkëpunim me institucionet kërkimore-shkencore, përcakton fushat e kërkimit dhe studimit për burimet ujore, si dhe fondet përkatëse për to;
- g) bashkërendon dhe kontrollon punën me organet vendore të menaxhimit të burimeve ujore, si dhe ndjek procedurat e dhënies dhe zbatimin e lejeve dhe autorizimeve;
- gj) ndjek zbatimin e planeve të menaxhimit të baseneve ujore.

#### Neni 12

#### **Këshilli i basenit ujq**

1. Këshilli i basenit ujq është organi përgjegjës për menaxhimin e integruar të burimeve ujore në basenin përkatës, në nivel vendor.

2. Këshilli i basenit ujq ka këto detyra:

- a) siguron ruajtjen dhe zhvillimin sa më racional të burimeve ujore brenda kufijve të basenit përkatës ujq;
- b) siguron shpërndarjen e drejtë të burimeve ujore brenda kufirit të basenit përkatës ujq, sipas qëllimeve të përdorimit dhe drejtimin e administrimit e efektshëm të tyre;
- c) siguron mbrojtjen e burimeve ujore nga ndotjet, shpërdorimet dhe dëmtimet që prekin cilësinë dhe sasinë e tyre;
- ç) identifikon trupat ujqorë përkatës që kanë nevojë për mbrojtje.

2. Këshilli i basenit ujq ka status juridik publik dhe varet nga Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit.

#### Neni 13

#### **Agjencia e basenit ujq**

1. Agjencia e basenit ujq është struktura në varësi të ministrisë, e cila ngrihet dhe funksionon në çdo basen ujq.



2. Agjencia e basenit ujqor ka këto detyra:
- përpilon projektin e planit për burimet ujqore për basenin përkatës dhe e paraqet për miratim në këshillin e basenit ujqor;
  - harton inventarin e burimeve ujqore në sasi dhe cilësi, si dhe bën periodikisht përditësimin e tij;
  - nxit pjesëmarrjen e përdoruesve të ujit në drejtimin dhe administrimin e burimeve ujqore;
  - përgatit raporte, jep opinione për burimet ujqore dhe i paraqet ato për ndjekje të mëtejshme në këshillin e basenit ujqor;
  - përgatit materialet për mbledhjet e këshillit të basenit ujqor.
  - ndjek zbatimin e vendimeve të Këshillit Kombëtar të Ujit dhe këshillit të basenit ujqor.

### KREU III MENAXHIMI I BURIMEVE UJORE

#### Seksioni 1

#### **Ndarja e territorit për efekt të menaxhimit të burimeve ujqore**

##### Neni 14

#### **Basenet ujqore**

- Territori i Republikës së Shqipërisë, për qëllime të menaxhimit të burimeve ujqore, ndahet në basene ujqore.
- Ujërat nëntokësore, kur nuk ndjekin plotësisht një basen ujqor të veçantë, identifikohen dhe i caktohen basenit ujqor më të afërt.
- Ujërat bregdetare identifikohen dhe i caktohen basenit ujqor më të afërt.

#### Seksioni 2

#### **Dokumentet e planifikimit për menaxhimin e burimeve ujqore**

##### Neni 15

#### **Politikat**

Politikat janë niveli më i lartë i planifikimit dhe menaxhimit të integruar të burimeve ujqore, dokumentet e të cilave përmbajnë:

- qëllimin e planifikimit dhe të zhvillimit të menaxhimit të burimeve ujqore, në harmoni me zhvillimin ekonomik, demografik, social, mjedisor, kulturor dhe historik;
- masat e zbatimit;
- planin e punës dhe buxhetin e nevojshëm për zbatimin e tij.

##### Neni 16

#### **Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Burimeve Ujqore**

- Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Burimeve Ujqore është një dokument planifikimi që përcakton vizionin e politikave të shtetit, misionin, qëllimet dhe objektivat në fushën e menaxhimit të integruar të ujërave për një periudhë afatgjatë.
- Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Burimeve Ujqore bazohet në kërkimet shkencore, vëzhgimin e vazhdueshëm të situatës dhe fenomenet që kanë lidhje me ujin dhe përdorimin e tij, duke respektuar problemet specifike të ujit dhe mbrojtjes e integruar të mjedisit në çdo basen ujqor.
- Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Burimeve Ujqore është dokumenti kuadër për menaxhimin e ujërave për zhvillimin e planeve dhe dokumenteve të tjera strategjike në fushën e planifikimit territorial, mbrojtjes së mjedisit, diversitetit biologjik dhe peizazhit, bujqësisë, pylltarisë, peshkimit, transportit, turizmit, shëndetit publik dhe përmban edhe dokumente të tjera përkatëse.

4. Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Burimeve Ujore rishikohet çdo 15 vjet. Strategjia mund të rishikohet dhe të përditësohet edhe para përfundimit të këtij afati, në qoftë se një gjë e tillë diktohet nga ndryshimet në sistemin e ujërave dhe zhvillimet ekonomike dhe sociale të vendit.

5. Organet, entet, institucionet e specializuara në fushën e ujërave, nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e sekretariatit teknik, hartojnë Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore.

#### Neni 17

##### **Planet e menaxhimit të baseneve ujore**

1. Planet e menaxhimit të baseneve ujore hartohen në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe zbatohen për një territor dhe periudhë të përcaktuar.

2. Ministria, nëpërmjet Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, harton planet e menaxhimit të burimeve ujore, të cilat ia kalon për shqyrtim e miratim në parim Këshillit Kombëtar të Ujit. Pas miratimit nga Këshilli Kombëtar i Ujit, Këshilli i Ministrave miraton planet e menaxhimit të burimeve ujore.

3. Planet e menaxhimit të baseneve ujore rishikohen çdo gjashtë vjet.

#### Neni 18

##### **Bashkëpunimi ndërkombëtar**

1. Republika e Shqipërisë lidh marrëveshje me vendet fqinje, me qëllim vendosjen dhe promovimin e bashkëpunimit ndërmjet këtyre vendeve për mbrojtjen e ujërave ndërkufitare, për nevojën e forcimit të veprimit kombëtar dhe dypalësh, si dhe për parandalimin e ndotjes së burimeve ujore.

2. Bashkëpunimi ndërkufitar synon mbrojtjen e ujërave ndërkufitare në gjendjen e tyre natyrore, garantimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e jetës dhe ekosistemeve në to, duke nxitur zhvillimin e veprimtarive të dobishme, në përputhje me kërkesat e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm.

#### Neni 19

##### **Zbatimi i marrëveshjeve, konventave dhe protokolleve ndërkombëtare**

1. Për mbrojtjen e gjendjes natyrore të ujërave ndërkufitare veprojnë të gjitha aktet ligjore e nënligjore në fuqi për mbrojtjen e mjedisit në Republikën e Shqipërisë, si dhe marrëveshjet, konventat, protokollat ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.

2. Ujërat ndërkufitare mund të përdoren vetëm në mënyrë të kontrolluar dhe në kufij të përcaktuar shkencorë, pa dëmtuar kushtet natyrore dhe balancat biologjike dhe ekologjike të tyre.

3. Personat fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, që shfrytëzojnë pasuritë ujore, natyrore dhe biologjike të burimeve ujore, ose ushtrojnë veprimtari të ndryshme në to, janë të detyruar të mbrojnë ujërat ndërkufitare nga dëmtimet e mundshme dhe të zbatojnë dispozitat e këtij ligji.

4. Subjektet përkatëse, për projektet dhe veprimtaritë që kërkojnë të ushtrojnë në ujërat ndërkufitare, duhet të pajisen me leje mjedisore dhe për këtë përgatitet raport i thelluar i ndikimit në mjedisin ujor.

#### Neni 20

##### **Masat për mbrojtjen e ujërave ndërkufitare**

Ministria, në bashkëpunim dhe së bashku me ministrinë përkatëse, organizojnë punën për mbrojtjen e ujërave ndërkufitare, kontrollojnë zbatimin e kërkesave të këtij ligji dhe marrin pjesë në:

- a) hartimin dhe zbatimin e planeve të menaxhimit të ujërave ndërkufitare;
- b) hartimin dhe zbatimin e programeve të veçanta të monitorimit;
- c) hartimin dhe zbatimin e planeve për rehabilitimin e zonave të ndotura e të dëmtuara të ujërave ndërkufitare;



- ç) krijimin e kuadrit ligjor bashkëkohor për administrimin dhe mbrojtjen e ujërave ndërkufitare;
- d) sigurimin dhe përdorimin e frytshëm të mjeteve të nevojshme financiare;
- dh) kontrollin e vazhdueshëm për të siguruar ruajtjen e gjendjes natyrore të faunës dhe florës së ujërave ndërkufitare.

#### Neni 21

##### **Administrimi dhe menaxhimi i ujërave ndërkufitare**

1. Administrimi i ujërave ndërkufitare kryhet nga ministria në bazë të planeve të menaxhimit që hartohen nga Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit.
2. Në planet e menaxhimit për ujërat ndërkufitare përfshihen:
  - a) hartimi dhe zbatimi i këtyre planeve;
  - b) objektivat e menaxhimit të ujërave ndërkufitare;
  - c) identifikimi i detyrave të organeve të ndryshme shtetërore, të institucioneve studimore, të organizatave mjedisore për administrimin dhe mbrojtjen e ujërave ndërkufitare;
  - ç) masat për të mënjeluar apo reduktuar kërcënimet e identifikuara;
  - d) kushtet për kërkimin shkencor, inventarizimin dhe monitorimin;
  - dh) kushte të tjera të veçanta.

#### Neni 22

##### **Komisionet e posaçme për administrimin e ujërave ndërkufitare**

1. Për mbrojtjen dhe administrimin e ujërave ndërkufitare krijohen komisione të posaçme, përbërja, funksionet, përgjegjësitë dhe detyrat e të cilave rregullohen me akte ligjore e nënligjore të veçanta.
2. Me propozimin e Këshillit Kombëtar të Ujit, nëpërmjet ministrit, Këshilli i Ministrave emëron një komision të posaçëm, që ngarkohet me administrimin e ujërave ndërkufitare, administrimin e marrëdhënieve me shtetet kufitare për këto ujëra, duke u bazuar në legjislacionin shqiptar dhe në marrëveshjet përkatëse ndërkombëtare.

#### Neni 23

##### **Programe plotësuese**

1. Planet e menaxhimit mund të plotësohen me programe më të hollësishme për të trajtuar aspekte të veçanta të menaxhimit të burimeve ujore.
2. Këshilli Kombëtar i Ujit, me propozimin e ministrit, miraton kushtet dhe elementet përbërëse të programeve plotësuese.

#### Neni 24

##### **Hollësitë e strategjisë dhe të planit të menaxhimit të basenit ujq**

- Në Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujqore dhe planin e menaxhimit të basenit ujqor përfshihen:
- a) objektivat mjedisorë, referuar në nenin 25 të këtij ligji;
  - b) parametrat kimikë dhe ekologjikë për ujërat sipërfaqësore, siç përcaktohet në këtë ligj;
  - c) parametrat kimikë dhe sasiorë për statusin e ujërave nëntokësore, siç përcaktohet në këtë ligj;
  - ç) kushtet për shpalljen e trupave ujqorë tepër të modifikuar, referuar në nenin 27 të këtij ligji;
  - d) specifikimet teknike dhe metodat e standardizuara, lidhur me programin e monitorimit, siç përcaktohet në këtë ligj;
  - dh) specifikimet teknike për analizën e karakteristikave të baseneve ujqore, referuar në nenin 37 të këtij ligji;

- e) përmbajtja e programit të masave, referuar në nenin 37 të këtij ligji;
- ë) kushtet dhe masat përkatëse për planifikimin e menaxhimit të rrezikut nga përmytjet, referuar në nenet 68 e 69 të këtij ligji;
- f) çdo çështje tjetër që ka lidhje me zbatimin e planit të menaxhimit të basenit ujqor.

Seksioni 3  
**Klasifikimi i ujërave**

Neni 25  
**Objektivat mjedisorë**

1. Objektivat mjedisorë për trupat me ujëra sipërfaqësore, nëntokësore, si dhe për zonat e mbrojtura vendosen me qëllim parandalimin e dëmtimit të trupave ujqorë, si dhe mbrojtjen, shtimin dhe rehabilitimin e të gjithë trupave ujqorë, si sipërfaqësorë dhe nëntokësorë.
2. Objektivat mjedisorë, të përmendur në pikën 1 të këtij neni, përcaktohen duke marrë në konsideratë statusin e tyre kimik, ekologjik dhe sasior.
3. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit, miraton kriteret për vendosjen e objektivave mjedisorë.

Neni 26  
**Klasifikimi i ujërave**

1. Ujërat sipërfaqësore, me qëllim mbrojtjen dhe përmirësimin e statusit të ujqit, klasifikohen sipas statusit të tyre kimik dhe ekologjik.
2. Ujërat nëntokësore, me qëllim mbrojtjen dhe përmirësimin e statusit të ujqit, klasifikohen sipas statusit sasior dhe kimik.
3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Këshillit Kombëtar të Ujqit ose ministrit, përcakton ujërat, sipas klasifikimit të tyre.
4. Ministri, me propozimin e këshillit të basenit ujqor dhe institucioneve të specializuara shkencore që mbulojnë ujërat sipërfaqësore e nëntokësore, në përputhje me parashikimet e këtij neni, shpall trupat ujqorë artificialë ose tepër të modifikuar dhe e publikon shpalljen në Fletoren Zyrtare.
5. Trupat ujqorë, në bazë të klasifikimit të ujërave të tyre, janë pjesë përbërëse e planit të menaxhimit të basenit ujqor.

Neni 27  
**Trupat ujqorë tepër të modifikuar**

1. Ministri, me propozim të Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujqit dhe në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, ka të drejtë:
  - a) të shpallë trupa të caktuar ujqorë si artificialë ose tepër të modifikuar, kur objektivat mjedisorë në lidhje me statusin e mirë apo potencialin e mirë ekologjik të tyre nuk mund të arrihen për shkak të pamundësisë teknike ose kostove tepër të larta;
  - b) të zgjatë afatet për arritjen e objektivave mjedisorë, me kusht që të mos ndodhë asnjë përkeqësim i mëtejshëm në statusin e trupit ujqor të prekur;
  - c) të vendosë objektiva mjedisorë specifike për trupa ujqorë të caktuar, kur ata janë shumë të prekur nga aktiviteti njerëzor apo kur kushtet e tyre natyrore janë të tilla që e bëjnë arritjen e objektivave të përgjithshëm mjedisorë të përealizueshëm ose tepër të kushtueshëm.
2. Ministri, me propozim të këshillit të basenit ujqor, përcakton masa të përshtatshme për parandalimin e përkeqësimit të statusit të trupit që është shpallur si trup ujqor tepër i modifikuar.
3. Çdo shpallje e bërë sipas këtij neni dhe arsyet përkatëse përcaktohen në planin e menaxhimit të basenit ujqor përkatës.
4. Shpalljet e bëra në përputhje me këtë nen rishikohen çdo 6 vjet.





## KREU IV KONTROLLI I NDOTJES

### Seksioni 1 Normat e ujit

#### Neni 28

#### **Normat e cilësisë së mjedisit për burimet ujore**

1. Normat e cilësisë së mjedisit për ujërat përcaktohen në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, me qëllim parandalimin e përkeqësimit të cilësisë së ujit.
2. Normat e cilësisë së mjedisit për ujërat përcaktohen për të gjitha ujërat, përfshirë edhe ujërat nëntokësore.
3. Normat e cilësisë së mjedisit për ujërat përcaktohen për të gjitha burimet ujore apo duke iu referuar:
  - a) përdorimit aktual ose potencial, të cilit i nënshtrohet çdo trup ujqor i caktuar;
  - b) aktiviteteve që kryhen apo janë duke u kryer në trupa të tillë ujqorë;
  - c) atyre trupave ujqorë që, për të qenë në gjendje të mbështetin disa veprimtari të caktuara, kërkojnë mbrojtje.
4. Këshilli Kombëtar i Ujit identifikon trupat ujqorë, referuar në pikën 3 të këtij neni, sipas procedurës përkatëse dhe në afatet kohore të përcaktuara prej tij.

#### Neni 29

#### **Normat teknike të shkarkimit të ujërave në mjedis**

Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit, miraton normat teknike të shkarkimit në mjedis për ujin, për substancat e rrezikshme, për substancat dhe parametrat e tjerë, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, me qëllim parandalimin e përkeqësimit të cilësisë së ujit dhe mbrojtjen e mjedisit.

#### Neni 30

#### **Shkarkimet industriale dhe trajtimi i tyre**

1. Agjencitë e baseneve ujore, në bashkëpunim me agjencitë rajonale të mjedisit, përgatisin programet për parandalimin dhe shmangien e ndotjes së burimeve ujore pritëse nën juridiksionin e tyre, nga shkarkimet e lëngëta.
2. Shkarkimi në mjedis i ujërave të përdorura industriale duhet të realizohet në përputhje të plotë me kërkesat e përgjithshme e specifike për lloje të ndryshme të veprimtarive, si rezultat i të cilave kryhen shkarkime të lëngshme në mjedis, me qëllim mbrojtjen e ujërave nëntokësore apo sipërfaqësore nga kontaminimi apo ndotja.
3. Menaxhimi i ujërave të përdorura industriale duhet të realizohet nga subjekte, të cilat i prodhojnë dhe i shkarkojnë ato në zbatim të parimit “Ndotësi paguan”.
4. Menaxhimi i ujërave të përdorura industriale përfshin trajtimin e pjesshëm apo të plotë të tyre, në afërsi të zonës ku vendoset subjekti, i cili i prodhon ato apo në një zonë të caktuar industriale. Shkarkimet e lëngëta, pas trajtimit në impiantet e trajtimit të ujërave të përdorura, bëhen kundrejt një tarife dhe në përputhje me normat e cilësisë së këtyre ujërave.
5. Tarifat e shkarkimeve të lëngëta, të prodhuara nga trajtimi i ujërave të përdorura industriale, përcaktohen në bazë të sasisë së shkarkimit dhe përbërjes kimike të tyre.
6. Ujërat e ndotura, që nuk arrijnë karakteristikat e përcaktuara në akte nënligjore, ndalohen të shkarkohen direkt në tokë, në ujë dhe në sistemin publik të kanalizimeve.
7. Monitorimi i cilësisë, sasisë së prodhimit të ujërave të përdorura industriale dhe shkarkimeve në mjedisin ujqor sipërfaqësor apo nëntokësor pas trajtimit duhet të kryhet nga organet e përcaktuara me ligje të veçanta.

Neni 31

**Cilësia e ujit të pijshëm**

1. Këshilli i Ministrave, me propozim të Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë, përcakton kërkesat e cilësisë për ujin e pijshëm.

2. Çdo person fizik a juridik, publik apo privat, që ofron ose shet në publik ujë të pijshëm, detyrohet të jetë i pajisur me leje apo autorizimin përkatës, si dhe të përmbushë kërkesat e cilësisë së ujit të pijshëm, sipas akteve ligjore në fuqi.

3. Njësitë e qeverisjes vendore dhe çdo institucion tjetër, publik a privat, që kanë sistemin e tyre të furnizimit me ujë, detyrohen të marrin masa për një kontroll të rregullt të cilësisë së ujit të furnizuar.

4. Ministri përgjegjës për shëndetësinë, nëpërmjet inspektoratit që mbulon fushën e shëndetit, urdhëron ndërprerjen e furnizimit me ujë të pijshëm në qoftë se ai nuk plotëson normat e cilësisë.

Seksioni 2

**Kontrolli i ndotjes**

Neni 32

**Trajtimi i kombinuar**

1. Kontrolli i ndotjes bazohet në parimin e trajtimit të kombinuar dhe synon parandalimin e përkeqësimit, shtimin dhe kthimin në gjendje të pranueshme të trupave me ujëra sipërfaqësore.

2. Kontrolli i ndotjes realizohet nëpërmjet zbatimit të vlerave përkatëse kufi të shkarkimeve, bazuar në teknikat më të mira të disponueshme apo dhe në praktikat më të mira mjedisore kur ndikimet janë të shpërndara.

3. Kontrollat më të plota e më të hollësishme për shkarkimet kryhen, sipas rastit, kur një objektiv mjedisor ose normë mjedisore e cilësisë së ujit kërkon kushte më specifike sesa ato të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 33

**Lejet e mjedisit**

Çdo person fizik ose juridik, që ushtron një aktivitet, prej të cilit shkarkohen ujëra të ndotura në trupat ujorë, duhet të ketë lejen përkatëse të mjedisit, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”.

Neni 34

**Zonat e mbrojtura**

1. Zonat e mbrojtura, në bazë të këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore, përcaktohen me qëllim mbrojtjen e ujërave dhe ekosistemeve ujore dhe përfshijnë masa të veçanta mbrojtëse.

2. Në zonat e mbrojtura përfshihen:

a) zonat higjieno-sanitare për mbrojtjen e burimeve ujore, të përcaktuara për prodhimin e ujit të pijshëm;

b) zonat e mbrojtura, të përcaktuara sipas ligjit nr. 8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar;

c) zonat për peshkim dhe rritjen e butakëve, sipas legjislacionit për peshkimin;

ç) zonat për banjat termale, për trajtimin kurativ dhe rekreacion;

d) zonat e prirura ndaj eutrofikimit dhe zonat në rrezik nga nitratet e nitritet;

dh) zonat e synuara për mbrojtjen e bimëve apo kafshëve, si dhe të habitateve, ku ruajtja apo përmirësimi i statusit të ujit është një element i rëndësishëm i mbrojtjes së tyre.

3. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit, shpall zonat e mbrojtura, të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.



4. Këshillat e baseneve ujore dhe ministria hartojnë, menaxhojnë dhe përditësojnë inventarin e zonave të mbrojtura, si pjesë përbërëse e planit të menaxhimit të zonave të mbrojtura.

5. Plani i menaxhimit të zonës së mbrojtur përfshihet në planin e menaxhimit të basenit ujor përkatës.

#### Neni 35

### **Mbrojtja e zonave të prirura ndaj ndotjes**

1. Ministri harton aktet përkatëse nënligjore për shpalljen e zonave në rrezik nga ndotja prej elementeve apo substancave të dëmshme, si nitratat, fosfatet, produktet për mbrojtjen e bimëve, biocidet dhe i paraqet për miratim në Këshillin Kombëtar të Ujit.

2. Ministri, në bashkëpunim me ministrin përgjegjës për bujqësinë, ministrin përgjegjës për ekonominë dhe ministrin përgjegjës për shëndetësinë, nxjerr rregullore, ku përcaktohen programet, masat dhe detyrimet e tjera përkatëse, me qëllim reduktimin dhe parandalimin e ndotjes së ujërave nga substancat e dëmshme, si ato të cituara në pikën 1 të këtij neni, ashtu edhe ato që shkaktohen apo rrjedhin nga veprimtari të tjera bujqësore.

3. Trajtimi i kombinuar, siç përcaktohet në nenin 32 të këtij ligji, zbatohet për shkarkimet nga pikat dhe burimet shpërndarëse në zonat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

#### Seksioni 3

### **Masat për mbrojtjen e burimeve ujore**

#### Neni 36

### **Karakteristikat e baseneve ujore**

1. Këshilli i Basenit Ujor kryen për çdo basen ujor përkatës vlerësimin e ndikimit të aktivitetit njerëzor në statusin e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, analizën ekonomike të përdorimit të ujërave, si dhe analiza pas monitorimeve të kryera nga subjektet e kontraktuara nga ministria.

2. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit, përcakton me akt nënligjor specifikimet teknike të nevojshme për kryerjen e analizave dhe rishikimeve, siç përcaktohet në pikën 1 të këtij neni.

3. Analizat dhe vlerësimet e përcaktuara në këtë nen do të kryhen pas miratimit të planeve të menaxhimit të baseneve ujore dhe do të përditësohen rregullisht.

#### Neni 37

### **Programet e masave për objektivat mjedisore**

1. Këshilli i basenit ujor, me qëllim arritjen e objektiveve mjedisore të përcaktuara në nenin 25 të këtij ligji, harton programin e masave për basenin ujor, duke marrë në konsideratë rezultatet e analizave, siç përcaktohet në nenin 36 të këtij ligji.

2. Programi i masave për basenin ujor rishikohet çdo 6 vjet dhe, në qoftë se është e nevojshme, përditësohet.

3. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit, miraton programin e masave, të hartuar nga çdo këshill baseni ujor.

#### KREU V

### **PËRDORIMI I BURIMEVE UJORE**

#### Neni 38

### **Qëllimet e përdorimit të burimeve ujore**

Burimet ujore përdoren për:

- a) qëllimet shtëpiake, komunale, bujqësore, përfshirë ujitjen dhe ujin për blegtorinë;
- b) akuakulturë, transport uJOR, industrial, prodhim hidroenergjetik;
- c) tregti;
- ç) turizëm, argëtim, përfshirë lundrimin për argëtim;
- d) qëllime të tjera, të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Ujërave.

#### Neni 39

#### **Përdorimi i burimeve ujore**

1. Përdorimi i burimeve ujore natyrore i nënshtrohet kontrollit administrativ nga organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore dhe inspektimit nga inspektorët që mbulojnë fushën e mjedisit.

2. Çdo përdorues i ujit është i detyruar që në rrjedhën natyrore të lejojë rrjedhjen minimale ekologjike, duke mos e përfshirë atë në sasinë e ujit që është i autorizuar të përdorë.

3. Sasia e rrjedhjes minimale ekologjike për çdo trup uJOR natyror përcaktohet sipas planeve të menaxhimit të baseneve dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore, duke u bazuar në karakteristikat specifike dhe vlerat natyrore e ekologjike që ka baseni uJOR.

4. Pavarësisht nga sasia e rrjedhjes ekologjike që përcaktohet në planet e menaxhimit të baseneve, ajo nuk mund të jetë më e vogël se prurja me qëndrueshmëri 355 ditë në vit (Q355).

#### Neni 40

#### **Përdorimi i lirë i burimeve ujore**

1. Kushdo ka të drejtë të përdorë lirisht burimet ujore sipërfaqësore për të pirë dhe për nevoja të tjera shtëpiake e të blegtorisë, pa tejkalar nevojat, sasinë e nevojshme për plotësimin e nevojave individuale dhe familjare të përdoruesit dhe në përputhje me ligjet dhe planet përkatëse të këshillave të baseneve.

2. Kushdo ka të drejtë të përdorë lirisht ujërat e brigjeve për t'u larë dhe për sporte ujore.

3. Kushdo ka të drejtë të përdorë burimet ujore në rastet e rënies së zjarrit për shuarjen e tij.

4. Kushdo ka të drejtë të përdorë ujin e shiut që bie në tokë private, me kusht që ky ujë të mos jetë mbledhur në instalime artificiale.

5. Organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore kanë të drejtë që gjatë periudhave të mungesës së ujit dhe thatësirave apo kur cilësia e ujit është cenuar, kur përhapen ose ka rrezik të përhapen sëmundje të shkaktuara nga uji, të kufizojnë përdorimin e lirë të ujit në të gjithë vendin ose në zona të veçanta.

#### Neni 41

#### **Përdorimi me leje i ujit**

1. Veprimtaritë e mëposhtme, që mund të kryhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, do të ushtrohen në bazë të lejes administrative të lëshuar nga organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore.

- a) Përdorimi i ujit, kur ky realizohet me instalime të përhershme.
- b) Ujitja.
- c) Përdorime industriale të ujit sipërfaqësor.
- ç) Ujë për pishina.
- d) Ujë i ambalazhuar.
- dh) Ujërat kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale.
- e) Shfrytëzimi i ujërave nëntokësore për qëllime të ndryshme.
- ë) Dhënia në përdorim e burimeve ujore për zhvillimin e akuakulturës.



2. Për përdorimet e mëposhtme kërkohet leja përkatëse e Këshillit Kombëtar të Ujit.
  - a) Lundrueshmëria.
  - b) Ndërtimi i strukturave ankoruese, portuale, i veprave mbrojtëse bregdetare dhe ishujve artificialë në det.
  - c) Përdorimi i ujërave detare për prodhim hidroenergjie.
3. Këshilli i Ministrave, me propozim të Këshillit Kombëtar të Ujit, miraton formularin e kërkesës për leje për përdorim të burimeve ujore.

#### Neni 42

#### **Përdorimi i ujit me autorizim**

1. Veprimtaritë e mëposhtme mund të kryhen vetëm pasi subjektet përkatëse të pajisen me autorizim nga organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore:
  - a) dhënia e ujit bagëtime, kur shoqërohet me instalime tubacionesh dhe ndërtime objektesh;
  - b) shfrytëzimi i ujërave nëntokësore për qëllime familjare;
  - c) përdorimi ose ripërdorimi i ujërave të përdorura, përfshirë aplikimin e tyre në tokë.
2. Përdorimi i burimeve ujore për qëllime dhe aktivitete peshkimi përcaktohet me akte ligjore e nënligjore që rregullojnë këto veprimtari.
3. Të gjitha llojet e kërkimeve, studimeve dhe eksplorimeve në ujërat sipërfaqësore e nëntokësore, edhe kur nuk kanë për objekt ujin, kryhen me autorizim nga organet përkatëse të ujit, për një zonë dhe për një afat të caktuar.
4. Përfshihen nga kjo kërkesë institucionet monitoruese të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, si dhe institucionet shkencore, veprimtaritë e të cilave nuk ndikojnë në prishjen e ekuilibrit sasiorë dhe cilësorë të ujërave.
5. Këshilli i Ministrave, me propozim të Këshillit Kombëtar të Ujit, miraton formularin e kërkesës për autorizim për përdorim të burimeve ujore.

#### Neni 43

#### **Dhënia e koncesioneve për përdorimin e burimeve ujore**

1. Dhënia e koncesioneve për përdorimin e burimeve ujore bëhet në përputhje me ligjin nr. 9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", të ndryshuar dhe aktet nënligjore që përcaktojnë kërkesa dhe procedura për dhënie të koncesioneve.
2. Organi kontraktues i menaxhimit të burimeve ujore kombëtare mban regjistrin e koncesionit. Ky regjistër administrohet dhe ruhet nga organi përkatës kontraktues, sipas kërkesave të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat".

#### Neni 44

#### **Shfrytëzimi i materialeve inerte**

1. Organet e menaxhimit të burimeve ujore lëshojnë leje administrative për shfrytëzimin e materialeve inerte, si rërë, zhavorr, që nxirren nga shtretërit e lumenjve, përrenjve, liqeneve me ose pa ujë, vetëm në qoftë se plotësohen kushtet dhe kriteret ligjore, të përcaktuara me akte nënligjore.
2. Këshilli i Ministrave, me propozim të Këshillit Kombëtar të Ujit, miraton formularin e kërkesës për leje dhe rinovim për shfrytëzim materialeve inerte nga shtretërit e lumenjve.

#### Neni 45

#### **Detyrat e përdoruesve të ujit**

Përdoruesit e ujit duhet:

- a) të përdorin ujin në mënyrë racionale dhe ekonomike;
- b) të respektojnë kushtet dhe detyrimet e vëna mbi të drejtën e përdorimit të ujit;

- c) të respektojnë kushtet dhe detyrimet e përcaktuara mbi të drejtën e pronësisë;
- ç) të sigurojnë mbrojtjen e ujit nga ndotja, të mbajnë nën kontroll cilësinë e ujit dhe të mbrojnë mjedisin nga ndotësit e ndryshëm;
- d) të respektojnë të drejtat e përdoruesve të tjerë të ligjshëm të ujërave dhe të palëve të treta.

Neni 46

**Thatësira dhe mungesa e ujit**

Këshilli Kombëtar i Ujit, me propozimin e ministrit, në kushtet e thatësirës apo të mungesës së ujit, nxjerr vendim për marrjen e masave të nevojshme për thatësinë, i cili publikohet në Fletoren Zyrtare. Në këtë vendim përcaktohen:

- a) kufizime në disa ose në të gjitha veprimtaritë që përfshijnë përdorimin e burimeve ujore;
- b) kufizimi i përdorimit të ujit, në përputhje me licencat, autorizimet, lejet dhe koncesionet për përdorimin e ujit.

Neni 47

**Trupat ujorë që përdoren si ujë i destinuar për pirje**

1. Këshilli i basenit ujor për basenin ujor përkatës duhet të identifikojë në mënyrë të veçantë:
  - a) të gjitha trupat ujorë të destinuar për konsum njerëzor, që japin mesatarisht mbi 10 m<sup>3</sup> në ditë ose që furnizojnë më shumë se 50 njerëz;
  - b) të gjithë trupat ujorë të destinuar për përdorime të tilla në të ardhmen.
2. Këshilli i basenit ujor dhe organet përkatëse të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore duhet të sigurojnë mbrojtjen e burimeve ujore të referuara në këtë nen, me qëllim që të shmangin përkeqësimin e cilësisë së tyre dhe të kryejnë pastrimin e nevojshëm në atë nivel, me qëllim përftimin e ujit të pijshëm.
3. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit, miraton zonat e mbrojtjes sanitare për burimet ujore të përcaktuara në këtë nen dhe dispozitat rregullatore për zbatimin e këtyre parashikimeve ligjore.

KREU VI

**BURIMET E UJËRAVE KURATIVE, MINERALE, TERMOMINERALE  
DHE GJEOTERMALE**

Neni 48

**Menaxhimi i burimeve natyrore të ujërave kurative, minerale, termominerale  
dhe gjeotermale**

1. Menaxhimi i integruar mbi burimet natyrore të ujërave kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale ka të bëjë me krijimin e një kuadri për mbrojtjen e këtyre burimeve me qëllim:
  - a) monitorimin e cilësisë së ujërave kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale nga ministria, ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe ministria përgjegjëse për ekonominë;
  - b) promovimin e përdorimit racional e të qëndrueshëm të këtyre ujërave, i cili kryhet duke u bazuar në mbrojtjen afatgjatë të burimeve natyrore, të ujërave kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale;
  - c) reduktimin progresiv të ndotjes së burimeve natyrore të ujërave kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale, me qëllim parandalimin e ndotjes së mëtejshme të tyre;
  - ç) ndalimin e ndërtimeve rreth zonave të burimeve natyrore të ujërave kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale pa lejen e organeve të menaxhimit të burimeve ujore;
  - d) parandalimin e shkarkimeve të ujërave kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale të përdorura dhe të patrajuara në tokë, në ujë dhe në sistemin publik të kanalizimeve;



dh) vlerësimin e shkaqeve të ndotjes së ujërave kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale;

e) hartimin e planit të menaxhimit të ujërave kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale nga organet e menaxhimit të burimeve ujore;

ë) kontrollin rreth zonave të burimeve natyrore të ujërave kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale, i cili kryhet nga organet e menaxhimit të burimeve ujore;

f) ndalimin e ndryshimit të destinacionit të përdorimit të ujërave kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale;

g) ndalimin e shpimeve dhe ndërhyrjeve në zonën e burimeve natyrore të ujërave kurative, termale, termominerale dhe gjeotermale;

gj) ndalimin e thithjes me pompa të ujit kurativ, termal, termomineral dhe gjeotermal direkt nga gryka e burimit.

2. Çdo person fizik ose juridik, që shfrytëzon burimet natyrore të ujërave kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale, duhet të pajset me leje pranë organeve të menaxhimit të burimeve ujore, e cila jepet në përputhje me planin e menaxhimit të këtyre ujërave.

3. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit, miraton tarifat e përdorimit të ujërave kurative, termominerale dhe gjeotermale.

#### Neni 49

### **Pezullimi dhe ndryshimi i përkohshëm i kushteve të lejes për burimet natyrore të ujërave kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale**

1. Leja mund të ndryshohet, të pezullohet ose të shfuqizohet kur titullari përkatës i saj nuk përmbush kriteret e dhënies së këtij titulli ose ka shkelur detyrimet e përcaktuara në të.

2. Ndryshimi i kushteve, pezullimi dhe shfuqizimi i lejes kryhen, sipas rastit, nga organi që e ka lëshuar ose organi më i lartë epror:

a) kur kanë ndodhur ndryshime për shkak të forcave madhore;

b) me kërkesë të mbajtësit të lejes;

c) në rast të mosrespektimit nga titullari i kushteve të lejes;

ç) kur ujërat kurative, minerale dhe termale, me të cilat lidhet leja, nuk janë përdorur sipas afatit të përcaktuar në lejen përkatëse;

d) me vdekjen e personit fizik apo me mbarimin e personit juridik.

#### KREU VII

### **AUTORIZIMET, LEJET DHE KONCESIONET PËR PËRDORIMIN E BURIMEVE UJORE**

#### Neni 50

### **Organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore që lëshojnë autorizime, leje dhe japin koncesione**

1. Organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore japin autorizime, leje dhe lidhin kontrata koncesioni për përdorimin e ujërave, duke u bazuar në parimet e proporcionalitetit, efikasitetit dhe deburokratizimit, në zvogëlimin e barrierave administrative, si dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara me ligj të veçantë ose me vendim të Këshillit të Ministrave, në zbatim të këtij kreu.

2. Këshilli i basenit ujqor lëshon autorizimet dhe lejet në rastet kur aktiviteti do të kryhet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe brenda kufijve të një baseni të vetëm.

3. Këshilli Kombëtar i Ujit lëshon leje dhe autorizime në rastet kur aktiviteti do të kryhet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, por në një zonë që i kalon kufijtë e një baseni.

4. Ministria identifikon projektin koncesionar në bazë të klasifikimit të burimeve ujore, planit të menaxhimit të basenit ujqor dhe sipas procedurave, kriterëve dhe kushteve të përcaktuara me akte ligjore e nënligjore.

5. Autorizimet, lejet dhe koncesionet për përdorimin e ujërave:
- a) janë personale dhe i takojnë titullarit të licencës, autorizimit, lejes, koncesionit përkatës;
  - b) nuk mund të transferohen pa miratimin e organeve të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore;
  - c) janë të vlefshme për një afat të caktuar dhe rinovohen sipas një procedure të përcaktuar;
  - ç) mund të ndryshohen, të refuzohen, të pezullohen ose të shfuqizohen në bazë të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;
  - d) lëshohen pas pagimit të një tarife për shpenzimet administrative;
  - dh) regjistrohen në Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Autorizimeve, sipas parashikimeve ligjore e nënligjore përkatëse;
  - e) nuk mund të refuzohen pa një vendim të arsyetuar të organit administrativ që shqyrton kërkesën për autorizim ose leje.
6. Këshilli i Ministrave, në zbatim të këtij ligji dhe ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përcakton:
- a) kushtet e posaçme të licencimit, të autorizimit dhe lejimit dhe dokumentet shoqëruese, të nevojshme, që paraqiten për këtë qëllim;
  - b) afatin e vlefshmërisë së licencës, të autorizimit dhe lejes;
  - c) procedurat dhe afatet e shqyrtimit dhe të vendimmarrjes administrative;
  - ç) procedurat e revokimit nga organet administrative.

#### Neni 51

#### **Parimet e përgjithshme për dhënien e autorizimeve, lejeve dhe koncesioneve**

Autorizimi, leja ose koncesioni lëshohet vetëm në qoftë se:

- a) aktiviteti i personit fizik apo juridik, që është titullar i autorizimit, lejes apo koncesionit, nuk ndikon negativisht në përdorimin e ujërave;
- b) është në përputhje me planin e menaxhimit të basenit ujor përkatës;
- c) nuk çon në shkeljen e normave të cilësisë së ujit, të përcaktuara në këtë ligj;
- ç) nuk çon në cenimin e objektivave mjedisore përkatës, të përcaktuar në këtë ligj;
- d) nuk bie ndesh me programin e masave, të parashikuar në bazë të këtij ligji.

#### Neni 52

#### **Përparësitë në dhënien e lejeve, autorizimeve dhe koncesioneve**

Për dhënien e një lejeje, autorizimi, koncesioni, organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore përkatëse të ujit mbështeten në përparësitë e mëposhtme:

- a) furnizimin me ujë të popullsisë, përfshirë edhe kërkesat e industrive që ndodhen brenda vijës kufizuese të qendrave të banuara dhe që kanë një nivel të ulët konsumi;
- b) përdorimet për ujitje, bujqësi e akuakulturë;
- c) përdorime për prodhim energjie elektrike nëpërmjet burimeve hidrike;
- ç) përdorime të tjera industriale, që nuk përfshihen në kategorinë e mësipërme, përfshirë edhe përdorime në miniera;
- d) peshkim;
- dh) transport ujor;
- e) argëtim e turizëm, përfshirë lundrimin për zbavitje;
- ë) përdorime të tjera.





#### Neni 53

### **Kushtet e përgjithshme të autorizimeve, lejeve dhe koncesioneve për përdorimin e ujërave**

1. Autorizimi, leja apo kontrata koncesionare për përdorimin e ujërave përmban këto të dhëna të përgjithshme:

- a) serinë, numrin dhe datën e miratimit dhe të hyrjes në fuqi;
- b) të dhënat për identifikimin e titullarit;
- c) llojin e veprimtarisë që lejohet dhe qëllimin, për të cilin do të përdoret uji;
- ç) sasinë e ujit që mund të përdoret, duke iu referuar ose një vëllimi fiks, ose një pjese të rrjedhës;
- d) vëllimin e rrjedhës së kthyer, në qoftë se ka, dhe vendin ku rrjedha e kthyer do të shkarkohet;
- dh) sipërfaqen e tokës, me të cilën lidhet përdorimi i ujit, në rastet kur uji do të përdoret për ujitje;
- e) vendin ku ushtrohet veprimtaria, kryhet veprimi apo përdoret e mira publike;
- ë) kufizimet në ushtrimin e veprimtarisë, në kryerjen e veprimit apo në përdorimin e së mirës publike;
- f) periudhën e vlefshmërisë së licencës, autorizimit, lejes apo koncesionit.

2. Licenca, autorizimi, leja apo kontrata koncesionare përmban detyrimisht kushtet e përgjithshme të mëposhtme, në bazë të të cilave operatori detyrohet:

- a) të përdorë ujërat në mënyrë racionale, duke shmangur mbetjet dhe duke mos dëmtuar mjedisin;
- b) të përdorë ujërat vetëm për qëllimet, për të cilat i është dhënë licenca, autorizimi, leja apo kontrata koncesionare;
- c) të paguajë të gjitha kostot, taksat, tarifat në lidhje me përdorimin e ujit;
- ç) të instalojë ose të lejojë instalimin e pajisjeve për matjen e sasisë së ujit të përdorur, në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga organi përkatës që ka lëshuar lejen, autorizimin apo koncesionin;
- d) të regjistrojë vëllimin e ujit të përdorur, përfshirë dhe rrjedhën e kthyer;
- dh) të japë të dhëna dhe informacion për përdorimin e ujit sa herë që i kërkohet nga organet e ngarkuara për menaxhimin e burimeve ujore.

3. Kushtet e posaçme, dokumentet shoqëruese, afati i vlefshmërisë, procedurat e shqyrtimit dhe vendimmarrja përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Licenca dhe leja e dhënë nga institucionet qendrore apo institucionet e pavarura hyn në fuqi vetëm pas publikimit të saj në Regjistrin e Licencave dhe Lejeve, përveç rastit kur hyrja në fuqi e aktit që e miraton atë lidhet me botimin në Fletoren Zyrtare.

5. Lejet e përdorimit të ujit përfshihen në kategorinë III.6 të shtojcës së ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

#### Neni 54

### **Pezullimi dhe ndryshimi i përkohshëm i kushteve të autorizimeve, lejeve apo koncesioneve**

1. Autorizimi, leja dhe koncesioni mund të pezullohen ose të ndryshohen kur titullari përkatës nuk përmbush kriteret e dhënies së këtij titulli apo shkel detyrimet e përcaktuara në të.

2. Pezullimi dhe ndryshimi i kushteve që përmbahen në licencat, autorizimet, lejet dhe koncesionet kryhen nga organi lëshues:

- a) si pasojë e një urdhri për thatësirën, të lëshuar në bazë të këtij ligji;
- b) kur kanë ndodhur ndryshime për shkak të forcave madhore;
- c) me kërkesë të mbajtësit të titullit;
- ç) në rast të mosrespektimit nga titullari të kushteve të autorizimit, lejes ose koncesionit.

Neni 55

**Revokimi e shfuqizimi i autorizimeve dhe lejeve dhe zgjidhja e kontratës koncesionare**

1. Zgjidhja e kontratës koncesionare dhe shfuqizimi ose revokimi i autorizimeve dhe lejeve mund të bëhen në rastet kur:

a) bazuar në interesin publik dhe në përputhje me planin e menaxhimit të baseneve ujore, është i domosdoshëm përdorimi i ujërave për një qëllim tjetër parësor, në përputhje me kategorizimet, sipas përparësive të përcaktuara në nenin 52 të këtij ligji;

b) titullari i autorizimit, lejes, koncesionit nuk respekton kushtet përkatëse edhe pas pezullimit të lejes, autorizimit për një afat të caktuar;

c) me kërkesën e titullarit të autorizimit, lejes, koncesionit;

ç) ujërat, me të cilat lidhet leja, autorizimi ose koncesioni, nuk janë përdorur për një periudhë prej tre vjetësh;

d) me vdekjen e titullarit apo me mbarimin e personit juridik.

2. Çdo vendim i organeve vendore të menaxhimit të burimeve ujore për revokimin ose shfuqizimin e autorizimit, lejes mund të apelohej në rrugë administrative te ministri, sipas procedurave të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, përveç rastit të parashikuar në shkronjën “d” të pikës 1 të këtij neni.

3. Akti administrativ i ministrit për revokimin ose shfuqizimin e lejeve apo autorizimeve mund të ankimohet në gjykatën kompetente brenda afatit ligjor.

4. Për ankimet ndaj procedurave të dhënies së koncesionit dhe zgjidhjes së kontratës së koncesionit do të zbatohet legjislacioni në fuqi për koncesionet.

Neni 56

**Shpuesit profesionistë**

1. Shpuesi profesionist për ujë, që e ushtron veprimtarinë mbi bazë tregtare, duhet të jetë i pajisur me licencën e parashikuar në kategorinë III.7 të shtojcës së ligjit për licencat. Kjo veprimtari licencohet sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Organet e menaxhimit të burimeve ujore japin leje për kryerjen e shpimit pasi shpuesi profesionist paraqet projektin teknik dhe hidrogeologjik për shpimin, të hartuar nga subjekte juridike të licencuara, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Shpuesi profesionist, jo më vonë se një muaj pas përfundimit të shpimit, u paraqet organeve të administrimit të burimeve ujore, në dy kopje, një raport të hollësishëm hidrogeologjik në lidhje me shpimin, me mostrat e shtresave të shpuara, si dhe gjithë dokumentacionin përkatës, projektin fillestar të shpimit dhe relacionin pas shpimit. Organet e administrimit të burimeve ujore i dërgojnë një kopje Arkivit Qendror Gjeologjik.

4. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar duhet t’u japë informacionin përkatës organeve të menaxhimit të burimeve ujore për projektet hidrogeologjike dhe relacionet e shpimit, të dorëzuara nga subjektet pranë këtij institucioni.

5. Leja e shfrytëzimit për nxjerrje uji lëshohet nga organet e menaxhimit të burimeve ujore, pasi shpuesi profesionist paraqet relacionin teknik dhe hidrogeologjik për përdorimin potencial të pusit, të hartuar nga subjekte juridike të licencuara, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë së shpimit për nxjerrje uji nga ana e subjekteve fizike, juridike apo personave të palicencuar, pa leje përkatëse të shpimit nga organet e menaxhimit të burimeve ujore.



## KREU VIII ZONAT DHE SIPËRFAQET E MBROJTURA

### Neni 57

#### Zonat e mbrojtjes higjiëno-sanitare

1. Zonat e mbrojtjes higjiëno-sanitare përcaktohen rrotull burimeve sipërfaqësore ose nëntokësore të ujit, që furnizojnë popullsinë urbane e rurale me ujë, me qëllim që të ruhet cilësia e ujit pranë burimit.

2. Kufijtë e këtyre zonave miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, ministrit përgjegjës për ekonominë, ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe ministrit përgjegjës për punët publike.

3. Zonat e mbrojtjes higjiëno-sanitare përbëhen nga:

a) zona e parë e mbrojtjes rrotull burimit, që kontrollohet nga operatori që nxjerr, prodhon dhe shpërndan ujë të pijshëm. Kjo zonë rrethohet;

b) zona e mbrojtjes së afërt, brenda së cilës ndalohen ndërtimet, zhvillimi i industrisë, kryerja e veprimtarive bujqësore e blegtorale, hapja e puseve, hapja e kanaleve, depozitimi apo shkarkimi i ndotjeve, i ujërave të ndotura, i substancave kimike e toksike, përdorimi i plehrave kimike dhe pesticideve, përdorimi si varrezë apo groposja e kafshëve të ngordhura;

c) zona e mbrojtjes së largët, brenda së cilës veprimtaritë e parashikuara në shkronjën "b" të kësaj pike do të jenë objekt i autorizimeve të posaçme administrative.

4. Personat fizikë dhe juridikë, interesat e të cilëve dëmtohen nga përcaktimi i zonave të mbrojtjes higjiëno-sanitare, kompensohen sipas dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

### Neni 58

#### Mbrojtja e zonave të prirura ndaj ndotjes

1. Ministri harton aktet përkatëse nënligjore për shpalljen e zonave në rrezik nga ndotja prej elementeve apo substancave të dëmshme, si kimikatet e ndryshme, biocidet, për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, agrikulturës, mjedisit, të cilat i paraqet për miratim në Këshillin Kombëtar të Ujit.

2. Ministri, në bashkëpunim me ministrin përgjegjës për bujqësinë dhe ministrin përgjegjës për ekonominë, nxjerr rregullore që përcakton programet, masat dhe detyrimet e tjera përkatëse, me qëllim reduktimin dhe parandalimin e ndotjes së ujërave nga substancat e dëmshme, si ato të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, ashtu edhe ato që shkaktohen apo rrjedhin nga veprimtari të tjera bujqësore, industriale dhe veprimtaria njerëzore.

### Neni 59

#### Zonat e mbrojtjes emergjente

1. Organet e burimeve ujore mund të përcaktojnë dhe të shpallin zona ose sipërfaqe të mbrojtura sa herë që burimet sipërfaqësore ose nëntokësore rrezikohen seriozisht në sasi e cilësi, si dhe kur ekziston rreziku i përhapjes së sëmundjeve infektive, sipas evidencave nga organet kompetente.

2. Regjimi i këtyre zonave ose sipërfaqeve, si dhe kufizimet e tyre vendosen dhe ndryshojnë sipas rrethanave specifike, të cilat përcaktohen me akt nënligjor.

### Neni 60

#### Zona të veçanta ruajtjeje

Këshilli i Ministrave, nëpërmjet Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, miraton si zona të veçanta ruajtjeje zona të caktuara, basene, pjesë basenesh, rrjedha ujore, lumenj.

Neni 61

**Bashkëndimi i planeve të rregullimit të territorit me ato të burimeve ujore**

Autoritetet, që hartojnë planet dhe studimet e rregullimit të territorit, marrin në konsideratë planet e menaxhimit të burimeve ujore, të hartuara nga ministria dhe të miratuara nga Këshilli i Ministrave, me propozim të Këshillit Kombëtar të Ujit.

Neni 62

**Tokat e mbuluara me ujë**

1. Kënetat ose sipërfaqet e mbuluara me ujë, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj, përfshirë edhe ato që janë krijuar artificialisht, quhen toka të mbuluara me ujë. Këshilli Kombëtar i Ujit përcakton kufijtë e tyre.

2. Të gjitha veprimtaritë, që kryhen ose ndikojnë mbi to, janë objekt i autorizimeve, lejeve dhe koncesioneve.

Neni 63

**Zonat e rrezikshme për shëndetin**

Këshilli Kombëtar i Ujit, në bashkëpunim me organet përkatëse shëndetësore dhe ato të mbrojtjes së mjedisit, përcakton zonat e rrezikshme për jetën dhe shëndetin e njerëzve, që janë shpallur si të dëmshme për interesat publikë dhe vendos tharjen e tokave që janë nën ujë.

KREU IX

**MBROJTJA E BRIGJEVE**

Neni 64

**Mbrojtja e brigjeve**

Mbrojtja e brigjeve është detyrë publike, që realizohet me anë të ndërtimeve, rindërtimeve dhe mirëmbajtjes së pritave, veprave veshëse dhe veprave e masave të tjera teknike, ku përfshihen edhe ato biologjike.

Neni 65

**Mbrojtja e përkohshme**

Personat fizikë a juridikë, vendas dhe të huaj, pas marrjes së miratimit nga organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore, mund të kryejnë veprimtari mbrojtëse të përkohshme në raste emergjence.

Neni 66

**Veprimtaritë ndërtimore në brigje**

Organet përgjegjëse të planifikimit të territorit në njësitë e qeverisjes vendore lëshojnë leje për ndërtimin, rindërtimin apo shembjen e objekteve mbrojtëse të brigjeve, mureve, pritave e veprave të tjera në brigje, vetëm pasi pajisen me autorizim të posaçëm nga organet e administrimit dhe të menaxhimit të burimeve ujore.



#### Neni 67

### Veprimtari të ndaluara në brigje dhe plazhe

1. Në brigje, plazhe dhe në zonat e vërshimit ndalohen:
  - a) ndryshimi ose zhvendosja e mbulesës bimore natyrore apo artificiale;
  - b) marrja e materialeve inerte, rërë, zhavorr, gurë ose plisa;
  - c) ndërtimi i vendeve të parkimit për mjete ujore dhe automjete tokësore;
  - ç) krijimi i vendeve të thata për rrjetat;
  - d) gjermimi, shpimi ose shpëlarjet;
  - dh) hedhja apo depozitimi i materialeve inerte që dalin nga prishja e objekteve ndërtimore, gjermimeve të ndryshme, si dhe veprimtarive të tjera që gjenerojnë mbetje;
  - e) shkarkimi i ujërave të ndotura urbane e industriale të patrajtuara.
2. Organet e menaxhimit dhe administrimit të burimeve ujore, në bashkëpunim me organet përgjegjëse të rregullimit e planifikimit të territorit, me qëllim sigurimin dhe mirëmbajtjen e bregut, kanë të drejtë të kufizojnë ose të ndalojnë shfrytëzimin e plazhit, të fundit të detit, të dunave, të brigjeve të pjerrëta dhe të çdo sipërfaqeje tjetër që është përcaktuar për mbrojtjen e bregut dhe mirëmbajtjen e tij.

#### KREU X

### EFEKTET E DËMSHME TË UJIT

#### Neni 68

### Përmbytjet

1. Organet e menaxhimit dhe administrimit të burimeve ujore, për të garantuar sigurinë e njerëzve, gjësë së gjallë dhe të pronave, marrin masat e nevojshme brenda sipërfaqeve që preken nga përmbytjet. Në rast përmbytjesh të mëdha, ato, në bashkëpunim me strukturat dhe organet përgjegjëse për emergjencat civile, urdhërojnë ekzekutimin e punimeve të emergjencës, duke kërkuar nga përdoruesit e ujit të gjitha pajisjet dhe materialet e nevojshme për këtë qëllim.
2. Organet e menaxhimit dhe administrimit të burimeve ujore, në bashkëpunim me strukturat dhe organet e qeverisjes vendore, janë përgjegjëse për parandalimin, përballimin dhe për rehabilitimin e gjendjes së shkaktuar.
3. Çdo person fizik apo juridik, subjekt i lejes, autorizimit, koncesionit detyrohet të bashkëpunojë me dhënien e çfarëdolloj ndihme dhe informacioni me autoritetet përgjegjëse të përcaktuara në këtë nen për eliminimin e pasojave të përmbytjeve dhe efekteve të tjera të dëmshme të ujit.
4. Shkarkimet maksimale nga përdoruesit e ujit bëhen në përputhje me kushtet dhe kriteret përcaktuara në planet e menaxhimit të baseneve, si dhe akte të tjera nënligjore.
5. Për pikën 4 të këtij neni përjashtim bëjnë rastet kur shkarkimet bëhen të detyruara nga ardhja e plotave maksimale.
6. Kushtet dhe kriteret për shkarkimet maksimale miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 69

### Tokat e përmbytura

1. Tokat, që mund të përmbyen gjatë daljes nga shtrati i zakonshëm i liqeneve, pellgjeve, rezervuarëve, lumenjve, përrenjve e rrjedhave të tjera, ruajnë statusin e tyre të mëparshëm ligjor.
2. Këshilli Kombëtar i Ujit, pas marrjes së mendimit nga strukturat drejtuese vendore, si dhe nga strukturat dhe organet përgjegjëse për emergjencat civile, në raste të veçanta vendos kufizime për përdorimin e zonave të përmbytura ose të zonave që janë nën efektet e dëmshme të ujit, kur këto rrezikojnë jetën e njerëzve, të gjësë së gjallë apo pronën publike e private.
3. Magazinimi i materialeve dhe lëndëve që mund të shpëlahen në ujë dhe ndërtimi i objekteve të reja në zonat e kërcënuara nga përmbytjet janë të ndaluara.

Neni 70

**Planifikimi i menaxhimit të rrezikut nga përmytjet**

1. Ministria, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për emergjencat civile, harton akte nënligjore për planet dhe rregullat për menaxhimin e rrezikut nga përmytjet, në përputhje me legjislacionin në fuqi për emergjencat civile dhe me Planin Kombëtar të Emergjencave Civile.

2. Këshilli i basenit uxor harton për rrethet e basenit uxor të tij planin e menaxhimit të rrezikut nga përmytjet, i cili fokusohet në parandalimin, mbrojtjen, gatishmërinë, përfshirë parashikimin e përmytjeve dhe sistemet e paralajmërimit të hershëm, të cilin e paraqet për miratim në strukturat përgjegjëse për emergjencat civile.

3. Plani i menaxhimit të rrezikut nga përmytjet hartohet duke marrë në konsideratë karakteristikat përkatëse të baseneve ujore. Planet e menaxhimit të përmytjeve përfshijnë edhe promovimin e praktikave të përdorimit të qëndrueshëm të tokës, përmirësimin e aftësisë mbajtëse të ujit, kontrollin nga përmytjet të zonave të caktuara, në rast përmytjeje.

4. Plani i menaxhimit të rrezikut nga përmytjet është pjesë përbërëse e planit të menaxhimit të basenit uxor.

**KREU XI**

**VEPRAT DHE OBJEKTET UJORE**

Neni 71

**Ndërtimi**

1. Ndërtimi i veprave dhe objekteve për shfrytëzimin e burimeve ujore dhe parandalimin e veprimeve të dëmshme të ujit, që bëhen për shërbime publike, është objekt i autorizimeve, lejeve ose koncesioneve, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Personi juridik, përgjegjës për ndërtimin, brenda 30 ditëve nga përfundimi i veprës a objektit, duhet të njoftojë organet e administrimit a menaxhimit të burimeve ujore, që kanë lejuar kryerjen e veprimtarisë, që të kryejnë inspektimin përfundimtar në këtë vepër a objekt uxor.

Neni 72

**Kompetencat e organeve të menaxhimit dhe administrimit  
të burimeve ujore**

1. Organet e administrimit të burimeve ujore, në bashkëpunim me inspektoratin që mbulon fushën e mjedisit dhe organet e qeverisjes vendore, kanë të drejtë të mbikëqyrin e të detyrojnë subjektet, persona fizikë apo juridikë, për instalimin e pajisjeve për mbajtjen nën kontroll dhe matjen e sasisë së përdorimit të ujit në tokë private, si dhe të servituteve që nevojiten për hyrjen në instalime të tilla, për punën përgatitore dhe për ndërtimin.

2. Organet e administrimit të burimeve ujore, në bashkëpunim me inspektoratin që mbulon fushën e mjedisit, kanë të drejtë të kontrollojnë vënien në punë në afatet e përcaktuara në leje dhe mirëmbajtjen e objekteve ujore, si dhe të vendosin sanksione e të detyrojnë vendosjen e tubacioneve të transportit të ujit të pijshëm ose atij të kanalizimeve.

3. Organet e menaxhimit të burimeve ujore, në bashkëpunim me inspektoratin që mbulon fushën e mjedisit, kryejnë kontrole periodike të punimeve dhe objekteve ujore. Për këtë qëllim, personat e autorizuar prej tyre kanë të drejtë të inspektojnë veprat, objektet dhe të kërkojnë të dhëna e dokumentacionin lidhur me to.



## KREU XII SHKARKIMET DHE KANALIZIMET

### Neni 73 Shkarkimet e lëngshme

1. Shkarkimet në ujë, tokë, nëntokë bëhen me leje ose autorizim, të lëshuar nga organet e menaxhimit dhe administrimit të burimeve ujore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Këshilli Ministrave, me propozim të ministrit, miraton normat e shkarkimeve të lëngshme dhe kërkesat e përgjithshme e specifike për lloje të ndryshme të veprimtarive, si rezultat i të cilave kryhen shkarkime të lëngshme në mjedis.

### Neni 74 Sistemi i kanalizimeve të ujërave të ndotura

1. Për të gjitha veprimtaritë që gjenerojnë ujëra të ndotura është e detyrueshme të lidhen dhe të përdoren kanalizimet e ujërave të ndotura, në përputhje me legjislacionin që rregullon shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, si dhe me aktet nënligjore që zbatohen në këtë fushë.
2. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit dhe ministrit përgjegjës për punët publike, miraton kriteret mjedisore për ndërtimin dhe funksionimin e sistemeve të kanalizimeve.
3. Sistemi i ujërave të ndotura planifikohet i tillë që të largojë me shpejtësi e të derdhë në vende të caktuara, larg vendbanimeve njerëzore, ujërat e kanalizimeve që vijnë nga godinat publike ose private.
4. Ndërtimi i sistemit të kanalizimeve duhet jetë i tillë që të shmangë derdhjet, të cilat, në destinacionin e tyre përfundimtar, ndotin ujërat sipërfaqësore, nëntokësore, si dhe ujërat bregdetare.
5. Subjekte të caktuara mund të marrin përgjegjësinë e grumbullimit, transportimit, trajtimit dhe derdhjes në vendet e caktuara të ujërave të kanalizimeve.

### Neni 75 Sistemi individual dhe kolektiv i kanalizimeve

1. Kur disa persona përdorin një sistem të përbashkët për kanalizimet, përgjegjës para organeve të administrimit të burimeve ujore është enti që i shërben sistemit kolektiv të kanalizimeve.
2. Në rastin e një sistemi individual kanalizimesh, shkarkuesi është përgjegjës para organeve të administrimit të burimeve ujore, qoftë ky familjar ose jofamiljar.

### Neni 76 Impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura

Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit dhe ministrit përgjegjës për punët publike, miraton rregullore dhe akte normative për projektimin, ndërtimin dhe shfrytëzimin e sistemeve të impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura.

## KREU XIII LEJET DHE AUTORIZIMET PËR SHKARKIMET E UJËRAVE TË NDOTURA

### Neni 77 Dispozita të përbashkëta për leje dhe autorizime

1. Kërkesa për leje dhe autorizim për shkarkimet duhet të përmbajë në hollësi kriteret që duhet të plotësohen nga shkarkuesi, siç parashikohet në aktet nënligjore në fuqi. Në to përfshihen një përshkrim i

impiantit të trajtimit, i pajisjeve dhe i procedurave monitoruese për të siguruar funksionimin e tij korrekt, si dhe çdo përkufizim i vendosur për përmbajtjen kimike dhe bakterologjike të shkarkimit.

2. Karakteristikat e lejeve dhe autorizimeve të shkarkimit janë të njëjta me ato të përdorimit të ujit. Në çdo rast, ato përmbajnë kushtet lidhur me impiantet e trajtimit e të monitorimit, si dhe në bazë të tyre do të vendoset për standardet e ujërave të trajtuara.

3. Lejet dhe autorizimet për veprimtaritë e shkarkimit të lëngjeve që mund të shkaktojnë infiltrimin ose akumulimin me kohë në ujërat sipërfaqësore, shtretërit natyrorë ose artificialë, shtresat ujëmbajtëse ose ujërat nëntokësore do të jepen vetëm pas një studimi kompleks të bërë brenda një viti nga data e kërkesës për leje shkarkimi. Studimi do të kryhet nga institucione të licencuara ose të akredituara, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Ripërdorimi i ujërave të ndotura është objekt i lejeve administrative. Në rast se ripërdorimi i ujërave do të bëhet nga një subjekt i ndryshëm nga subjekti i parë, atëherë të dyja subjektet duhet të pajisen me leje të veçanta. Këshilli Kombëtar i Ujit përcakton rregullat për ripërdorimin e drejtpërdrejtë të ujërave të ndotura, duke u bazuar në proceset e trajtimit, cilësisë dhe qëllimin e përdorimit të këtyre ujërave pas trajtimit.

#### Neni 78

##### **Lejet administrative**

Leja, autorizimi për shkarkimin nga shoqëritë ose industrinë, që bëjnë ose mund të bëjnë shkarkime ujërash të ndotura, jepen në bazë të akteve nënligjore dhe vetëm me kushtin që të jetë marrë më parë leja, autorizimi për shkarkimin.

#### Neni 79

##### **Refuzimi i lejeve dhe autorizimeve**

Organet e administrimit të ujit kanë të drejtë të refuzojnë lejet dhe autorizimet për veprimtari ose procese industriale, derdhjet e të cilave, pavarësisht nga trajtimi, paraqesin një rrezik serioz për ndotjen e burimeve ujore, sistemin ekologjik dhe mjedisin.

#### Neni 80

##### **Ndryshimi i lejeve**

1. Këshilli i basenit ujor ka të drejtë të vendosë në lidhje me pezullimin e përkohshëm, të përhershëm ose ndryshimin e lejes dhe autorizimit, kur është në kompetencën e këtij organi, nëse rrethanat, në të cilat është bazuar dhënia e tyre, kanë ndryshuar ose kur krijohen rrethana të reja, të cilat, nëse do të kishin ekzistuar në kohën e dhënies, do të kishin çuar në refuzim të lejes ose lëshimin e lejes me kushte dhe afate të tjera.

2. Këshilli i basenit ujor, për rastet kur kompetencën për pezullimin e përkohshëm, të përhershëm ose ndryshimin e lejes dhe autorizimit e ka Këshilli Kombëtar i Ujit, bën propozimet përkatëse me vendim formal, i cili i dërgohet Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit për t'u shqyrtuar nga Këshilli Kombëtar i Ujit.

#### Neni 81

##### **Ndërprerja e veprimtarive të shkarkimit të ujërave të ndotura**

Organet e administrimit të ujit kanë të drejtë të urdhërojnë ndërprerjen e menjëhershme të të gjitha veprimtarive apo të pjesëve të veçanta të tyre, lidhur me shkarkimet e ujërave të ndotura, nga të cilat rezultojnë shkarkime të paautorizuara që dëmtojnë interesin publik.





Neni 82

**Pagesat për shpenzimet administrative**

Aktivitetet e autorizuara të shkarkimit u nënshtrohen pagesave administrative, sipas kritereve dhe tarifave të vendosura nga Këshilli i Ministrave.

**KREU XIV  
SERVITUTET**

Neni 83

**Servitutet**

Pronarët e tokave, për çështjet e servituteve që lidhen me rrjedhjen dhe marrjen e ujërave, u referohen përcaktimeve të bëra në dispozitat e Kodit Civil.

Neni 84

**Veprimtaritë në brigje**

Në tokat, pronë private dhe shtetërore, përbri brigjeve të lumenjve, përrenjve, kanaleve, liqeneve, pellgjeve, rezervuarëve, lagunave bregdetare dhe deteve duhet, detyrimisht, të lihet:

a) një sipërfaqe toke e lirë për përdorim publik, me gjerësi nga 5 deri në 100 metra nga këto brigje, sipas përkufizimit të bërë në këtë ligj. Gjerësia e saj mund të shtrihet më tej në afërsi të grykës së lumenjve, në rrethinat e ngushta të rezervuarëve ose kur kushtet topografike dhe hidrologjike të lumenjve, liqeneve ose rezervuarëve e bëjnë të nevojshme për sigurimin e njerëzve dhe të pasurisë. Veprimtaritë në këto zona përcaktohen me akte të Këshillit Kombëtar të Ujit;

b) një sipërfaqe toke e lirë për zhvillimin e veprimtarive që përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Ujit, me gjerësi nga 100 m deri në 200 m.

**KREU XV  
MONITORIMI**

Neni 85

**Monitorimi i statusit të ujërave të brendshme detare, sipërfaqësore, nëntokësore dhe zonave të mbrojtura**

1. Këshilli i basenit ujor zbaton programin e monitorimit të statusit të ujërave, në mënyrë që të përcaktohet një rishikim koherent dhe i kuptueshëm i statusit të ujit, brenda secilit basen.

2. Për ujërat sipërfaqësore, programe të tilla mbulojnë:

a) statusin ekologjik, kimik e mikrobiologjik, potencialin ekologjik, si dhe biodiversitetin;

b) vëllimin dhe nivelin ose shkallën e rrjedhjes që kërkohet për të arritur statusin përkatës ekologjik dhe kimik, potencialin ekologjik.

3. Për ujërat tokësore, këto programe mbulojnë monitorimin e statusit kimik dhe të statusit sasior.

4. Sipas rastit, programet e përmendura në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni plotësohen duke iu referuar edhe specifikimeve të dhëna në legjislacionin për zonat e mbrojtura.

5. Programi për ujërat nëntokësore mbulon dhe trajton monitorimin e statusit kimik dhe sasior.

6. Këto programe do të vihen në zbatim jo më vonë se 6 vjet pas miratimit të këtij ligji.

7. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit, miraton kërkesat për programet e monitorimit, sipas këtij neni.

Neni 86

**Monitorimi dhe menaxhimi i të dhënave**

1. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit, miraton rregulloren për hartimin e programit të monitorimit sistematik të kushteve të ujërave sipërfaqësore e nëntokësore dhe të zonave të mbrojtura.
2. Rregullorja përcakton parametrat që do të monitorohen, procedurat dhe masat teknike të nevojshme, përfshirë, por pa u kufizuar në kërkesat për marrjen e mostrave dhe analizave për secilin parametër, kontrollin e cilësisë, praktikat laboratorike, regjistrimin dhe menaxhimin e të dhënave.
3. Rregullorja përcakton kriteret për botimin e buletineve periodike vjetore dhe shumëvjeçare, me akses publik, të monitorimit të ujërave sipërfaqësore e nëntokësore dhe të zonave të mbrojtura.

Neni 87

**Monitorimi i trupave ujqorë të përcaktuar për prodhimin e ujit të pijshëm**

Agjencia e basenit ujqor është institucioni përgjegjës për monitorimin e trupave ujqorë sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, të përcaktuar për prodhimin e ujit të pijshëm.

KREU XVI

**KADASTRA KOMBËTARE E BURIMEVE UJORE DHE REGJISTRI KOMBËTAR I  
AUTORIZIMEVE, LEJEVE E KONCESIONEVE PËR PËRDORIMIN E BURIMEVE UJORE**

Neni 88

**Kadastra Kombëtare e Burimeve Ujqore**

1. Ministria është organi që krijon, menaxhon dhe përditëson Kadastrën Kombëtare të Burimeve Ujqore.
2. Kadastra Kombëtare e Burimeve Ujqore përmban të dhëna për:
  - a) ujërat sipërfaqësore që klasifikohen sipas statusit të tyre kimik dhe ekologjik;
  - b) zonat e mbrojtura;
  - c) trupat ujqorë tepër të modifikuar;
  - ç) lejet e mjedisit për të ushtruar veprimtari, si rezultat i të cilave shkarkohen ujëra të përdorura në trupat ujqorë;
  - d) zonat e prirura ndaj eutrofikimit dhe zonat ndaj nitrateve;
  - dh) zonat e mbrojtjes higjieno-sanitare;
  - e) zonat e mbrojtjes emergjente;
  - ë) zona të veçanta ruajtjeje;
  - f) zonat e rrezikshme për shëndetin;
  - g) trupat ujqorë të përcaktuar për prodhimin e ujit të pijshëm.
3. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit, miraton kërkesat, kushtet, procedurat, fondet e nevojshme buxhetore për krijimin, mbajtjen, menaxhimin dhe përditësimin e Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujqore.
4. Të gjitha institucionet, entet dhe subjektet e tjera, publike ose jopublike, që merren me menaxhimin e burimeve ujqore, detyrohen të caktojnë një përfaqësues që mban marrëdhënie me Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit dhe dërgon të dhënat në Kadastrën Kombëtare të Burimeve Ujqore, në bazë të formave dhe procedurave përkatëse të parashikuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
5. Kadastra Kombëtare e Burimeve Ujqore dhe të dhënat e saj mbahen, menaxhohen dhe përditësohen nëpërmjet sistemit dhe arkivit elektronik.



#### Neni 89

### **Funksionet e Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore**

1. Informacioni në Kadastrën Kombëtare të Burimeve Ujore organizohet sipas të dhënave elektronike të integruara për burimet ujore, në mënyrë të pavarur dhe në bashkëpunim me njëra-tjetrën. Organet përgjegjëse për menaxhimin e burimeve ujore krijojnë, mbajnë dhe menaxhojnë përkatësisht bazën e të dhënave.

2. Kadastra Kombëtare e Burimeve Ujore dhe të dhënat e tij publikohen në faqen zyrtare të ministrisë.

3. Të dhënat e Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore përdoren nga autoritetet dhe institucionet e tjera publike, kombëtare ose vendore, në përputhje me këtë ligj dhe me akte të tjera ligjore e nënligjore.

4. Çdo institucion hedh në Kadastrën Kombëtare të Burimeve Ujore pjesën e vet të të dhënave dhe i publikon ato në faqen e vet elektronike.

#### Neni 90

### **Regjistri Kombëtar i autorizimeve, lejeve e koncesioneve për përdorimin e burimeve ujore**

1. Agjencia e basenit ujqor mban regjistrin ku shënohen të gjitha licencat, autorizimet, lejet, koncesionet e lëshuara, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

2. Ministria krijon, mban, menaxhon dhe përditëson Regjistrin Kombëtar për të gjitha lejet, autorizimet dhe koncesionet e lëshuara nga organet e menaxhimit dhe administrimit të burimeve ujore.

3. Në çdo regjistër evidentohen:

a) të dhënat për të gjitha kërkesat, autorizimet, lejet dhe koncesionet e reja, të kërkuara në përputhje me këtë ligj ose për ndryshimin, rinovimin apo heqjen dorë nga ato ekzistuese;

b) procedurat e vënies në zbatim të këtyre autorizimeve, lejeve dhe koncesioneve.

4. Këshillat e baseneve ujore i përcjellin ministrisë të dhënat dhe informacionin që disponojnë në regjistrat e tyre, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

#### KREU XVII

### **INFORMIMI I PUBLIKUT DHE KONSULTIMI**

#### Neni 91

### **E drejta për të marrë dhe për të përdorur informacionin për burimet ujore**

1. Çdo person fizik dhe juridik ka të drejtën t'i mundësohet dhënia e informacionit të disponueshëm në lidhje me burimet ujore.

2. Publikut i jepet informacion për dokumentet bazë dhe të dhënat e përdorura për hartimin e planeve të menaxhimit të baseneve, si dhe i krijohet mundësia për të marrë pjesë në procesin e konsultimit dhe komentimit të planeve të menaxhimit të baseneve ujore.

#### KREU XVIII

### **DISPOZITAT FINANCIARE**

#### Neni 92

### **Tarifat për përdorimin e ujit**

1. Këshilli i Ministrave miraton tarifat që paguhen për përdorimin e ujit, duke pasur parasysh këto faktorë:

a) llojin e ujit që kërkohet për përdorim;

b) qëllimin e përdorimit të ujit;

- c) stinën e vitit, gjatë së cilës përdoret uji;
  - ç) sasinë e ujit që do të merret;
  - d) zërat e shpenzimeve të planifikimit, ndërtimit, shfrytëzimit, mirëmbajtjes e amortizimit të objekteve ujore dhe të ardhurat e parashikuara për përdoruesin e ujit nga përdorimi i këtij objekti ujor;
  - dh) përshtatshmërinë e impianteve për trajtimin dhe largimin e ujit pas përdorimit, në kuptimin e ndikimit mbi shëndetin e njerëzve, cilësinë e ujit dhe mjedisin.
2. Tarifat e përdorimit të ujërave ndërkufitare përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
  3. Përfshihen nga pagimi i tarifave të ujit forcat zjarrfikëse, qofshin këto subjekte publike apo private, të cilat përdorin ujin për rastet e shuarjes së zjarrit.

#### Neni 93

##### **Shpenzimet administrative**

1. Kushdo, që kërkon të ushtrojë veprimtari që lidhen me përdorimin apo shkarkimin e ujit, për ndërtimin e objekteve a veprave ujore, sipas këtij ligji, detyrohet të paguajë për shpenzimet administrative.
2. Këshilli i Ministrave, me propozim të Këshillit Kombëtar të Ujit, miraton tarifat për shpenzimet administrative.

#### Neni 94

##### **Mbledhja e tarifave dhe pagesave për shpenzimet administrative**

1. Tarifat e përdorimit të ujit dhe pagesat për shpenzimet administrative mblidhen nga organet e menaxhimit të burimeve ujore.
2. Të ardhurat, që krijohen nga shpenzimet administrative, gjobat dhe tarifat për përdorimin e ujit kalojnë në Buxhetin e Shtetit.

#### Neni 95

##### **Organet përgjegjëse për zbatimin e ligjit**

1. Organet e administrimit të burimeve ujore, njësitë e qeverisjes vendore, strukturat e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, për bujqësinë, strukturat dhe organet e emergjencave civile, të rregullimit e planifikimit të territorit janë përgjegjëse për marrjen e masave dhe zbatimin e dispozitave të këtij ligji.
2. Inspektoratet, që mbulojnë fushën e mjedisit, shëndetësisë dhe bujqësisë, janë përgjegjëse për zbatimin e dispozitave të këtij ligji.
3. Inspektorati, që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit, dhe agjencitë rajonale të mjedisit janë përgjegjëse për zbatimin e dispozitave të këtij ligji, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.
4. Përdoruesit e angazhuar në fushën e menaxhimit të ujërave, mbi të cilët zbatohet ky ligj, u japin inspektorëve që mbulojnë fushën e mjedisit të gjithë asistencën e nevojshme për kryerjen e inspektimeve në atë veprimtari, për marrjen, analizimin dhe grumbullimin e gjithë informacionit të nevojshëm për realizimin e detyrave të tyre, për qëllime të këtij ligji, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.
5. Inspektimi për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore bëhet në përputhje me këtë ligj, me ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.



## KREU XIX KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 96

### **Inspektimi dhe konstatimi i shkeljes administrative**

1. Kontrolli për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore bëhet nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

2. Kur konstaton shkeljen e dispozitave të këtij ligji, inspektori i inspektoratit që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit vendos dënimin kryesor me gjobë, si dhe dënime të tjera plotësuese.

Neni 97

### **Sanksionet administrative**

Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen si më poshtë:

1. Shkarkimi në mjedis i ujërave të përdorura industriale, në kundërshtim me parashikimin e pikës 7 të nenit 30 të këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 1 000 000 lekë deri në 5 000 000 lekë.

2. Veprimet e kryera në kundërshtim me nenin 39 të këtij ligji, lidhur me sasinë e rrjedhjes minimale ekologjike për çdo trup uJOR natyror, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga 1 000 000 lekë deri në 2 000 000 lekë.

3. Llundrueshmëria dhe ndërtimi i strukturave ankoruese, portuale, i veprave mbrojtëse bregdetare dhe ishujve artificialë në det, të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 2 të nenit 41 të këtij ligji, kur kryhen pa lejen e Këshillit Kombëtar të Ujit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga 1 000 000 lekë deri në 2 000 000 lekë.

4. Mospajisja me autorizim nga organet e administrimit dhe menaxhimit të ujërave për veprimtaritë e parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 1 të nenit 42 të këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 100 000 lekë deri në 500 000 lekë.

5. Nxjerrja e materialeve inerte, si rërë, zhavor, që nxirren nga shtretërit e lumenjve, përrenjve, liqeneve me ose pa ujë, në kundërshtim me nenin 44 të këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 1 000 000 lekë deri në 2 000 000 lekë.

6. Shpimet dhe ndërhyrjet në zonën e burimeve natyrore të ujërave kurative, termale, termominerale dhe gjeotermale, si dhe thithja me pompa e ujërave kurative, termale, termominerale dhe gjeotermale direkt nga gryka e burimit, në kundërshtim me shkronjat “g” dhe “h” të pikës 1 të nenit 48 të këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga 500 000 lekë deri në 1 000 000 lekë.

7. Shfrytëzimi i burimeve natyrore të ujërave kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale pa lejen e organeve të menaxhimit të burimeve ujore, si dhe ndryshimi i destinacionit të këtyre burimeve, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 48 të këtij ligji, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga 500 000 lekë deri në 1 000 000 lekë.

8. Ushtrimi i aktivitetit mbi bazë tregtare nga shpuesit profesionistë të puseve pa licencë nga QKL-ja, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 56 të këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 100 000 lekë deri në 500 000 lekë.

9. Mospajisja në afat e raportit të shpimit nga ana e shpuesit profesionist në organet e administrimit të burimeve ujore, në përfundim të shpimit, e parashikuar në pikën 3 të nenit 56 të këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 100 000 lekë deri në 300 000 lekë.

10. Ushtrimi i veprimtarisë së shpimit për nxjerrje uji nga subjekte fizike, juridike apo persona të palicencuar, që ndërmarrin operacione shpimi pa u pajisur më parë me lejen për shpim nga organet e menaxhimit të burimeve ujore, të parashikuar në pikën 6 të nenit 56 të këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 300 000 lekë deri në 500 000 lekë.

11. Kryerja e veprimtarive pa lejet apo autorizimet përkatëse në zonat e mbrojtjes higjieno-sanitare, të parashikuara në shkronjat “a”, “b” e “c” të pikës 3 të nenit 57 të këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 500 000 lekë deri në 1 000 000 lekë.

12. Veprimet që kryhen në kundërshtim me nenet 67, 69 pika 3 dhe 84 të këtij ligji, lidhur me veprime për mbrojtjen e brigjeve, kryerjen e veprimtarive në brigje pa lejet përkatëse, për kryerjen e veprimtarive të ndaluara në brigje dhe plazhe, për magazinimin e materialeve të lëndëve dhe ndërtimin e objekteve të reja në zonat e kërcënuara nga përmbytjet, si dhe për ndërtimin e veprave dhe objekteve ujore pa lejet përkatëse, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga 1 000 000 lekë deri në 2 000 000 lekë.

13. Veprimet që kryhen në kundërshtim me pikën 4 të nenit 68 të këtij ligji, lidhur me shkarkimet maksimale nga përdoruesit e ujit, të cilat nuk bëhen në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në planet e menaxhimit të baseneve, si dhe akteve të tjera nënligjore, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga 1 000 000 lekë deri në 2 000 000 lekë.

14. Veprimet që kryhen në kundërshtim me pikën 1 të nenit 71 të këtij ligji, lidhur me ndërtimin e veprave dhe objekteve për shfrytëzimin e burimeve ujore, pa lejen apo autorizimin përkatës, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga 500 000 lekë deri në 1 000 000 lekë.

15. Mosnjoftimi i organeve të administrimit apo menaxhimit të burimeve ujore për përfundimin e veprës apo objektit brenda afatit ligjor, sipas pikës 2 të nenit 71 të këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 100 000 lekë deri në 300 000 lekë.

16. Shkarkimet në ujë, tokë, nëntokë apo në gropa, pa miratimin e lëshuar nga organi i menaxhimit të burimit ujor, parashikuar në pikën 1 të nenit 73 të këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 500 000 lekë deri në 1 000 000 lekë.

17. Krahas dënimit me gjobë, në varësi të ndotjes dhe dëmtimit, vendoset dhe pezullimi i pjeshëm apo i plotë i aktivitetit, si edhe sekuestrimi i mjeteve dhe pajisjeve, të cilat kalojnë në rezervat e shtetit.

Neni 98

#### **Klasifikimi i masave administrative**

Masat e gjobës, pezullimit të veprimtarisë deri në 10 ditë, pezullimit të veprimtarisë për një afat dymujor ose heqjes së lejes, të parashikuara në këtë ligj, janë dënime kryesore, ndërsa masat e tjera si sekuestrimi i mjeteve dhe pajisjeve, materialeve inerte gjendje janë dënime plotësuese.

Neni 99

#### **Ankimi**

1. Kundër vendimit të organeve të menaxhimit dhe administrimit të burimeve ujore mund të bëhet ankimi në gjykatën kompetente brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

2. Kundër vendimit të Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar mund të bëhet ankimi ose ankimi i veçantë, në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 100

#### **Ekzekutimi i kundërvajtjeve administrative**

Ekzekutimi i masave administrative në zbatim të këtij ligji bëhet në përputhje me ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.



KREU XX  
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 101

**Propozimi dhe miratimi i akteve nënligjore**

1. Këshilli i Ministrave, brenda 3 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miraton aktet nënligjore në zbatim të neneve 8, 17 pika 2, 22 pika 2, 25 pika 3, 26 pika 3, 29, 31 pika 1, 34 pika 3, 36 pika 2, 37 pika 3, 41 pika 3, 42 pika 5, 44 pika 2, 47 pika 3, 48 pika 3, 50 pikat 1 dhe 6, 53 pika 3, 57 pika 2, 60, 61, 68 pika 6, 73 pika 2, 74 pika 2, 76, 82, 85 pika 7, 86 pika 1, 88 pika 3, 92 pikat 1 dhe 2 dhe 93 pika 2 të këtij ligji.

2. Ministri miraton aktet nënligjore për zbatimin e neneve 26 pika 4, 27 pikat 1 dhe 2 dhe 35 pika 1 të këtij ligji.

3. Ministri, në bashkëpunim me ministrin përgjegjës për bujqësinë, ministrin përgjegjës për ekonominë dhe atë për shëndetësinë, nxjerr rregullore për zbatimin e pikës 2 të nenit 35 dhe pikës 2 të nenit 58 të këtij ligji.

4. Këshilli Kombëtar i Ujit miraton aktet për zbatimin e neneve 9 pika 3, 17 pika 2, 23 pika 2, 28 pika 4, 35 pika 1, 41 pika 2, 46 pika 1, 50 pika 3, 58 pika 1, 62 pika 1, 63, 69 pika 2, 77 pika 4 dhe 84 shkronja “a” të këtij ligji.

5. Ministri, në bashkëpunim me ministrin përgjegjës për emergjencat civile, miraton akte nënligjore për zbatimin e pikës 1 të nenit 70 të këtij ligji.

Neni 102

Kur leja ose autorizimi i lëshuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji bie në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, ajo shfuqizohet, por pa i hequr të drejtën titullarit të vazhdojë aktivitetin deri në mbarim të afatit dhe, me mbarimin e tij, të aplikojë një leje ose autorizim të ri.

Neni 103

**Shfuqizimet**

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 8093, datë 21.3.1996 “Për rezervat ujore”, i ndryshuar, si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji shfuqizohen.

Neni 104

**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 1 vit pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 15.11.2012

**Shpallur me dekretin nr.7845, datë 3.12.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QBZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 5.12.2012  
Doli nga shtypi më 6.12.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2012

Çmimi 96 lekë